

**UNIVERSITETI I EVROPËS
JUG – LINDORE**



FAKULTETI I DREJTËSISË

STUDIMET E DOKTORATURËS

PLANI I DISERTACIONIT

**Tema: "EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË
KOSOVË NË RASTET SPECIFIKE NË
PERIUDHËN KOHORE 2014-2017 "**

Mentori,

Prof. Dr. BESA ARIFI

Kandidati,

PhD. Cand. MENSUR MORINA

Tetovë, 2019

Përmbajtja

1. Parathënie.....	6
2. Falënderimet	7
3. Abstrakti.....	9
4. Abstract.....	11
5. Hyrje	13
D E K L A R A T Ë	14
6. Biografia dhe arritjet akademike.....	15
7. Titulli i tezës së doktoraturës	21
8. Fusha e studimeve.....	21
9. Rëndësia e problemit studimor	21
10. Kontributi i tezës për komunitetin dhe shoqërinë	22
11. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore	23
12. Shqyrtimi i literaturës	24
13. Etika	25
14. Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare.....	26
15. Metodologjia e hulumtimit.....	26
16. Përmbajtja (struktura) e tezës së doktoratës.....	28
17. Shkurtesat.....	29
PJESA I	31
KAPITULLI I:	31
1. Historiku i ekstremizmit.....	31
1.1 Historiku i ekstremizmit dhe veprimi i tyre organizativë	31
1.2 Përkufizimi i ekstremizmit dhe terrorizmit	40
1.3 Disa nga grupet terroriste më të njohura në botë.....	45
1.4 Ekstremizmi i dhunshëm që shpie në Radikalizëm dhe Terrorizëm	50
1.5 Motivet e ekstremizmit, tipologjia dhe faktorët.....	51
1.6. Kuptimi dhe përmbajtja e sigurisë shoqërore	54
KAPITULLI II:	56
2. Format dhe përhapja e ekstremizmit.....	56
2.1 Terrorizmi ndërkombëtar si problem i paqes dhe sigurisë botërore.....	56
2.2 Terrorizmi pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA.....	57
2.3 Rruga që ndjekin ekstremistët për t'u rekrutuar në organizatat terroriste	63
2.4 Roli i religjionit në ekstremizëm dhe radikalizëm që shpie në Terrorizëm.....	64
KAPITULLI III:	66
3. Aspektet e drejtësisë penale, terrorizmi dhe konceptet e përgjithshme të saj në Kodin Penal të Kosovës.....	66
3.1 Përkufizimi i terrorizmit sipas Kodit Penal të Kosovës.....	66

3.2 Kryerja e veprave Terroriste	69
3.3 Ndhimja në kryerjen e terrorizmit	73
3.4 Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit	74
3.4 Rekrutimi për terrorizëm	77
3.5 Trajnimi për terrorizëm.....	78
3.6 Shtytja për kryerjen e veprave terroriste.....	79
3.7 Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste	80
3.8 Organizimi dhe pjesëmarrja në grupin terrorist.	80
3.9 Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës	82
3.10 Rëndësia e përgatitjes së kryerjes së veprës terroriste	83
3.11 Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare	84
3.12 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.....	85
KAPITULLI IV:	87
4. Aspekti krahasues i legjislacioneve penale të Kosovës me atë të Maqedonisë	87
4.1 Rregullimi i veprave penale lidhur me ekstremizimin e dhunshëm në Kodin Penal të Maqedonisë	87
4.2 Organizata Terroriste (Neni 394-a)	87
4.3 Terrorizmi (Neni 394-b).....	88
4.4 Financimi i Terrorizmit (Neni 394-c)	89
4.5 Raste specifike të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni	91
4.6 Qelia	91
4.7 Rasti i 27 Prillit 2017.....	93
4.8 Rasti Monstra	95
KAPITULLI V:	97
5. Ekstremizmi i dhunshëm dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.....	97
5.1 Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në luftën kundër ekstremizmit, radikalizmit që shpiejnë në terrorizëm.....	97
5.2 Liria e mendimit, ndërgjegjjes dhe fesë apo besimit fetar	100
KAPITULLU VI:	101
6. Aplikimi i masave Parandaluese	101
6.1 Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpiejnë në Terrorizëm, konceptet kryesore të tyre	101
6.2 Aplikimi i masave parandaluese nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjia kombëtare dhe qasja në luftën kundër terrorizmit	103
6.3 Masat represive në luftën kundër ekstremizmit dhe terrorizmit	106
6.4 Llogaridhënia, Legjitimiteti dhe besimi tek institucionet e rendit	107
KAPITULLI VII:	108

7. Aspekti hulumentus i shqiptimi të sanksioneve penale ndaj kryersëve të veprave Penale të Terrorizmit	108
7.1 Aspekti hulumentus i shqiptimi të sanksioneve penale ndaj kryersëve të veprave Penale të Terrorizmit në Gjykatat e Kosovës për periudhën kohore 2014-2017	108
KAPITULLI VIII	131
8. Studimet empirike (Fokus grupi, intervistat gjysmë të strukturuar dhe anketa me pyetësor të strukturuar).....	131
8.1 Intervista gjysmë të strukturuar me bërësit e politikave dhe përgjegjësit: roli i përgjegjësve të sektoreve të sigurisë dhe menaxhimi i situatave nga parandalimi i ekstremizmit të dhunëshëm;	131
8.2 Anketa me pyetësor të strukturuar me drejtorët e departamenteve të nivelit të mesëm e të ulët dhe të mesëm e të lartë: roli i drejtorit në zbatimin e politikave programore të dalura nga ligji dhe strategjia Kombëtare;.....	131
PYETJET	148
KONKLuzionET	171
9. Bibliografia	184

Përmbajtja e Grafikeve

Grafiku 1 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Ferizajt	112
Grafiku 2 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Gjakovës.....	113
Grafiku 3 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Gjilanit	115
Grafiku 4 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Mitrovicës	117
Grafiku 5 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Pejës	119
Grafiku 6 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës	120
Grafiku 7 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës	123
Grafiku 8 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës	125
Grafiku 9 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës	127
Grafiku 10 Raport statistikor për veprat penale kundër terrorizmit Neni 136-145 i ri	130
Grafiku 11 Grafiku i pyetësorëve: Komisioni AKI 1, Komisioni AKI 2, Komisioni AKI 3, Komisioni SIGURI 1 dhe Komisioni SIGURI 2	147

Përmbajtja e Tabelave

Tabela 1. Publikimet në revistat shkencore si dhe pjesëmarrja në konferencat shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare	20
Tabela 2 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017–në Gjykatën Themelore të Ferizajt	111
Tabela 3 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Gjakovës	113
Tabela 4 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Gjilanit	114
Tabela 5 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Mitrovicës	116
Tabela 6 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2017– në Gjykatën Themelore të Pejës	118
Tabela 7 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2014, në Gjykatën Themelore të Prishtinës	120
Tabela 8 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2015, në Gjykatën Themelore të Prishtinës	122

Tabela 9 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2016, në Gjykatën Themelore të Prishtinës	124
Tabela 10 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2017, në Gjykatën Themelore të Prishtinës	126
Tabela 11 Raport statistikor për veprat penale kundër terrorizmit Neni 136-145 KPK i riu	129
Tabela 12 Pyetëtor – Komisioni AKI 1	134
Tabela 13 Pyetësor - Komisioni AKI 2.....	137
Tabela 14 Pyetësor - Komisioni AKI 3.....	140
Tabela 15 Pyetësor - Komisioni SIGURI 1	143
Tabela 16 Pyetësor - Komisioni për siguri 2.....	146

1. Parathënie

Fenomeni i terrorizmit dhe i radikalizmit është i vjetër sa edhe vet shoqëria njerëzore, sepse në vazhdimësi janë kryer veprime terroriste nga individ dhe grupe të strukturuar kundër institucioneve të ndryshme shtetërore, por edhe ndaj vet shoqërisë. Aktete e tilla janë kryer për të arritur qëllime nga më të ndryshmet qoftë qëllime politike, ideologjike, fetare, racore, kombëtare etj.

Sidoqoftë përkundër faktit se ky fenomen ka një histori të gjatë, megjithatë në trevat shqiptare nuk është trajtuar me një seriozitet të duhur dhe si pasojë edhe literatura e kësaj fushe ka qenë e mangët, e pamjaftueshme dhe në shumë raste edhe literaturë e vjetër e cila nuk është se ka shërbyer shumë për njohjen e kësaj dukurie të rrezikshme. Kjo pikërisht ka qenë arsyeja kryesore që i ka shtyrë shumë studiues viteve të fundit që të merren me këtë dukuri, duke grumbulluar literaturë vendore dhe të huaj, duke analizuar taktikat e përdorura dhe duke krahasuar të dhënat e dala nga institucionet shtetërore të cilat janë marrë me luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni.

Ky punim i doktoraturës, i ndarë në kapituj përmban të dhëna lidhur me historikun e paraqitjes së terrorizmit, përkufizimet ligjore dhe ato politike të terrorizmit, pastaj mënyrat e paraqitjes së terrorizmit, duke përfshirë edhe motivet e kryerjes së veprave të tilla gjithashtu.

Kapitulli i I-rë i punimit flet për historikun e ekstremizmit dhe veprimin organizativ, përkufizimin e nocionit të ekstremizmit dhe terrorizmit, informata mbi grupet terroriste më të njohura në botë, motivet, tipologjinë dhe faktorët e ekstremizmit, si dhe kuptimin dhe përmbajtjen e sigurisë shoqërore.

Në Kapitullin e II-të është trajtuar terrorizmi ndërkombëtar e veçanërisht terrorizmi pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA, gjithashtu është trajtuar edhe roli i fesë dhe religjionit në shfaqjen e terrorizmit.

Në Kapitullin III-të të këtij punimi është trajtuar aspekti ligjor-penal i terrorizmit sipas Kodit Penal të Kosovës. Në mënyrë shumë specifike janë trajtuar veprat penale veç e veç sipas KPK-s, që përfshijnë mënyrën e kryerjes, kryerësit e mundshëm të këtyre veprave, format e kryerjes së këtyre veprave, dënimet e parapara dhe detaje të tjera.

Në Kapitullin e IV-të është trajtuar legjislacioni Penal i Republikës së Maqedonisë lidhur me terrorizmin, e gjithashtu janë trajtuar edhe disa nga rastet më të rënda të cilat e kanë tronditur opinionin publik, e që konsiderohen si vepra të natyrës terroriste.

Në Kapitullin V-stë janë trajtuar respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë luftimit dhe parandalimit të terrorizmit dhe radikalizmit fetar, si një parakusht për një sukses në këtë përballje me terrorizmin.

Kapitulli i VI-të përmban të dhëna për parandalimin e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë kapitull janë prezantuar institucionet relevante shtetërore të pëfshira në këtë ballafaqim, pastaj aktete ligjore, nënligjore, strategjitë kombëtare si dhe dokumentete e tjera të nevojshme dhe të zbatueshme.

Në Kapitullin e VII-të janë prezentuar të dhëna të sakta, të nxjerra nga Gjykatat e Kosovës, Prokuroritë dhe Policia e Kosovës lidhur me numrin e rasteve të hetimit, procedimit dhe dënimit të kryerësve të veprave penale terroriste.

Ndërsa në Kapitullin e VIII-të dhe të fundit, janë prezantuar edhe rezultatet e intervistave dhe anketave me njohës të kësaj fushe.

2. Falënderimet

Studimi dhe arritja në përfundim të shkollës së doktoraturës përfshinë një periudhë të gjatë, të lodhshme dhe të mundimshme, e cila kërkon një përkushtim, vullnet dhe durim të çeliktë, përballë të gjitha vështirësive dhe sfidave me të cilat përballesh.

Falë ndihmës, përkrahjes si dhe mbështetjes që më kanë dhënë shumë persona arrita në përfundim të një rrugëtimi të gjatë studimor.

Për këtë, përfitoj nga rasti dhe dua të shpreh mirënjohjen dhe falënderimet për të gjithë ata që më kanë qëndruar pranë dhe më kanë mbështetur në këtë periudhë kohore. Duke qenë student në doktoraturë, këshillat, sugjerimet, përkrahja dhe mbështetja e shumë personave të ndihmojnë që t'i tejkalosh të gjitha çastet e vështira dhe lodhjen e madhe dhe të pamasë.

Fillimisht, shpreh një falënderim dhe mirënjohje të veçantë për udhëheqësen time-mentoren, Prof. Dr. BESA ARIFI, pa ndihmën, këshillën dhe mbështetjen e së cilës nuk do të ishte i mundur realizimi i këtij studimi. Shpesh herë kam qenë para dilemave të mëdha lidhur me titullin e temës për të cilin u përcaktova, por falë durimit, këshillave si dhe profesionalizmit e sugjerimeve që m'i dha hap pas hapi profesoresha ime, u mbusha me forcë dhe motiv për ta përfunduar me sukses temën.

Poashtu dëshiroj të shpreh falënderimet e mia për gjithë drejtuesit, profesorët dhe stafin akademik të studimeve themelore, atyre të magjistraturës dhe në veçanti të studimeve të doktoraturës të cilët u teguan të gatshëm që të më ndihmonin rreth mbledhjes së informatave dhe seleksionimit të tyre, për ta përmbyllur me sukses temën time të doktoraturës.

Falënderoj edhe gjykatat, prokuroritë dhe Policinë e Kosovës që më ndihmuan me këshillat dhe informatat e tyre.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për intervistuesit: Prof. Dr. Mustafë Bajrami – ekspert dhe njohës i fesë dhe i Lindjes së Mesme. Emrush Thaçi ish- Drejtor i Burgjeve të

Kosovës njëherit Prof. Dr i Psikologjisë, Z. Nur Çeku Koordinator për AKI, Z. Dr Florian Qehaja Drejtor Ekzekutiv i QKSS(Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë), si dhe njëri ndër themeluesit e QKSS, Z. Haxhi Xhemajli Koordinator për Siguri dhe Mbikqyrje të FSK – së në Kuadër të Parlamentit të Kosovës, Prof Dr. Xhabir Hamiti – Profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, që u treguan të gatshëm të plotësonin dhe të përgjigjeshin në pyetësorët dhe pyetjet që ua parashtrova lidhur me temën time.

Nuk mund ta lë pa e përmendur dhe falënderuar edhe ndihmën e pakursyeshme si dhe këshillat që m’i ofroi Mr .Sevdail Robelli, që më ndihmuan shumë që ta përfundoj me sukses temën e doktoraturës. Një vend të rëndësishëm në këtë temë zë edhe lektori, profesor MD.Sadri Daku, i cili me punën dhe përkushtimin e tij bëri që tema të jetë shumë e kapshme, më e pranueshme për studentët dhe të gjitha nivelet e intelektualëve që kanë interesim të merren në të ardhmen me një tematikë të tillë të studimit. Përfitoj nga rasti të falënderoj të gjithë stafin e profesorëve, që më kanë dhënë mësim në të gjitha nivelet e studimit, duke marrë më të lehtë edhe analizën, sintezën, strukturimin dhe realizimin me sukses të punimit tim.

Falënderime dhe mirënjohje të pafund shkojnë edhe për familjen time, prindërit, bashkëshorten, djalin, tri motrat dhe vëllain tim, të cilët nuk e kursyen durimin e tyre dhe ndihmën, qoftë ajo morale, qoftë materiale, patën kurajën, më dëgjuan e ndihmuan shumë. Pa përkrahjen e tyre, përkujdesjen dhe dashurinë që ma ofruan nuk do të arrija të isha sot këtu para jush. U jam mirënjohës që më keni ndejtur pranë, duke dëgjuar ankesat e mia, stresin dhe ngarkesat, si dhe e keni kuptuar drejt mungesën time në momentet dhe çastet kur unë duhet të isha realisht pranë jush.

Ju faleminderit të gjithëve.

3. Abstrakti

Punimi im i doktoraturës, si një finalizimi i punës sime hulumtuese dhe shkencore, synon që të hedh dritë mbi shumë ecuri dhe procese nëpër të cilat ka kaluar dhe vazhdon të kalojë shoqëria shqiptare në Republikën e Kosovës dhe atë të Maqedonisë.

Në këtë punim jemi përpjekur që sado pak të ofrojmë një kontribut lidhur me njohjen më të saktë të terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit fetar, duke konsideruar se këto edhe janë sfidat më serioze të sigurisë jo vetëm për Republikën e Kosovës, por edhe për Republikën e Maqedonisë, si dhe për shtete të tjera të rajonit dhe më gjerë edhe në botë.

Punimi ynë është i fokusuar në grumbullimin e informatave sa më të sakta nga burime të sigurta lidhur me fenomenet e terrorizmit. Pa pretenduar se ky është një punim i përsosur, ne kemi bërë përpjekje për të sjellë disa nga përkufizimet e terrorizmit të cilat i hasim nëpër literaturën ndërkombëtare, përkufizime këto që shfrytëzohen nga shtete dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare me qëllim të luftimit dhe parandalimit të terrorizmit. Gjithashtu, jemi fokusuar edhe në paraqitjen e historikut të terrorizmit duke u ndalur në disa raste specifike e pastaj duke paraqitur edhe idetë tona për terrorizmin e shekullit XXI, i cili manifestohet në forma shumë më të avancuara se sa më parë.

Sfidat e sigurisë, sidomos terrorizmi ndërkombëtar më ka provokuar për një periudhë të gjatë kohore gjatë studimeve universitare, studimeve të Masterit, por, edhe tani në këtë shkallë të studimeve. Provokimi që më ka bërë tema si e tillë, më ka shtyrë që t'i përvjel mëngët dhe të vjel informacione që lidhen me këtë temë, të përpiqem që të shoh pak dritë në zgjidhjen e problemeve që na imponohen, madje shpesh herë pa dashje neve si shoqëri.

Ky interesim është shtuar sidomos viteve të fundit, ku shumë të rinj nga trojet shqiptare në Ballkan dhe nga shtetet e Evropës, i janë bashkuar organizatave terroriste në Lindjen e Mesme. Në këtë punim jemi përpjekur maksimalisht që të hulumtojmë dhe prezantojmë shkaqet që i kanë shtyrë këta të rinj të ndjekin një rrugë të tillë, e sigurisht që e kalaura e tyre, shkollimi, cilësia e shkollimit dhe edukimit, rrethanat e tjera sociale dhe disa faktorë të tjerë janë identifikuar si arsye që të njëjtit të kenë ndërmarrë veprime të tilla.

Ndër vlerat më të mëdha të këtij punimi, pa dyshim janë prononcimet e aktorëve të ndryshëm politik dhe jo vetëm, për terrorizmin dhe radikalizmin fetar. Gjithashtu ky punim përmban edhe të dhëna lidhur me dallimet dhe ngjashmëritë mes legjislacionit penal të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë.

Poashtu në disertacionin e doktoraturës sime, kam futur edhe shumë intervista me personat përgjegjës në fushën e sigurisë, të cilët me informacionet, profesionalizmin dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara kanë hedhur dritë mbi çështjen e cila tashmë është bërë

dukuri shqetësuese, jo vetëm për Kosovën dhe Maqedoninë,por edhe më gjerë,është bërë problem global i njerëzimit.

Është me një rëndësi shumë të madhe që të përpilohet një strategjie kombëtare për luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit,që janë fenomene të cilat nuk mund të luftohen vetëm me deklarata për shtyp, debate televizive,por duhen veprime dhe vendime konkrete dhe të koordinuara. Vetëm me një strategji të qartë, në të cilën do të angazhoheshin të gjitha njësitë sektoriale të sigurisë,që do të jetë e zbatueshme, do të kemi sukses në këtë sfidë e cila me shumë mundësi do të jetë njëra ndër sfidat kryesore të sigurisë së çdo shteti edhe në dekadat dhe mijëvjeçarin në të cilin po jetojmë .

Fjalët kyçe:ligjet, ekstremizmi, terrorizmi,dhuna dhe shkallët e saj.

4. Abstract

My Ph.D. thesis, as a finalization of my research and scientific work, aims to shed light on the many of the progress and the processes through which the Albanian society in the Republic of Kosovo and Macedonia have and are continuing to go through.

In this paper, we have tried to contribute to an accurate recognition of terrorism, radicalism and religious extremism, considering that these are also the most serious security challenges not only for the Republic of Kosovo but also for the Republic of Macedonia and other countries in the region and beyond.

My work has focused on gathering the most accurate information from secure sources regarding the terrorism phenomena. Without pretending that this is a perfect work, we have made efforts to bring some of the definitions of terrorism that are available in international literature, definitions used by different states and international organizations to combat and prevent terrorism. We have also focused on presenting the background of terrorism by focusing on specific cases and then presenting our ideas for XXI century terrorism, which is manifested into much more advanced forms than before.

Security challenges, especially international terrorism, have incited me for a long period of time, even during my undergraduate studies, master studies, but even now in this degree of study. This incitement has pushed me to roll my sleeves and collect information related to this subject, to try to shed a little light and solve the problems that are imposed on us as a society, often even involuntarily.

This interest has increased especially in recent years, where many young people from Albanian regions in the Balkans and European countries have joined the terrorist organizations in the Middle East. In this paper we have tried our best to explore and present the causes that have led these young people to follow such a path, and of course their past, education, the quality of education, other social circumstances and some others factors, which have been identified as reasons for them taking such actions.

Amongst the greatest values of this paper, are certainly the statements of the different political actors and others on terrorism and religious radicalism. This paper also contains data on the differences and similarities between the criminal legislation of the Republic of Kosovo and the Republic of Macedonia.

Also, in my PhD dissertation, I have also included many interviews with responsible persons in the field of security, who with information, professionalism and their response to the

questions asked have shed light on the issue which has already become a concern, not only for Kosovo and Macedonia, but also beyond, and is now considered a global problem for mankind.

It is of utmost importance to draft a national strategy for fighting extremism and terrorism, which are phenomena which that cannot be fought only with press releases, TV debates, but need rather concrete and coordinated actions and decisions. Only with a clear strategy that will include all of our security sector units, and which is applicable, will we succeed in this challenge that is likely to be one of the key security challenges for any country for the decades to come and the millennium in which we are living.

Key words: laws, extremism, terrorism, violence and its stairs

5. Hyrje

Skica ideore dhe plani individual i disertacionit, të cilin e keni në duar, shtjellon në detaje orientimin dhe planin profesional se si do të realizohet teza e disertacionit, e autorit të këtij punimi Mensur Morina me titull: **”EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KOSOVË NËRASTET SPECIFIKE NË PERIUdhËN KOHORE 2014-2017 ”**

Në këtë skicë ideore dhe në planin individual, elaborohen çështjet si: deklarata për bartjen e të drejtës autoriale te Universiteti i Evropës Juglindore, biografia dhe arritjet akademike, titulli i tezës së disertacionit, fusha dhe nënfusha e studimit, rëndësia e problemit studimor, kontributi i tezës për komunitet dhe industri, hipotezat dhe pyetjet kërkimore, shqyrtimi i literaturës, etika e studimit, të dhënat primare dhe sekondare, metodologjia e hulumtimit, përmbajtja (struktura) e hulumtimit, bibliografia dhe literatura e cila mendohet të përdoret në studim, planifikimi i afatit kohor të përfundimit të studimit të disertacionit, si dhe aktivitetet tjera hulumtuese.

Të gjitha këto çështje do të paraqiten më poshtë.

Për: Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë

Nga: MENSUR MORINA, PhD Cand

Datë: 12. 12. 2017

Lënda: Deklaratë për bartjen e të drejtës autoriale

DEKLARATË

Përmes kësaj deklaratë, unë Mensur Morina, i lindur me datë: 01.07.1986, në Komunën e Kamenicës, me vendbanim në Gjilan, i bart Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL) në Tetovë, të drejtat autoriale të punimit tim të disertacionit të doktoraturës, për përdorim me qëllime edukative, arsimore dhe hulumtuese.

Me respekt,

Mensur Morina

Datë: 12. 12. 2017

6. Biografia dhe arritjet akademike

Mensur Morina

Ditëlindja: 01.07.1986.

Kontakti: 00386 (0)49 491 307 e-mail:mm26941@seeu.edu.mk dhe mensur.morina@gmail.com.

Edukimi:

- 2016 Kandidat për **PhD**, drejtimi: Juridiko-Penal , Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë
- 2013-2014 Studimet pasdiplomike në lëmin Juridiko-Penal , Fakulteti Juridik, Kolegji Universitar, "FAMA" në Prishtinë.
- 2009-2013 Studimet deridiplomikenë lëmin e Kriminalistikës , Fakulteti i Kriminalistikës , Kolegji Universitar "FAMA" në Prishtinë.

Trajnimet:

- USA-MEMBER OF CONGRESS-CERTIFICATE OF APPRECIATION-WITH GREAT APPRECIATION FOR YOURS SUPPORT OF ALBANIAN AMERICAN CIVIL LEGUE'S-INTERNATIONAL CAMPAIGN FOR INDEPENDENCE OF KOSOVA NOW. PRISHTINA , JULY 2004.

- Kryqi i Kuq i Kosovës në bashkëpunim me Organizatën e Kryqit të Kuq në Gjilan mbajtën trajnim dyditor nga Rinia e KK me temën mbi :Dukuritë negative dhe Lidërshipi në shoqëri- dhe ndanë Çertifikatë . Gjilan 03-05.05.05

- Kryqi i Kuq i Kosovës në bashkëpunim me Organizatën e Kryqit të Kuq në Gjilan – organizuan trajnimin 10 ditor lidhur me Lidërshipin ,Edukimin shëndetësor dhe dhënien e ndihmës së parë dhe ndanë –Çertifikatë. Trajnimi u mbajt nga data 15-25 dhjetor 2005.

- The Balkan Trust for Democracy and KCIC Certificate For completion of there days training on Organizational Strengthening and Project Cycle Management,organized in Gjilan during the period 10-12 of November 2005.

- Partes socialadvertising –Diplomë për pjesëmarrje aktive për trajnim të gazetarëve të rinjë i mbajtur prej 14-17.01.2006.
- Rrjeti Rinor Gjilan ndanë Çertifikatë për pjesëmarrje në trajnimin dyditor me datë 04-05-.03.2006 në Vushtrri me temën :”Fuqizimi i Udhëheqësve Rinor në komunikim me masën”
- Care international -Çertifikatë për kryerjen me sukses të “Trajnimin për Promotëret e Rinjë” qershor 2006.
- World Bank dhe KCIC –Certifikatë për trajnimin Udhëheqja e organizatës dhe përpilimi i projekt propozimeve.24-25.07.2006.
- Udhëheqës i Rinisë të Kryqit të Kuq të Kosovës –Çertifikatë. 05-09-08 2006.-
- UNDP /KCIC Certifikatë- Për përfundimin me sukses të trajnimit nga rreziku për armët e vogla dhe të lehta (AVL),organizuar në kuadër të projektit “Pa armë ,për një të ardhme më të mirë” që e implementojnëp OJQ Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar-të financuar nga United Nation Development Program (UNDP). Gjilan më :23.02.2006.
- SOS-KDI Ndanë Mirënjohje për ndihmën dhe përkrahjen e fushatës “SOS Java ” në SOS -Fshatin e Fëmijëve,Kosovë.Prishtinë 23.06-02.07.2006.
- ATRC Advokacy Training and Resource Center –Certifikate –Konflikt Management, Training06-13-14.03.2007.Gjilan.
- ATRC Advokacy Training and Resource Center –Certifikate -Negotiations Training 06-07.11.2007.Gjilan.
- ALBANIAN AMERICAN NATIONAL COUNCIL-CERTIFIKATE –For attendin courses of the youth track program,(Team Building,Leadership,Project proposal,Cyrclle and Foundraising), january-april 2008
- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sporte e KK Gjilan përmes drejtorit Sadri Daku nderon me- Mirënjohje –Për organizimin e aktiviteteve rinore gjithëpërfshirëse me rini dhe organizata rinore.Gjilan 24 dhjetor 2009.
- INSTITUTE FOR TRAINING & ECONOMIC DEVELOPMENT-CERTIFIKATE for PROJECT PROPOSAL AND BUSINESS ADMINISTRATION AND FINANCE TRAINING COURSE, 17-19 May.2011 at Prishtina ,Kosovo
- OSCE Certifikate YOUTH CAPACITY BUILDING WORKSHOP,may 2011.
- Këshilli Qendror i Veprimit Rinor i Kosovës- e shpall Kryetar Nderi Z.Mensur Morinën në Kuvendin e II-të Zgjedhor të KQVR-së të mbajtur më 22 maj 2013 në Vushtrri.
- Britanica –Certifikate for succesfull completion of English Upper –Intermediate Language course 2014/2015.

- Certificate of Participation-For they contribution in the Balcans Election Exchange program organized by AK Party Istambul youth branch ,November 2015
- OSCE –Kosovë Çertifikatë për pjesëmarrje në trajnimin “Fuqizimi i Rinisë në Krijimin e Rregulloreve” 2015.

Përvoja:

- Janar 2014 – Dhjetor 2017 , Drejtor i organizatës LIZA-R.(Kjo organizatë mban një lidhje me interes zhvillimor për të ardhmen e rinisë.Misioni dhe qëllimi i kësaj organizate është: OJQ është themeluar me qëllim të integritimit,fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të rinisë në proceset demokratike.)
- Prill 2011–Gusht 2013,Kryetar i Rinisë së Kosovës, Këshilli Qendror i Rinisë së Republikës së Kosovës,(Organi më i lartë dhe suprem i përfaqësimit rinor në Republikën e Kosovës,Ligji Nr.03/L-145, Ligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë).
- Janar 2010 – Prill 2013, Kryetar i Këshillit Rinor Lokal në Gjilan, Struktura Rinore përfaqësuese më e lartë sipas ligjit për Rini.
- Korrik 2008 – janar 2010, Kryetar i Rrjetit Rinor të Gjilanit, organi më i lartë përfaqësues Rinor në nivel Lokal, (para se të miratohet Ligji Ligji Nr. 03/L-145 i cili u miratua në shtator të vitit 2009).
- Janar 2006- janar 2007 fitues i EVS për Evropë gjegjësisht në Slloveni, Ljublanë Vullnetar Aktiv Rinor i Ljublanës për një periudhë një vjeçare.
- 2000 – 2006, Trajner i Rinisë në Kryqin e Kuq
- 2008 - 2010, Trajner në fushat e ndryshme për Rini në Regjionin e Gjilanit.
- 2010 - 2014, Trajner në fushat e ndryshme për Rininë e Republikës së Kosovës.

Publikimet dhe aktivitetet tjera hulumtuese dhe shkencore:

- *Nëntor të vitit 2015* një punim i botuar në *ACADEMIC JOURNAL of Business, Administration, Law and Social Sciences E-ISSN 2410-8693/ISSN 2410-3918 IMPAKT FACTOR* me temën: “*Rritja ekonomike dhe determinantat e saj në vendet në tranzicion*”.
- *Shtator të vitit 2015* një punim i botuar në *Ballkan Journal of Interdisciplinary Research This work is licensed under A CC License of Attribution- Noncommercial- Noderivatives 4.0 International ISSN 2410-759X ISSN 2411-9725* me temën: “*Tregtimi i obligacioneve në tregjet e kapitalit* ” .

- Shtator 2015, pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të organizuar nga *INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE COMERCIAL AND COMPETITION LAW SECOND INTERNATIONAL CONFERENCE ON “ INTERDISCIPLINARY STUDIES – GLOBAL CHALLENGE 2015* me temën: “ *Tregtimi i obligacioneve në tregjet e kapitalit* ” .
- Prill 2017 , pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të organizuar nga UEJL në TETOVË me temën: “*Kqyrja e Vendit të ngjarjës tek Vrasjet* “

Më poshtë po e sjellim në formë tabelare listimin e publikimeve të mia shkencore nëpër revista, qoftë si autor i vetëm,apo edhe me bashkautorësi me kolegët në fushat respektive të studimit.Poashtu në këtë tabelë i gjeni të dhënat lidhur me pjesëmarrjen time në konferencat shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Publikimet Shkencore:		
Revistat Shkencore:		
<i>Titulli i punimit</i>	<i>Revista Shkencore</i>	<i>Viti</i>
The legal-criminal aspects of terrorism under the Criminal Code of the Republic of Kosovo and Republic of Macedonia <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	This work is licensed under Creative Commons Attribution 3.0 License. European Journal of Economics, Law and Social Sciences IIPCCL Publishing, Graz-Austria ISSN 2519-1284 (print) ISSN 2510-0429 (online) Copyright © IIPCCL-International Institute for Private, Commercial and Competition law Road Directory of Open Access Scholarly Resources DOAJ World Wide Science Global Impact Factor	Vol. 3 No. 1 January, 2019
Violent extremism leading to terrorism <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	This work is licensed under Creative Commons Attribution 3.0 License. European Journal of Economics, Law and Social Sciences IIPCCL Publishing, Graz-Austria ISSN 2519-1284 (print) ISSN 2510-0429 (online) Copyright © IIPCCL-International Institute for Private, Commercial and Competition law Road Directory of Open Access	Vol. 3 No. 1 January, 2019

	Scholarly Resources DOAJ World Wide Science Global Impact Factor	
LEGAL-CRIMINAL OVERSIGHT INTO CRIMINAL SANCTIONS FOR THE JUVENILE <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	<i>ACADEMIC JOURNAL</i> <i>ISBN: 978-9928-259-31-8</i> <i>Bialystok – Poland</i> International Institute for Private, Commercial and Competition law	<i>2018, Tetor</i> <i>Faqe,228-239</i>
KËQYRJA E VENDIT TË NGJARJES TE VEPRAT PENALE TË VRASJEVE <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	<i>ACADEMIC JOURNAL</i> <i>ISBN: 978-9928-259-20-2</i> <i>Bialystok – Poland</i> International Institute for Private, Commercial and Competition law	<i>2018, Qershor</i> <i>Faqe,30-47</i>
<i>1. Rritja ekonomike dhe determinantat e saj në vendet në tranzicion</i> <i>1.Msc.(c)Kestrim Avdimetaj</i> <i>2. Msc.Mensur Morina</i>	<i>ACADEMIC JOURNAL</i> <i>of Business, Administration, Law and Social Sciences</i> <i>E-ISSN 2410-8693/ISSN 2410-3918</i> <i>IMPAKT FACTOR</i>	<i>Viti 2015, Nëntor</i> <i>Faqe, 214-224</i>
<i>3.Tregtimi i obligacioneve në tregjet e kapitalit</i> <i>1. Msc.(c)Kestrim Avdimetaj</i> <i>2. Msc.Mensur Morina</i>	<i>Ballkan Journal of Interdisciplinary Research</i> <i>This work is licensed under A CC License of Attribution- Noncommercial- Noderivatives 4.0 International</i> <i>ISSN 2410-759X</i> <i>ISSN 2411-9725</i>	<i>Viti 2015, Shtator</i> <i>Faqe, 121-126</i>
Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare		
<i>Titulli i punimit</i>	<i>Konferenca Shkencore</i>	<i>Viti</i>
LEGAL-CRIMINAL OVERSIGHT INTO CRIMINAL SANCTIONS FOR THE	<i>Seventh international conference on: “ Education and social sciences – challenges towards the future</i>	<i>2018</i> <i>Tetor</i>

JUVENILE <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	<i>Bialystok – Poland</i>	
KËQYRJA E VENDIT TË NGJARJES TE VEPRAT PENALE TË VRASJEVE <i>1. PhD. Mensur Morina</i>	<i>Sixth international conference on: “ Education and social sciences – challenges towards the future Bialystok – Poland</i>	2018 Qershor
<i>Kqyrja e Vendit te ngjarjes tek Vrasjet 1. PHD. Mensur Morina</i>	<i>Universiteti i Europes Juglindore Juridiko – Penal</i>	Viti 2017 Prill
<i>Tregtimi i obligacioneve në tregjet e kapitalit 1. Msc.(c).Kestrim Avdimetaj 2. Msc.Mensur Morina 3. Msc.(c).Valmir Zogaj</i>	<i>INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE COMERCIAL AND COMPETITION LAW SECOND INTERNATIONAL CONFERENCE ON “ INTERDISCIPLINARY STUDIES – GLOBAL CHALLENGE 2015</i>	Viti 2015 Shtator

Tabela 1.Publikimet në revistat shkencore si dhe pjesëmarrja në konferencat shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare

Gjuhët:

- **Shqip** (gjuhë amtare).
- **Anglisht:** Shkrim: **3**. Lexim: **3**. Të folurit: **4**.Të kuptuarit: **4**.
- **Turke:** Shkrim: **5**. Lexim: **5**. Të folurit: **5**.Të kuptuarit: **5**.

Afrësitë kompjuterike:

- Microsoft Word: **5**.
- Microsoft Excel: **4**.
- Power Point: **5**.

7. Titulli i tezës së doktoraturës

Titulli i tezës së doktoraturës i propozuar nga autori (Mensur Morina):

”EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KOSOVË NË RASTET SPECIFIKE NË PERIUdhËN KOHORE 2014-2017 ”

8. Fusha e studimeve

Kjo tezë e disertacionit të doktoraturës bënë pjesë në kuadër të fushës së studimeve E drejta e procedurës penale (me E drejtë penale, E drejtë penale për të mitur, E drejtë penale ndërkombëtare dhe Kriminalistikë).

9. Rëndësia e problemit studimor

Studimi i ekstremizmit të dhunëshëm në rastet specifike në Republikën e Kosovës është i rëndësishëm të studiohet gjatë periudhës 2014-2017 për disa arsye kryesore.

1. Kjo fushë është e rëndësishme të studiohet për arsye se, deri tani kjo fushë nuk është studiuar nga studiuesit në mënyrë të mirëfilltë dhe të detajuar.

2. Pse studimi i Ekstremizmit të dhunëshëm në rastet specifike në Kosovë është i rëndësishëm të studiohen gjatë periudhës 2014-2017?. Sepse Ekstremizmi i dhunëshëm dhe radikalizmi në Kosovë gjatë kësaj periudhe ka pasur sfida dhe ndryshime të mëdha, duke u nisur nga ndikimi i faktorëve të jashtëm, faktorëve të brendshëm, religjioni, sistemi i sigurisë, mos ekzistimi i ligjit, mungesa e zbatimit të saj pas miratimit të ligjit, rekrutimi i një numri të madh të qytetarëve të Kosovës në zonat e luftës në lindjen e mesme dhe gjetiu, krijimi i legjislacionit të mirëfilltë, trajnimet në fushën e sigurisë dhe akterëve të saj, menaxhimi i situatave të sigurisë.

3. Përveç kësaj, pse Ekstremizmi i dhunëshëm në rastet specifike në Kosovë është i rëndësishëm të studiohet gjatë periudhës 2014-2017?.

4. Sepse, çështja e tillë ishte e rregulluar formalisht meligjin e nxjerrur në vitin 2014, dhe kjo tregon se gjatë kësaj periudhe mundësia e rritjes së kësaj dukurie ka qenë prezente dhe e paparandalueshme.

5. Gjithashtu është e rëndësishme të studiohen, ngase Sistemi i Sigurisë gjatë kësaj periudhe pati reforma të mëdha, si në rregullimin e infrastrukturës Ligjore, ngritja e kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë nga akterët ndërkombëtar, delegimin e kompetencave nga ato ndërkombëtare tek ato lokale.

10. Kontributi i tezës për komunitetin dhe shoqërinë

Pritje e autorit (Mensur Morina) është që kërkimi shkencor të ketë zbatim në komunitet. Zbatimi në komunitet i referohet tri fushave kryesore, që janë :

1. **Kontributi për shkencën-** Deri tani nuk është realizuar asnjë hulumtim i kësaj natyre. Pra, është hulumtimi i parë për Ekstremizmin e dhunëshëm në raste specifike në Kosovë gjatë periudhës kohore 2014-2017. E veçanta tjetër e këtij hulumtimi për kontributin rreth shkencës është tërësia e metodave të cilat do të përdoren për realizimin e hulumtimit. Konkretisht, do të nxirret në sipërfaqe kontributi për shkencën në sektorin e Drejtësisë, Sigurisë, Agjencive të sigurisë.

2. **Institucionet shtetërore** të cilat merren me hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë dhe të drejtësisë. Veçanërisht, konkluzionet dhe rekomandimet e hulumtimit do të jenë të rëndësishme për të kuptuar efektin e deritanishëm të menaxhimit të Ekstremizmit të dhunëshëm dhe kahjet e reformimit të sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes . Institucionet kryesore në Kosovë që mund të përdorin rezultatet e këtij hulumtimi janë: Ministria e Punëve të Brendshme, më konkretisht Departamenti për Terrorizëm në Kuadër të Policisë së Republikës së Kosovës, Inspektorati i Policisë në Republikën e Kosovës, Agjencionit të Shërbimeve Sekrete AKI në Republikën e Kosovës, Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Jashtme në Republikë e Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë në Republikë e Kosovës, Ministrisë së Integriteteve Europiane në Republikën e Kosovës, Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, gjegjësisht Departamentit për Rini, sektorit për siguri në kuadër të këtij departamenti, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Drejtorët e shkollave, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe qendrat e ndryshme që merren me këtë dukuri, etj.

3. **Partnerët dhe donatorët e jashtëm** të cilët mund të përdorin rezultatet e hulumtimit janë pikërisht partnerët dhe donatorët të cilët kanë mbështetur sektorin e Sigurisë në Republikën e Kosovë, si: KFOR-i , Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (UNDP), Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, USAID-i, GIZ-i , TIKA, EULEX, OSCE, KSCS dhe donatorë dhe partnerët tjerë të jashtëm.

11.Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

Hipotezat kryesore të hulumtimit janë:

1. Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në periudhën 2014-2017 ka qenë nën ndikimin e një numri të madh të faktorëve të jashtëm. Pjesëmarrja e të rinjëve dhe qytetarëve kosovarë në luftrat e lindjes së mesme, gjatë kësaj kohe ka qenë gjithnjë në rritje, ndërsa në anën tjetër Qeveria e Kosovës punonte në krijimin e një sistemi të ri shoqëroro-ekonomik, me qëllim të zhvillimit të Kosovës dhe njohjes së saj në aspektin ndërkombëtar, gjë që rezultoi edhe me krijimin e një legjislacioni të ri të Sigurisë dhe menaxhimit të saj në kushte të reja. Kjo ndikoi në rritje të angazhimit politik, strategjik dhe të sigurisë me qëllim të sendërtimit të politikave të reja publike në të gjitha sferat e jetës. Në rritje është edhe trajnimi , gjegjësisht ngritja e kapaciteteve të sektorëve të sigurisë , ngritja e cilësisë së shërbimeve dhe e metodave të reja në këtë fushë. Integrimi i komuniteteve në përgjithësi, plotësimi i standarteve nga ana e Kosovës të përcaktuara nga Bashkimi Europian, Lufta e Terrorizmit dhe Kontrabandës, anëtarësimi i saj në mekanizma ndërkombëtare të sigurisë, antarësimi në NATO, BE, Liberalizimi i Vizave, Lëvizja e lirë, MSA etj.

2. Njohja dhe parandalimi i herëshëm i dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm, ndikon pozitivisht në ngritjen e cilësisë dhe sigurisë në Kosovë.

3. Mosharmonizimi i mirë i legjislacionit dhe paqartësia ligjore e kompetencave në mes të strukturave qendrore dhe faktorit ndërkombëtar në Kosovë në aspektin e Sigurisë ndikon në politizim dhe në uljen e cilësisë së menaxhimit të kësaj dukurie.

4. Mosgatishmëria për ndryshime e stafit të institucioneve gjegjëse për të qenë më profesionale, kanë ndikuar në performancën jo të mirë të gjendjes së sigurisë në Kosovë.

5. Menaxhimi i kësaj dukurie nga ata që e kanë të përfunduar magjistraturën dhe kanë bërë specializim jashtë vendit në këtë lëmi, apo trajnime të specializuara nga organizatat ndërkombëtare për këtë fushë, do të ndikojë më shumë në ngritjen e cilësisë në parandalim e hershëm të kësaj dukurie ,sesa ata që nuk e kanë të përfunduar asnjë trajnim specialistik të kësaj fushe.

6. Programet për siguri, parandalim të hershëm dhe menaxhim profesional të kësaj natyre, kanë ndikuar shumë në implementimin e reformës në sistemin e sigurisë dhe të parandalimit të hershëm të ekstremizmit që çon në Radikalizëm e më pastaj në terrorizëm në vitet 2014-2017.

Fjalët kyçe: Kosovë, ekstremizëm, siguri, sfidë, i dhunshëm, menaxhim, legjislacion, reformë, parandalim, terrorizëm, radikalizëm .

Pyetjet kërkimore të punimit janë:

1. Cilat ishin sfidat e menaxhimit të sigurisë në Kosovë gjatë periudhës 2014-2017?
2. Cili është roli i Qeverisë së Kosovës në menaxhimin e situatave të dhunshme?
3. Cili është roli i legjislacionit në ngritjen e cilësisë në menaxhimin e sigurisë?
4. Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë?
5. Cili është roli i studentëve që e kanë të përfunduar magjistraturën në këtë lëmi apo trajnimin për këtë fushë në krahasim me ata që nuk e kanë të përfunduar.
6. Cili ishte roli i programeve të ofruara në menaxhim, parandalimin e situatave të ekstremizmit të dhunshëm në implementimin e reformës në sistemin e sigurisë 2014-2017?

12. Shqyrtimi i literaturës

Shqyrtimi i literaturës është pjesa e cila vjen menjëherë pas Hyrjes dhe Metodologjisë. Rishikimi i literaturës i referohet operacionalizimit teorik të tri koncepteve themelore të temës së hulumtimit:

1. Operacionalizimi teorik i konceptit Ekstremizëm. Ekstremizmi “ Nocioni Ekstremizëm. Fjala “ekstremizëm”, rrjedh nga fjala latine “ extremus “, që do të thotë “iskajshëm”. (Në gjuhën gjermane, kjo fjalë përkthehet edhe në kuptimin “më i largmi”, “i zemëruari”, etj. Joseph Maria Stowasser „Stowassers Lateinwörterbuch“, Wien - München 1998, fjali latinisht – gjermanisht; fjala extremus: „das Äußerste, das Entfernteste, das Ärgste). Sipas këtij kuptimi, fjala “ekstremizëm”, për herë të parë është përdorur gjatë vitit 1789, në Kuvendin Kombëtar të Francës, kur kërkesat politike të disa deputetëve, kishin filluar të vlerësohen si “majtiste” ose “djathtiste”, varësisht nga pozicioni i tyre ndaj qëndrimeve politike të shumicës, që konsiderohej “mesishoqëror” (Krasniqi, Kolë, Terrorizmi Ndërkombëtar, D. 2010:290). Në kuptimin politik fjala “ekstremizëm”, shpjegohet si kundërshtim i normave, parimeve dhe përgjithësisht rregullimit demokratik të një shteti. Ekstremistët djathtistë, përmes trajtimit të problemeve të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe politike, vetëm në kontest të një faktori, i sulmojnë vlerat themelore

të shtetit demokratik, si parimin e ligjshmërisë, parimin e pluralizmit, parimin e tolerancës, parimin e humanitetit, etj(Krasniqi, Kolë, Terrorizmi Ndërkombëtar, D. 2010:290).

2. “Ekstremizmi”, është emërtim i përbashkët i kuptimeve dhe veprimeve të ndryshme kundër demokratike të karakterizuara me elementet e saj tradicionale ideologjike, që janë: nacionalizmi (kombi dhe vlerat e ndryshme kombëtare trajtohen si vlerat më të larta shoqërore “kombi mbi të gjitha”), autoritarizmi (e trajton shtetin si vlerën më të lartë shoqërore, e jo si instrument shoqëror), antipluralizmi (e mohon pluralizmin politik si element themelor të sistemit demokratik. Pluralizmi prezantohet si element destruktiv dhe glorifikohet monizmi politik i karakterizuar me përpjekjet për identifikimin e qeverisë dhe shtetit me popullin), racizmi (i karakterizuar me trajtime të pabarabarta dhe diskriminime të personave në bazë të përkatësive të ndryshme), antisemitizmi (i karakterizuar me nxitje të urrejtjes dhe disponimit kundër izraelitëve). Nga këto kuptime mund të thuhet se me fjalën ekstremizëm përfshihen manifestimet e caktuara politike, të cilat mbështeten në elemente të ndryshme ideologjike. ((Krasniqi, Kolë, Terrorizmi Ndërkombëtar, D. 2010:292).

3. Ekstremizmi i dhunshëm është "Inkurajimi, falja, justifikimi ose mbështetja e kryerjes së një veprimi të dhunshëm për të arritur qëllime politike, ideologjike, fetare, sociale ose ekonomike" .(<https://cve.fbi.gov/whatis/>).

4. Në politikë, ideologjitë ekstreme konsiderohen zakonisht ato që i përkasin të majtës ekstreme ,të drejtës ekstreme, ose fundamentalizmin fetar. Idhtarët e këtyre ideologjive ose lëvizjeve nuk janë quajtur kurrë ekstremistë, por, janë më të prirur të quhen radikalë. Për këtë arsye, termi radikalizmi sot është bërë i njohur si një lloj eufemizmi apo zbutjeje për ekstremizmin .

13. Etika

Për gjatë gjithë realizimit të hulumtimit do të merren parasysh çështjet etike. Etika “Parimet etike duhet të jenë në ballë të çdo projekti hulumtues dhe duhet të vazhdojnë deri në fund të hulumtimit”(Wellington, J. 2000:p.3). Në rastin e hulumtimit tonë, etika duhet të jetë në ballë të punimit ,duke i ruajtur parimet etike në të gjitha fazat e realizimit të hulumtimit. Pra, synimi kryesor i autorit është që të ruaj parimet etike, standardet morale gjatë realizimit të fokus grupit, intervistave gjysmë të strukturuar, anketave me pyetësor të strukturuar etj.

14. Të dhënat e mbledhura primare dhe sekondare

Në këtë hulumtim të dhënat e mbledhura janë primare dhe sekondare:

1. Të dhënat primare janë të dhënat e mbledhura nga autori i hulumtimit. Këto të dhëna janë mbledhur përmes metodës së: fokusgrupeve, eksploruese me ekspertët e Policisë, intervistave gjysmë të strukturuar me përgjegjësit, bërësit e politikave dhe menaxhuesit e sistemit të sigurisë, si dhe anketimi me pyetësor të strukturuar me Deputetet e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Mbikqyrje të AKI-s, Komisioni për Siguri dhe Mbikqyrje të FSK-së. Pra, të dhënat parësore janë "Ato të dhëna që hulumtuesi apo një pjesëtar i ekipit tonë i mbledh drejtpërsëdrejti" (Leksionet e dhëna në lëndën: Metodatat e Kërkimit, me Prof. Dr. Hasan Jashari, datë: 29. 11. 2016, vendi: Universiteti i Evropës Jug – Lindore- Tetovë).

2. Të dhënat sekondare janë: publikimet nga Institucionet, Ministrinë, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që i referohen Ekstremizmit të dhunëshëm në Kosovë etj. Pra, të dhënat dytësore janë "Të dhëna të mbledhura nga dikush tjetër -që nuk është pjesë e ekipit tonë" (Leksionet e dhëna në lëndën: Metodatat e Kërkimit, me Prof. Dr. Hasan Jashari, datë: 29. 11. 2016, vendi: Universiteti i Evropës Jug – Lindore- Tetovë). Po ashtu, të dhëna sekondare janë edhe publikimet e programeve dhe projekteve për siguri të cilat janë implementuar në Kosovë. Veçanërisht, do të merren në analizë publikimet e projektit të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian, GIZ-it, USAID-it, UNDP-së, OSCE, KSCS, etj.

15. Metodologjia e hulumtimit

Metodat kryesore të cilat do të përdoren në punim janë:

1. Metoda e fokus grupit eksplorues. Kështu "fokus grupi" është një metodë për mbledhjen e të dhënave cilësore, ndryshimi është se fokus grupi (siç e thotë edhe vet emri) largohet nga intervistat tek për tek, dhe bëhet një intervistë në grup (Matthews, B. dhe Ross, L. 2012:235). Tri janë karakteristikat e fokus grupit. "Bashkon një grup prej 5 deri në 13 vetë; të cilët kanë diçka të përbashkët që lidhet me temën e hulumtimit; për të marrë pjesë në një diskutim për këtë temë, që moderohet nga hulumtues" (Matthews, B. dhe Ross, L. 2012:235). Kjo metodë përdoret me ekspertët e fushës së sigurisë për të kuptuar çështjet më të rëndësishme që i shohin ata sa i përket parandalimit dhe menaxhimit të ekstremizmit të dhunëshëm në Kosovë gjatë periudhës 2014-2017.

2. Metodatat e përziera (cilësore dhe sasiore), "Metodat e përziera mund të mendohen si kombinim i metodave sasiore dhe cilësore në mënyrën që i përshtatet më mirë projektit

konkret. (Matthews, B. dhe Ross, L. 2012:235). “Metodat cilësore zgjidhen kur dëshirojmë të mbledhim të dhëna që janë të pa strukturuara,si:mendime,bindje,rrëfime”,ndërsa “metodat sasiore zgjidhen kur dëshirojmë të mbledhim dhe të përpunojmë të dhëna të strukturuara,të cilat mund të paraqiten në mënyrë numerike,ku pyetja e kërkimit parashtrohet si hipotezë e testuar dhe mund të testohet përmes numërimit dhe analizës statistikore”.(F.Azemi, B., dhe Bujari, R. 2013:86). Metoda e intervistës gjysmë të strukturuar me përgjegjësit,bërësit e politikave dhe menaxhuesit e sistemit të sigurisë.Karakteristikat kryesore të kësaj metode janë:Përdorni të njëjtin grup temash apo pyetjesh për çdo intervistë. 2. Temat apo pyetjet mund të paraqiten në rend apo mënyra të ndryshme,siç mund të jetë e përshtatshme për çdo intervistë.3.Lejoni pjesëmarrësit t’u përgjigjen pyetjeve apo të diskutojnë për çështjen në mënyrën e tyre, duke përdorur fjalët e veta”(F.Matthews dhe Ross, vep.cit., f. 221).3.Anketimi me pyetësor të strukturuar me drejtorët e departamenteve të sigurisë në Kosovë.Kështu,“Anketimi shënon atë pjesë të kërkimit social–shkencor në të cilin me anë të instrumenteve të njëjta dhe të standardizuara p.sh.pyetësorëve,shkallëzimeve etj., individët pyetën nga intervistuesi për çfarë do teme si rregull gojarisht,por,nganjëherë edhe me shkrim” (Feraj, H. 2007:271). Anketimi me pyetësor të strukturuar përdoret me rastin e hulumtimit të cilësisë.

3. Metoda e shqyrtimit të literaturës ekzistuese që ka të bëjë me këtë temë,librave të ndryshëm,ligjeve,rregulloreve,udhëzimeve administrative, strategjive,publikimeve hulumtuesenga organizatat jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që merren me këto çështje,publikime nga Institucionet e Sigurisë së Kosovës etj.Shtjellimi i koncepteve teorike,si:Ekstremizëm,Menaxhim,Radikalizëm,Parandalim edhe sinteza e këtyre koncepteve;po ashtu,kategoritë kryesore të kontekstit të sigurisë dhe menaxhimit, parandalimit të ekstremizmit të dhunëshëm,përkatësisht procesi hulumtues i këtyre subjekteve bëhet duke analizuar literaturën dhe publikimet ekzistuese.

16. Përmbajtja (struktura) e tezës së doktoratës

Tabela e përmbajtjes

Parathënie

Abstrakti

Hyrje

Metodologjia

Shtrimi i problemit për studim

Identifikimi i problemit

Hipotezat / pyetjet kërkimore

Metodologjia e hulumtimit

Etika dhe rëndësia e studimit

Etika e hulumtimit

Rëndësia e studimit

Strukturimi i studimit

17.Shkurtesat

KPK -Kodi Penal i Kosovës,

KPM- Kodi Penal i Maqedonisë

KPPK-Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

LPPFFT- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

SHBA- Shtetet e Bashkuara të Amerikës

AQ- Al Qaeda

OBL- Osama Bin Laden

FBI- Federal Byro of Investigation/ Byroja Federale e Hetimeve

CIA- Central Information Agency/ Agjencia Qendrore e Informatave

PLO- Palestinian Liberation Organisation/ Organizata per Çlirimin e Palestinës

IRA- Irish Republikan Army/ Armata Republikane Irlandeze

ETA- Euskadi Ta Askatasuna/ Atdheu dhe Liria Baske

BR- Brigade Rose/ Brigadat e Kuqe

LTTE-Tigrat Tamil

NATO- North Atlantic Traety Organisation/ Traktati i organziatës së Atlantikut të Veriut

OKB -Organizata e Kombeve të Bashkuara

EU- European Union/ Bashkimi Evropian

OSCE- Organisation for Security and Cooperation of Europe/ Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

UNMIK- Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

KFOR- Kosovo Forces/ Forcat në Kosovë(Misioni Ushtarak Ndërkombëtar në Kosovë)

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

PK- Policia e Kosovës

FSK- Forcat e Sigurisë së Kosovës

AKI- Agjencia e Kosovës për Intelejencë

VERLT-Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism/ Ekstremizmi dhe Radikalizimi i Dhunshëm që Shpie në Terrorizëm

MISH- Mjetet e Improvizuara Shpërthyesë

ISIS- Islamic Stata of Iraq and Syria/ Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë

PJESA I

KAPITULLI I:

1. Historiku i ekstremizmit

1.1 Historiku i ekstemizmit dhe veprimi i tyre organizativë

Terrorizmi, në manifestime formash të ndryshme ka ekzistuar gjatë tërë historisë dhe për lloje të ndryshme të ideologjive politike. Fjala terrorizëm ka aq shumë definicione po aq sa ka edhe organizata dhe grupe terroriste. Ky term ka kuptim të ndryshëm për njerëz të ndryshëm, dhe përpjekjet për ta definuar saktë këtë term kanë qenë të vështira. Por, qëllimi kryesor i gjetjes së një definicioni sa më gjithëpërfshirës për terrorizmin është të bëhet dallimi i tij nga format e tjera të përdorimit të dhunës, qoftë dhunës së përdorur nga shteti dhe përfaqësuesit e tij, qoftë nga individët, grupet terroriste, por, edhe nga grupet tjera të karakterit kryengritës apo kriminal.

Terrorizmi është një teknikë me histori mijëra vjeçare dhe përdorim nga grupe të ndryshme, shqetësimi më akut për qeveritë e sotme janë grupet që operojnë aktualisht. Grupet terroriste janë përshtatur me ndryshimin e rrethanave. Shpesh herë gjatë Luftës së Ftohtë grupet terroristegëzonin mbështetjen e Bashkimit Sovjetik, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose aleatëve të tyre respektiv. Sot nuk ekzistojnë superfuqi ushtarake konkurruese dhe mbështetja e hapur ndaj grupeve terroriste mund të prodhojë një përgjigje masive ushtarake si në rastin e regjimit të Talebanëve në Afganistan. Si kundërpërgjigje, organizatat terroriste kanë zhvilluar rrjete që sigurojnë asistencë të ndërsjellë. Grupet si AlQaeda, kanë tanimë struktura të cilat gjasojnë në disa aspekte me ato të rrjeteve kriminale shumë kombësie. Grupet terrosite kanë zhvilluar lidhje edhe me organizatat kriminale, veçanërisht me ato që janë të përfshira në tregtinë e drogës. Terroristët dhe kartelet e drogës përfitojnë nga qeveritë e dobëta, të cilat e kanë të vështirët t'i ndalojnë aktivitetet e tyre. Këto rrjete ndërkombëtare të lidhura lirshëm mund të jenë të vështira për t'u sulmuar dhe mposhtur. (Alan Collins, Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Përkthyer nga Enri Hide, Botuar nga UET Press, Tiranë, faqe 363)

Termi "terrorizëm" paraqitet dhe interpretohet në forma të ndryshme. Vetë fjala "terrorizëm" paraqet një sintezë të emrit latin terror dhe sufiksit latin, por, me prejardhje greke "izm". Fjala terror rrënjët e veta i ka në foljen "tras" e cila do të thotë dridhje. Haset në fjalët greke "ipe", në atë perse "tresidan", latine "ters", pellazge "terr" ... që nënkupton errësirën e

thellë e të plotë,botën pa dritë,por,edhe tmerrin,trishtimin,shkaktimin e frikës dhe të dridhjes; dhunën politike,deri te shkatërrimi fizik i kundërshtarit.(Dr. Boaz Ganor, ``Defining Terrorism: Is one man`s terroriste another man`s fridom fighter?``, Internacional Policy Institut of Counter-Terrorism, Herzlyia Israel, 24 September, p, 6)

Pra, mund të rumbullaksojmë se shprehja terrorizëm rrjedh nga gjuha latine“terror”që do të thotë frikë.Së këndejmi,terrorizmi në kuptimin më të gjerë është përdorim i dhunës apo kërcënimit me qëllim të shkaktimit të frikës dhe të pasigurisë ndaj individëve,grupit të qytetarëve apo të mirave materiale.(Dr.Ismet Salihu,E drejta Penale,Pjesa e Posaqme, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p. 61).

Definicionet më efektive të terrorizmit përfshijnë tre faktorë:*thelbin e tij*(dhunën ose kërcënimin për përdorim të dhunës);*cakun e tij*(civilët dhe personat që nuk marrin pjesë në veprime luftarake);dhe *qëllimin e tij* (të fitojë ose mbajë ndonjë formë të fuqisë politike duke instaluar frikë dhe duke detyruar dhunshëm disa ndryshime politike dhe sociale).

Me aktet terroriste kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime)të dhunshme e të kundërligjshme kundër jetës e shëndetit të njerëzve, lirisë vetjake të tyre, vepra këto të kryera me faj.(Ismet Elezi, E Drejta Penale, pjesa e posaqme, Botimi Tiranë, faqe 370)

Terrorizmi definohet si dhunë sistematike dhe e organizuar ndaj subjektit pasiv,ndaj të cilit shkaktohet apo krijohet ndjenja e pasigurisë dhe e frikës, me qëllim të nënshtrimit politik të tij apo me qëllim që te subjekti pasiv të shkaktohet mosbesimi ndaj regjimit ekzistues shoqëror dhe ashtu t`i imponohet pushteti politik i terroristëve për eksploatim dhe nënshtrim. Njëherit,me këtë dhunë ushtrohet ndikimi në pushtetin politik,për të nxjerrë nga ai koncesione të caktuara politike.(Sreten Kovacevic, “Terorizam i Jugoslavia”, Beograd 1992, Faqe 8, Cituar sipas Haki DEMOLLI, “Terrorizmi`, Prishtinë 2002, p, 7)

Në aspektin shoqëror,terrorizmi interpretohet si përdorim i drejtpërdrejtë dhe i organizuar i dhunës,kryesisht nga grupe e organizata të gatshme që në mënyrë fizike,duke përshtirë edhe atentatet, vrasjet, marrjen e pengjeve, me qëllim të imponimit të vullnetit të tyre shtetit dhe shoqërisë, të ngjallin terror psikik ndaj masës së gjërë, duke shkaktuar kompleksin e frikës personale e kolektive,pasiguri,shqetësim e apati.(Shkodrani A.,”Terrorizmi dhe shërbimet sekrete”, Tiranë 2010, p,26, cituar sipas V. Latifi, I. Elezi,V. Hysi, : Politika e Luftimit të Kriminalitetit”, Juridica ,Prishtinë 2012, faqe 141)

Por,problemi kryesor,i cili ka ndikuar dhe ndikon drejtpërdrejtë në gjetjen e një përkufizimi adekuat të terrorizmit është fakti se asnjë definicion ,sado gjithpërfshirës të jetë, nuk mund të përfshijë të gjitha format e paraqitjes së terrorizmit, sepse format e paraqitjes

kanë evoluar historikisht duke pësuar ndryshime në taktika, mjete të përdorura e caqe të atakuara.

Organizata e Kombeve të Bashkuara po ashtu ka dështuar që të shtojë një definicion, i cili do të ishte i vlefshëm për të gjitha shtetet e kësaj organizate, përkundër përpjekjeve të shumta dhe të vazhdueshme.

Interesat gjeo-strategjike dhe aleancat e deklaruara dhe të pa deklaruara të shteteve, po ashtu kanë ndikuar në mospajtimet lidhur me definimin e terrorizmit, sepse ajo që është organizatë terroriste, grup terrorist apo akt terrorist për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj, nuk është organizatë grup apo akt terrorist për Rusinë dhe aleatët, dhe e kundërta. Shembull konkret që shpërfaqet në këtë inkonsekuencë është Hamas-i, i cili nga SHBA-të konsiderohet organizatë terroriste, ndërsa nga Rusia konsiderohet si lëvizje e politike, ose derisa Ushtria Çlirimtare e Kosovës konsiderohej dhe vazhdon të konsiderohet si organizatë terroriste nga Rusia, në anën tjetër nga SHBA-të dhe shtetet tjera është konsideruar si një lëvizje çlirimtare, e cila është përkrahur fuqishëm. Rregulli “terroristi i dikujt është çlirimtari i dikujt tjetër” është edhe më tutje i pranishëm.

Dallime të tilla në cilësimin si organizatë terroriste të një organizate të caktuar hasim edhe mes aleateve siç janë: SHBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar. Derisa nga SHBA-të Hezbollah-u në tërësi konsiderohet si organizatë terroriste, Mbretëria e Bashkuar nuk ka qëndrim të tillë, sepse vetëm krahun ushtarak të Hezbollah-ut e konsideron si grup terrorist, ndërsa krahun politik e konsideron si një lëvizje radikale islamike.

Në çështjen e përkufizimit të terrorizmit hasen dallime edhe brenda vetë organizatave dhe institucioneve të një shteti, të cilat merren me luftimin e terrorizmit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës varësisht se me çfarë forme dhe në çfarë niveli një institucion shtetëror merret me luftimin e terrorizmit, hasen definicione të ndryshme.

Departamenti Amerikan i Shtetit (Department of State) për nevoja dhe qëllime të saj ka modifikuar një definicion, sipas së cilit: “Terrorizmi është akt i paramenduar, dhunë e motivuar politikisht e ushtruar ndaj personelit që nuk është përfshirë në betejë (non-combatant), nga grupe ose individë klandestinë (ilegal), zakonisht me qëllim të ndikimit në opinion (audiencë)”. Nick Pratt, “Terrorism; History & Causes, Yesterday”, faqe 6, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish-Partenkirchen, Gjermani

Byroja Federale e Hetimeve (FBI), konsideron se: "Terrorizmi është akt jo ligjor i përdorimit të forcës ose dhunës kundër qytetarëve ose pasurisë për të penguar ose detyruar qeverinë, popullatën civile, ose ndonjë segment të saj, me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre politike ose sociale". (Nick Pratt, "Terrorism; History & Causes, Yesterday", p. 7, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK, "European Centre For Security Studies", "George C. Marshall", Garmish-Partenkirchen, Gjermani)

Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve (Department of Defense) po ashtu në një definicion të modifikuar për nevojat dhe qëllimet e saj konsideron se: "Terrorizmi është akt i përllogaritur i përdorimit të dhunës në mënyrë që të ushqejë frikën, me qëllim që të pengojë ose detyrojë qeverinë dhe shoqërinë, për të arritur qëllimet e tyre që zakonisht janë politike, religjioze ose ideologjike". (Nick Pratt, "Terrorism; History & Causes, Yesterday", faqe 6, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK, "European Centre For Security Studies", "George C. Marshall", Garmish-Partenkirchen, Gjermani)

Një shtet tjetër shumë i angazhuar në luftën kundër terrorizmit dhe njëkohësisht shumë i kërcënuar, madje disa herë i atakuar është edhe Mbretëria e Bashkuar. Ky shtet ka një definicion mjaft të gjërë lidhur me terrorizmin. Terrorizmi përfshinë të gjitha veprimet ku përdorimi i dhunës ose kërcënimi është projektuar për të ndikuar në qeveri apo për të trembur opinionin publik ose një pjesë të publikut. Përdorimi i dhunës ose kërcënimi është bërë me qëllim të avancimit të një kauze politike, fetare apo ideologjike, që përfshin dhunën serioze kundër një personi apo shumë personave, dëme serioze në pronë; rrezikon jetën e një personi, përveç personit që ka kryer veprimin; që krijon një rrezik serioz për shëndetin apo sigurinë e publikut ose një pjesë të publikut; që është veprim i dizajnuar të ndërhyjë seriozisht që të ndërpriten komunikimet me sistem elektronik, përfshirë edhe veprimet jashtë Mbretërisë së Bashkuar". (Nick Pratt, "Terrorism; History & Causes, Yesterday", faqe 6, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK, "European Centre For Security Studies", "George C. Marshall", Garmish-Partenkirchen, Gjermani)

Për të arritur deri te një definicion mbi terrorizmin duhet të merren parasysh disa veçori të grupeve terroriste, të akteve terroriste si dhe të qëllimeve që synohen të arrihen me kryerjen e aktit terrorist.

Vetitë dhe elementet kryesore të terrorizmit janë: përdorimi i dhunës apo kanosjes sistematike të organizuar; ushtrimi i dhunës nga grupe të caktuara politike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, pasigurisë dhe mosbesimit në pushtet të masat e gjera; asgjësimi i njerëzve dhe të mirave materiale me përmasa të mëdha; nxjerrja e koncesioneve të caktuara politike;

fitimi i pushtetit shtetëror mbi territorin e caktuar, publiciteti dhe tërheqja e vëmendjes së opinionit ndërkombëtar.(Prof. Dr. Vesel Latifi, "Kriminalistika", Prishtinë 2001, p, 310)

Motivi i sulmit i cili mund të jetë politik apo ideologjik, qëllimi që synohet të arrihet, dhuna e përdorur apo kërcënimi për përdorimin e dhunës, aktiviteti i organizuar, por edhe individual i grupeve ilegale jo shtetërore, përzgjedhja e qëllimshme e civilëve si cak i sulmit, krijimi i frikës dhe panikut, fitimi i publicitetit me anë të kryerjes së aktit terrorist dhe vazhdimësia e akteve terroriste, janë disa nga karakteristikat, të cilat ndihmojnë në përpilimin e një përkufizimi lidhur me terrorizmin. Së këndejmi, për të arritur deri te një përkufizim sa më i pranueshëm lidhur me terrorizmin, duhet që në mënyrë kumulative një akt i kryer t'i përmbajë këto elemente, apo disa prej këtyre elementeve për t'u klasifikuar si akt terrorist. Në rastet kur një institucion shtetëror ushtron akte terroriste ndaj një pjesë të qytetarëve të vet, çfarë ishin veprimet e shtetit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1990-1999, ky do të konsiderohej terror ose terrorizëm shtetëror. Megjithë këtë, në rrethanat kur i njëjti institucion shtetëror (apo ndonjë institucion tjetër) ushtron dhunë dhe ndërmer akte terroriste edhe ndaj ndonjë shteti tjetër ose ndaj qytetarëve të atij shteti kudo në botë, atëherë do të kishim një situatë tjetër dhe ky më nuk do të ishte terror shtetëror, por terrorizëm shtetëror i ushtruar kundër një shteti tjetër.

Si përfundim mund të konstatojmë se terrorizmi është akt i përdorimit të dhunës apo kërcënimit me përdorim të dhunës serioze kundër qytetarëve, institucioneve shtetërore apo përfaqësuesve të tyre dhe përfaqësuesve të shteteve të huaja, dhunë e cila shkakton pasoja në njerëz e pronë dhe e cila ndikon në frikësimin e qytetarëve, duke i detyruar institucionet të veprojnë apo mos veprojnë lidhur me një çështje të caktuar, në mënyrë që më pas të arrihen synimet politike, ideologjike, religjioze e financiare.

Rastet e kryerjes së terrorizmit për arritjen e qëllimeve të caktuara politike, ideologjike a religjioze janë të njohura që nga shekulli i epokës së re. Sekti Zealots në Palestinë gjatë viteve '66- '73 kishte elemente të një lëvizjeje sociale, por, më tepër ishte një lëvizje radikale anti-romane, e cila si shënjestër kishte hebrenjtë, bashkëpunëtor me pushtuesit roman. Duke përdorur disa lloje të shpatave të vogla, ata shpesh sulmonin gjatë ditës në vendet e frekuentuara publike për të demonstruar paaftësinë e shtetit dhe për të mbjellë frikë ndaj shënjestrave të tyre të ardhshme, duke provokuar vazhdimisht konflikte me pushtuesit roman. (John Gearson, "The nature of Modern Terrorism", E# 2737, p, 8, "European Centre For Security Studies", "George C. Marshall", Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Në fillim të mileniumit të dytë, gjatë viteve 1090-1275 sektet Shi'ite të Ismili dhe Nizari sulmuan shumë herë kryqtarët,por,edhe myslimanët.Ata përdornin disa kama(shpata) të vogla,në luftime në distanca të afërta dhe kjo mënyrë e sulmeve,duke vënë në theks terrorin e shkaktuar dhe gatishmërinë për të vdekur me qëllim të realizimit të misionit të tyre, mund të krahasohet me sulmet e sotme vetëvrasëse.(John Gearson, “The nature of Modern Terrorism”, E# 2737, p, 7, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Termi terrorizëm për herë të parë është përdorur gjatë Revolucionit Borgjez Francez. “Regime de la terreur” (1793-1794) dhe ishte një përpjekje sistematike e ekspozimit të tradhtarëve të Revolucionit dhe dërgimit të tyre në gjyotinë.Në fillim dhuna,ose terrori,kishin konotacion pozitiv,sepse ishin të drejtuara kundër shkatërruesve dhe disidentëve,të cilët regjimi i ri i konsideronte si armiq të popullit.Dhuna u përhap,e madje edhe vet udhëheqësi revolucionar,Robspieri,së bashku me 40.000 persona të tjerë u dërguan në gjyotine gjatë “Regime de la terrorur”.Pak më vonë anglezi Edmund Bruke,një kritik i zëshëm i Revolucionit, ithtarët e Revolucionit i quajti terroristë.(Dr. Harvey Kushner, “Encyclopedia of terrorism”, Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications Inc. 2003,p, 359)

Gjatë shekullit XIX në Rusi u krijua një organizatë terroriste shumë e suksesshme e cila ishte e motivuar nga revolucionari rus Mikhail Bakunin, i cili një shekull më parë kishte bërë thirrje për pastrimin e tokës ruse përmes akteve terroriste nga individët ose grupet e vogla.Kjo organizatë e quajtur “Nardnya Volya” (Dëshira e popullit) veproi nga janari 1878 deri në mars 1881,ajo u udhëhoq nga Sofia Perovskaia (Sofya Perovskaya) duke ndërmarrë një valë të madhe të shpërthimeve dhe vrasjeve,ku si shënjestër ishte vetë Cari rus Aleksandri II, familja mbretërore e zyrtarët e shumtë shtetëror të cilët shiheshin si pjesë e një regjimi të korruptuar.(Nick Pratt, Profesor of Strategies and International Politics,”Terrorism: History&Causes,Yesterday,Today, Forever”,Ligjëratë në “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani, Mars 2010)

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX terrorizmi në formë të vrasjeve politike u bë një fenomen global.Vrasje të tilla politike u kryen ndaj gjeneralit Martinez Campos në Barcelonë më1892;presidentit Francez Sadi Carnot më1894;Mbretëshës Elizabeth të Austro-Hungarisë më1898;Mbretit Umberto të Italisë më1900;presidentit amerikan Wailliam Mc Kinley më 1901etj.Lufta e Parë Botërore filloi pas vrasjes së Arkidukës së Austrisë Franc Ferdinand dhe gruas së tij Sofia,nga nacionalisti serb Gavrilo Princip, i cili ishte anëtar i organizatës Mlada Bosna (Bosnja e Re).(Dr. Harvey

Kushner,"Encyclopedia of terrorism", Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications Inc. 2003,p, 360).

Mes dy luftërave botërore historia e njerëzimit pa shumë dhunë dhe terror shtetëror të kryer nga vetë shteti dhe institucionet e tij. Aktet e terrorizmit klasik ishin të rralla dhe në këtë periudhë dhuna shtetërore e ushtruar nga fashistët në Gjermani dhe komunistët në Rusi, vuri në hije aktet terroriste të individëve apo grupeve të ndryshme. Përndjekja e kundërshtarëve politik, etiketimi, përndjekja dhe persekutimi i qytetarëve me prejardhje hebreje në Gjermani, Holandë e Austri, por edhe në Rusi, ishte bazuar në një luftë të karakterit ideologjik, e cila luftë kishte bazën e saj në terrorin shtetëror të drejtuar kundër grupeve të caktuara politike, nacionale, fetare e racore. Regjimi i Hitlerit në Gjermani dhe ndikimi i tij në shtetet për rreth si dhe regjimi i Stalinit në Rusi ishin kryerësit më të mëdhenj të akteve të terrorit shtetëror në këtë periudhë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht në vitet e '50-të dhe '60-të të shekullit të kaluar, terrorizmi u përdor gjerësisht si një taktikë nga grupet nacionaliste që luftonin për pavarësi si, në Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore dhe Azi. Aktet tradicionale terroriste u regjistruan në qytetet e Palestinës dhe Qipros. Në anën tjetër të globit, në Amerikën Latine, u shfaqën shumë lëvizje majtiste, të cilat kryen shumë akte terroriste të rrëmbimit, grabitjes së bankave e shpërthime. Akte të tilla u regjistruan në Uruguai, Brazil, Argjentinë si dhe në shtete të tjera të kësaj pjese të globit. Në vitet e '70-të paraqiten edhe grupet e para terroriste të motivuara ideologjikisht në kontinentin e Evropës si RAF (Red Army Fraction) në Gjermani, Brigade Rose në Itali, Direct Action (Aksioni Direkt) në Francë, ETA në Spanjë e deri te Lëvizja për Çlirimin e Palestinës (PLO) në Palestinë. (Dr. Harvey Kushner, "Encyclopedia of terrorism", Thousand Oaks, London, New Delhi: Sage Publications Inc. 2003, p, 361)

Gjatë viteve të 70-të deri në vitet e 90-të të shekullit të kaluar, bota e pa shuarjen dhe eliminimin e shumë grupeve terroriste gjithandej, por grupe dhe organizata të reja u shfaqën në horizont. Grupet e reja terroriste të kësaj periudhe që vepronin në Lindjen e Mesme dhe në Evropë, karakterizohen me orientimin e luftës së tyre kundër Izraelit, rrëmbimin e aeroplanëve, rrëmbimin dhe mbajtjen e pengjeve dhe përkrahjen financiare dhe politike nga shtete të caktuara, shtete këto që grupet terroriste i përdornin si mjete të politikës së jashtme. Për sulmin terrorist në një klub nate, i cili frekuentohej nga ushtria amerikane në Berlin më 1985 u akuzuan autoritetet e Libisë, e poashtu edhe për sulmin në aeroplanin e "Pan Am" mbi Lockerbie të Skocisë më 1988 u akuzua regjimi i Kolonel Gadafit. Pas Revolucionit Islamik

në Iran (1979) autoritetet Shi`ite krijuan dhe financuan organizatën Hezbollah në Liban, e cila ishte në vijën e parë të luftimeve me pushtuesit Izraelit në vitin 1982.

Në Azinë Jugore organizata terroriste e Tigrave Tamil të Shri Lankes (LTTE) kreu shumë akte terroriste,ku si karakteristike e veçantë ishte *vetëfljimi i anëtarëve* të organizatës gjatë realizimit të sulmeve terroriste,dhe deri në atë kohë,rastet e vetëfljimit ishin më të shpeshtat nga kjo organizatë.Numri total i sulmeve vetëvrasëse terroriste gjatë viteve 1980 deri 2000 ishte 270.Nga këto,168 sulme u kryen nga anëtarët e LTTE,Hezbollahu 52, Hamasi 22 dhe PKK (Turqi) 15.(John Gearson, “The nature of Modern Terrorism”, E# 2737, p, 8, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Një ndër karakteristikat e kësaj periudhe të terrorizmit është *vetëfljimi i anëtarëve* të grupeve dhe organizatave terroriste.Nga tërësia e akteve të vetëfljimit mund të vërejmë tri lloje kryesore të përdorimit të kësaj metode:

-Grupet terroriste të cilat këtë formë të terrorizimit nuk e praktikojnë si taktikë të rregullt të sulmeve,por e përdorin vetëm në raste, rrethana dhe për qëllime shumë specifike,

-Grupe terroriste të cilat sulmet vetëvrasëse i kanë pjesë të taktikave të përkohshme ku udhëheqësit e grupeve kujdesen për legjitimimin ideologjik dhe fetar të sulmeve,rekrutojnë dhe trajnojnë persona të caktuar, të cilët i dërgojnë në misione ndaj objektivave specifike, dhe

-Grupet terroriste të cilat sulmet vetëvrasëse i kanë si pjesë të përhershme të strategjisë së tyre.(John Gearson, “The nature of Modern Terrorism”, E# 2737, p,9, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Për shkak të zhvillimeve të shumta politike në botë pas viteve të 90-ta të shekullit XX u rrit shqetësimi për shtetet e brishta, shtetet “mashtuese”, shtetet me mungesë të zbatimit të ligjit dhe shtetet “për brengosje” si Kuba,Irani,Iraku,Libia,Serbia,Korea Veriore,Siria, Sudani, Afganistani etj. Këto shtete dhe në lidhje me këto shtete u paraqitën forma të reja të terrorizmit, e sidomos të terrorit shtetëror.Këto shtete ishin edhe përkrahës dhe financues të terrorizmit në forma dhe me mjete të ndryshme.

Lufta në Gjirin Persik po ashtu ishte një shkas më tepër për grupet dhe organizatat e ndryshme islamike për të ndërmarrë sulme të shumta terroriste ndaj interesave amerikane në rajon,por edhe me gjërë. Sulmet terroriste në këtë periudhë u karakterizuan me dëshirë të madhe për të shkaktuar dëme në masë, të cilat deri në këtë kohë nuk kishin ndodhur asnjëherë.

Sulmi i parë në Qendrën Tregtare Botërore më 1993; sulmi në metronë e Tokios më 1995; sulmi në ndërtesën e FBI-së më 1995 në Oklahoma; sulmi në bazën ushtarake amerikane në Khobar Towers në Arabinë Saudite; sulmet në Ambasadat Amerikane në Kenia dhe në Tanzani (1997); sulmi në luftanijen amerikane USS COLE në Gjirin e Adenit në Jemen (1998), si dhe shumë sulme të tjera, vërtetuan dëshirën e madhe për hakmarrje dhe shkaktimin e dëmeve të pallogaritshme në njerëz dhe të mira materiale, ku vërehet qartë vetëm ndryshimi i taktikave dhe mjeteve, por jo edhe i qëllimeve të grupeve terroriste. (John Gearson, `` The nature of Modern Terrorism``, E# 2737, p, 12, ``European Centre For Security Studies``, ``George C. Marshall``, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Kjo periudhë e terrorizmit tregoi se grupet terroriste janë të gatshme të përdorin Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM) kurdo që atyre iu jepet mundësia. Në sulmet terroriste në metronë e Tokios u përdorë gazi ``Sarin``, dhe ky njihet si sulmi i parë në histori ku janë përdorur helmet kimike, me qëllim të vrasjes së sa më tepër njerëzve. Deri në sulmet e Tokios shumë herë është nënvlerësuar apo edhe mbivlerësuar mundësia dhe vullneti i grupeve terroriste për të përdorur armët kimike, dhe nga ky rast mund të konstatohet se nëse terroristët mund të kenë qasje në armët e shkatërrimit në masë, ata kanë vullnet dhe guxim të plotë t'i përdorin ato.

Karakteristikë tjetër e kësaj periudhe në zhvillimin e terrorizmit është edhe fakti se shtetet sponsorizuese të terrorizmit janë disi më të tërhequra, për shkak se lehtë vërehet përfshirja e tyre, dhe kjo kishte pasoja në planin ndërkombëtar, por edhe për faktin se këto shtete sponsorizuese tanimë kishin arritur të krijojnë organizata terroriste plotësisht të afta të operojnë në mënyrë të pavarur. Ndihma e shteteve sponsorizuese të terrorizmit si p.sh. Irani ndaj Hezbollahut, nuk është ndërprerë asnjëherë plotësisht, por është bërë dhe bëhet në mënyra shumë më të sofistikuar dhe vetëm në raste të veçanta.

Më 11 shtator 2001, 19 persona nga të cilët 15 shtetas sauditë, 2 shtetas të Emirateve të Bashkuara Arabe, 1 shtetas egjiptian dhe 1 shtetas libanez kishin rrëmbyer 4 aeroplanë udhëtarësh në lokacione të ndryshme në hapësirën ajrore amerikane, të cilët në mënyrë të koordinuar ishin drejtuar në shënjestra të ndryshme, me qëllim të realizimit të sulmeve më spektakulare dhe më të përgjakshme terroriste që i kishte parë bota deri atëherë. Sulmet e 11 shtatorit u organizuan nga Afganistani, i cili në atë kohë ishte jo një shtet sponsorizues i terrorizmit, por ishte pikërisht shteti i sponsorizuar nga terroristët, ku Al-Qaeda në këmbim të strehimit, paguante shuma të mëdha të parave për qeverinë Talebane në Kabul. (John Gearson, ``The nature of Modern Terrorism``, E# 2737, p, 15, ``European Centre For Security Studies``, ``George C. Marshall``, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Ky sulm tregoi edhe një herë gatishmërinë dhe vullnetin e një organizate terroriste për të kryer sulme të paimagjinueshme dhe me pasoja katastrofale për njerëzimin. Pas sulmeve të 11 shtatorit qendrat vendimmarrëse botërore ndërmorrën shumë veprime, të cilat ndryshuan rrjedhën e historisë botërore. Luftërat në Afganistan dhe Irak, destabilizimi i Pakistanit, rritja e numrit të grupeve terroriste dhe e aktivitetit të tyre, ndryshimet radikale në rregullat e sigurisë së udhëtimit etj, janë vetëm disa nga ndodhitë të cilat vërtetojnë se 11 shtatori ka ndryshuar botën.

Procesi i transplantimeve fetare në Kosovë nisi më 1999, shumë shpejt pas përfundimit të konfliktit me Serbinë. Salafizmi u importua në Kosovë nga organizata të caktuara Islame që vepronin në emër të agjencive humanitare. Intervistat që HIS (çka nënkupton kjo shkurtësë Mensur?) i zhvilloi me politikanë të njohur dhe zyrtarë të sundimit të ligjit në Kosovë, konfirmuan se organizatat islame janë duke vepruar në Kosovë përgjatë pothuaj një dekade dhe se kanë arritur të krijojnë një rrjet ndikues social, me qëllim depërtimin në Bashkësinë Islame të Kosovës dhe shndërrimin e identitetit kombëtar shqiptar në një identitet fetar. Edhe pse një pjesë e këtyre organizatave nuk ka ndonjë agjendë radikale apo të dhunshme, organizata të caktuara përhapin pikëpamjet e tyre më ekstremiste. (Nga Jane's Intelligence Review 07 Gusht 2012 18:10)

1.2 Përkufizimi i ekstremizmit dhe terrorizmit

Terrorizmi, në manifestime formash të ndryshme ka ekzistuar gjatë tërë historisë dhe për lloje të ndryshme të ideologjive politike. Fjala terrorizëm ka aq shumë definicione, po aq sa ka edhe organizata dhe grupe terroriste. Ky term ka kuptim të ndryshëm për njerëz të ndryshëm, dhe përpjekjet për ta definuar saktë këtë term kanë qenë të vështira. Por, qëllimi kryesor i gjetjes së një definicioni sa më gjithëpërfshirës për terrorizmin është të bëhet dallimi i tij nga format e tjera të përdorimit të dhunës, qoftë dhunës së përdorur nga shteti dhe përfaqësuesit e tij, qoftë nga individët, grupet terroriste, por edhe nga grupet tjera të karakterit kryengritës apo kriminal.

Aktet terroriste në mjaft vende të botës janë bërë problem tepër shqetësues. Numri i tyre ka shkuar duke u rritur vazhdimisht dhe pasojat e këtyre akteve kanë qenë tepër të rënda: viktima të shumta njerëzish, dëme materiale dhe gjendje pasigurie e panik në masë. Aktet terroriste paraqesin rrezik të madh për çdo shoqëri, prandaj edhe angazhimi në luftën kundër tyre është i domosdoshëm, si kundër terrorizmit shtetëror dhe atij të bandave apo organizatave kriminale edhe terrorizmit individual e atij ndërkombëtar. (Ismet Elezi, E drejta Penale, pjesa e posaqme, botimi Tiranë, P, 369)

Me terrorizmin që dominon rendin e ditës në botë, definicionet e terrorit, terroristit dhe të terrorizmit marrin një domethënie krejtësisht tjetër. Shumë vende e definojnë terrorizmin, hartojnë profilet terroriste dhe i (MA. Shkelzen Marevci, "Luftimi i Terrorizmit Bashkëkohor", Botimi Prishtinë, p. 28) publikojnë listat e organizatave terroriste në dritën e interesave të tyre kombëtare.

Termi "terrorizëm" paraqitet dhe interpretohet në forma të ndryshme. Vetë fjala "terrorizëm" paraqet një sintezë të emrit latin terror dhe sufiksit latin, por me prejardhje greke "izm". Fjala terror rrënjët e veta i ka në foljen "tras" e cila do të thotë dridhje. Haset në fjalët greke "ipe", në atë perse "tresidan", latine "ters", pellazge "terr" ... që nënkupton errësirën e thellë e të plotë, botën pa dritë, por edhe tmerrin, trishtimin, shkaktimin e frikës dhe të dridhjes; dhunën politike, deri te shkatërrimi fizik i kundërshtarit. (Shkodrani A., "Terrorizmi dhe shërbimet sekrete", Tiranë 2010, p. 25, cituar nga V. Latifi, I. Elezi, V. Hysi, "Politika e Luftimit të Kriminalitetit", "Juridica", Prishtinë 2012, p. 141)

Pra, mund të rumbullaksojmë se shprehja terrorizëm rrjedh nga gjuha latine "terror" që do të thotë frikë. Së këndejmi, terrorizmi në kuptimin më të gjerë është përdorim i dhunës apo kërcënimit me qëllim të shkaktimit të frikës dhe të pasigurisë ndaj individëve, grupit të qytetareve apo të mirave materiale. (Dr. Ismet Salihu, E drejta Penale, Pjesa e Posaqme, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p. 61)

Terrori është dhunë me qëllime politike, e ushtruar kundër objektivave jo ushtarake. E thënë ndryshe shënjestra e terrorit janë në tërësi civilët e pafajshëm, i vetmi krim i të cilëve është që ata në sytë e terroristëve përfaqësojnë "krahun tjetër". Për këtë arsye terror do të thotë që njerëzit e pafajshëm i nënshtrohen dhunës dhe kjo përbën një akt të zhveshur nga çdo justifikim moral. Kjo është një lloj si në rastet e vrasjeve të kryera nga Stalini apo Hitleri, përbën një krim kundër njerëzimit. (MA. Shkelzen Marevci, "Luftimi i Terrorizmit Bashkëkohor", Botimi Prishtinë, p. 33)

Definicionet më efektive të terrorizmit përfshijnë tre faktorë: *thelbin e tij* (dhunën ose kërcënimin për përdorim të dhunës); *cakun e tij* (civilët dhe personat që nuk marrin pjesë në veprime luftarake); dhe *qëllimin e tij* (të fitojë ose mbajë ndonjë formë të fuqisë politike duke instaluar frikë dhe duke detyruar dhunshëm disa ndryshime politike dhe sociale). (Dr. Boaz Ganor, "Defining Terrorism: Is one man's terroriste another man's freedom fighter?", International Policy Institut of Counter-Terrorism, Herzlyia Israel, 24 September, p. 6.)

Terrorizmi definohet si dhunë sistematike dhe e organizuar ndaj subjektit pasiv, ndaj të cilit shkaktohet apo krijohet ndjenja e pasigurisë dhe e frikës, me qëllim të nënshtrimit politik të tij apo me qëllim që të subjekti pasiv të shkaktohet mosbesimi ndaj regjimit ekzistues shoqëror dhe ashtu t'i imponohet pushteti politik i terroristëve për eksploatim dhe nënshtrim. Njëherit, me këtë dhunë ushtrohet ndikimi në pushtetin politik, për të nxjerrë nga ai koncesione të caktuara politike. (Sreten Kovacevic, "Terorizam i Jugosllavia", Beograd 1992, Faqe 8, Cituar sipas Haki DEMOLLI, "Terrorizmi", Prishtinë 2002, faqe 7)

Një përkufizim tjetër i cili është relativisht neutral pranon faktin themeltar se terrorizmi është një taktikë e përdorur nga shumë grupe terroriste të llojeve të ndryshme. Ai përfshin gjashtë elemente kryesore. Terrorizmi përfshin : 1. përdorimin ose kërcënimin e dhunës, 2. një grup të organizuar, 3. për të arritur objektiva politik, 4. dhunën e cila është e drejtuar kundër një audience të objektivizuar dhe e cila nuk kufizohet vetëm të viktimat e menjëhershme, por shpesh përfshin edhe civilët, 5. ndërsa qeveria mund të jetë shkaktari i dhunës dhe objektivi terrorist, dhunë kjo e cila si akt terrorist konsiderohet vetëm kur aplikohet nga grupet joqeveritare. Elementi i gjashtë (6) konsiderohet se terrorizmi është arma e të dobët. (Alan Collins, Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Përkthyer nga Enri Hide, Botuar nga UET Press, Tiranë, p. 365)

Në aspektin shoqëror, terrorizmi interpretohet si përdorim i drejtpërdrejtë dhe i organizuar i dhunës, kryesisht nga grupe e organizata të gatshme që në mënyrë fizike, duke përfshirë edhe atentatet, vrasjet, marrjen e pengjeve, me qëllim të imponimit të vullnetit të tyre shtetit dhe shoqërisë, të ngjallin terror psikik ndaj masës së gjërë, duke shkaktuar kompleksin e frikës personale e kolektive, pasiguri, shqetësim e apati. (Shkodrani A. "Terrorizmi dhe shërbimet sekrete", Tiranë 2010, p. 26, cituar sipas V. Latifi, I. Elezi, V. Hysi, :Politika e Luftimit të Kriminalitetit", "Juridica", Prishtinë 2012, p. 141)

Por, problemi kryesor, i cili ka ndikuar dhe ndikon drejtpërdrejt në gjetjen e një përkufizimi adekuat të terrorizmit është fakti se asnjë definicion, sado gjithëpërfshirës të jetë, nuk mund të përfshijë të gjitha format e paraqitjes së terrorizmit, sepse format e paraqitjes kanë evoluar historikisht duke pësuar ndryshime në taktika, mjete të përdorura e caqe të atakuara.

Organizata e Kombeve të Bashkuara po ashtu ka dështuar që të shtrojë një definicion, i cili do të ishte i vlefshëm për të gjitha shtetet e kësaj organizate, përkundër përpjekjeve të shumta dhe të vazhdueshme.

Interesat gjeo-strategjike dhe aleancat e deklaruara dhe të pa deklaruara të shteteve po ashtu kanë ndikuar në mospajtimet lidhur me definimin e terrorizmit,sepse ajo që është organizatë terroriste, grup terrorist apo akt terrorist për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj, nuk është organizatë,grup apo akt terrorist për Rusinë dhe aleatët,dhe e kundërta. Shembull konkret që shpërfaqet në këtë inkonsekuencë është Hamas-i,i cili nga SHBA-të konsiderohet organizatë terroriste,ndërsa nga Rusia konsiderohet si lëvizje politike,ose derisa Ushtria Çlirimtare e Kosovës konsiderohej dhe vazhdon të konsiderohet si organizatë terroriste nga Rusia, në anën tjetër nga SHBA-të dhe shtetet tjera është konsideruar si një lëvizje çlirimtare, e cila është përkrahur fuqishëm. Rregulli “terroristi i dikujt është çlirimtari i dikujt tjetër” është edhe më tutje i pranishëm.

Dallime të tilla në cilësimin si organizatë terroriste të një organizate të caktuar hasim edhe mes aleateve siç janë:SHBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar.Derisa nga SHBA-të Hezbollah-u në tërësi konsiderohet si organizatë terroriste,Mbretëria e Bashkuar nuk ka qëndrim të tillë,sepse vetëm krahun ushtarak të Hezbollah-ut e konsideron si grup terrorist, ndërsa krahun politik e konsideron si një lëvizje radikale islamike.

Në çështjen e përkufizimit të terrorizmit hasen dallime edhe brenda vetë organizatave dhe institucioneve të një shteti,të cilat merren me luftimin e terrorizmit.Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës varësisht se me çfarë forme dhe në çfarë niveli një institucion shtetëror merret me luftimin e terrorizmit,hasen definicione të ndryshme.

Departamenti Amerikan i Shtetit (Department of State) për nevoja dhe qëllime të saj ka modifikuar një definicion,sipas së cilit:“Terrorizmi është akt i paramenduar,dhunë e motivuar politikisht,e ushtruar ndaj personelit që nuk është përfshirë në betejë (non-combatant),nga grupe ose individë klandestinë (ilegal), zakonisht me qëllim të ndikimit në opinion (audiencë)”.(Nick Pratt,“Terrorism; History &Causes,Yesterday”, p, 6, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism:UK,“European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Byroja Federale e Hetimeve (FBI),konsideron se:“Terrorizmi është akt jo ligjor i përdorimit të forcës ose dhunës kundër qytetarëve ose pasurisë për të penguar ose detyruar qeverinë,popullatën civile,ose ndonjë segment të saj,me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre politike ose sociale”.(Nick Pratt,“Terrorism;History &Causes,Yesterday”,p,7,PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism:UK,“European Centre For Security Studies”,“George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve (Department of Defense) po ashtu në një definicion të modifikuar për nevojat dhe qëllimet e saj konsideron se:“Terrorizmi është akt i përlloritur i përdorimit të dhunës në mënyrë që të ushqejë frikën,me qëllim që të pengojë ose detyrojë qeverinë dhe shoqërinë,për të arritur qëllimet e tyre që zakonisht janë politike, religjioze ose ideologjike”.(Nick Pratt,“Terrorism;History &Causes,Yesterday”, p, 6, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK,“European Centre For Security Studies”,“George C. Marshall”,Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Një shtet tjetër shumë i angazhuar në luftën kundër terrorizmit dhe njëkohësisht shumë i kërcënuar, dhe disa herë i atakuar është edhe Mbretëria e Bashkuar. Ky shtet ka një definicion mjaft të gjerë lidhur me terrorizmin.Terrorizmi përfshinë të gjitha veprimet ku përdorimi i dhunës ose kërcënimi është projektuar për të ndikuar në qeveri apo për të trembur opinionin publik ose një pjesë të publikut.Përdorimi i dhunës ose kërcënimi është bërë me qëllim të avancimit të një kauze politike,fetare apo ideologjike,që përfshin dhunën serioze kundër një personi apo shumë personave,dëme serioze në pronë; rrezikon jetën e një personi, përveç personit që ka kryer veprimin;që krijon një rrezik serioz për shëndetin apo sigurinë e publikut ose një pjese të publikut;që është veprim i dizajnuar të ndërhyjë seriozisht që të ndërpriten komunikimet me sistem elektronik,përfshirë edhe veprimet jashtë Mbretërisë së Bashkuar”.(Nick Pratt,“Terrorism;History &Causes,Yesterday”,p,10, PTSS 10-3, Specific Features Of Terrorism: UK ,“European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Për të arritur deri të një definicion mbi terrorizmin duhet të merren parasysh disa veçori të grupeve terroriste, të akteve terroriste si dhe të qëllimeve që synohen të arrihen me kryerjen e aktit terrorist.Vetitë dhe elementet kryesore të terrorizmit janë:përdorimi i dhunës apo kanosjes sistematike të organizuar;ushtrimi i dhunës nga grupe të caktuara politike; shkaktimi i ndjenjës së frikës,pasigurisë dhe mosbesimit në pushtet te masat e gjëra; asgjësimi i njerëzve dhe të mirave materiale me përmasa të mëdha; nxjerrja e koncesioneve të caktuara politike;fitimi i pushtetit shtetëror mbi territorin e caktuar, publiciteti dhe tërheqja e vëmendjes së opinionit ndërkombëtar.(Prof.Dr.Vesel Latifi,“Kriminalistika”,Prishtinë 2001, p.310)

Motivi i sulmit i cili mund të jetë politik apo ideologjik,qëllimi që synohet të arrihet, dhuna e përdorur apo kërcënimi për përdorimin e dhunës,aktiviteti i organizuar,por edhe individual i grupeve ilegale jo shtetërore,përzgjedhja e qëllimshme e civilëve si cak i sulmit, krijimi i frikës dhe panikut, fitimi i publicitetit me anë të kryerjes së aktit terroristë dhe

vazhdimësia e akteve terroriste, janë disa nga karakteristikat, të cilat ndihmojnë në përpilimin e një përkufizimi lidhur me terrorizmin. Së këndejmi, për të arritur deri te një përkufizim sa më i pranueshëm lidhur me terrorizmin, duhet që në mënyrë kumulative një akt i kryer t'i përmbajë këto elemente, apo disa prej këtyre elementeve, për t'u klasifikuar si akt terrorist.

Në rastet kur një institucion shtetëror ushtron akte terroriste ndaj një pjesë të qytetarëve të vet, çfarë ishin veprimet e shtetit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1990-1999, ky do të konsiderohej terror ose terrorizëm shtetëror. Megjithatë, në rrethanat kur i njëjti institucion shtetëror (apo ndonjë institucion tjetër) ushtron dhunë dhe ndërmerr akte terroriste edhe ndaj ndonjë shteti tjetër ose ndaj qytetarëve të atij shteti kudo në botë, atëherë do të kishim një situatë tjetër dhe ky më nuk do të ishte terror shtetëror, por terrorizëm shtetëror i ushtruar kundër një shteti tjetër.

Si përfundim mund të konstatojmë se terrorizmi është akt i përdorimit të dhunës apo kërcënimit me përdorim të dhunës serioze kundër qytetarëve, institucioneve shtetërore apo përfaqësuesve të tyre dhe përfaqësuesve të shteteve të huaja, dhunë e cila shkakton pasoja në njerëz e pronë, dhe e cila ndikon në frikësimin e qytetarëve, duke i detyruar institucionet të veprojnë apo mos veprojnë lidhur me një çështje të caktuar, në mënyrë që më pas të arrihen synimet politike, ideologjike, religjioze e financiare.

Gjithashtu, duhet theksuar se përkufizimi i terrorizmit është një çështje shumë e rëndësishme, sidomos për organet e zbatimit të ligjit, sepse policia, prokuroria dhe gjykatat kërkojnë përkufizim të saktë të këtij fenomeni në mënyrë që të kenë mundësi të zhvillojnë ndjekjen penale dhe dënimin e personave të përfshirë në aktivitete terroriste. (Alan Collins, Studime Bashkëkohore të Sigurisë, përkthyer nga Enri Hide, Botuar nga UET Press, Tiranë, p. 363)

1.3 Disa nga grupet terroriste më të njohura në botë

Historia e njerëzimit ka njohur shumë grupe terroriste të krijuara në periudha të ndryshme, për motive e qëllime të ndryshme, ku disa prej tyre janë shuar, janë riorganizuar, janë ndarë apo bashkuar me grupe të tjera. Pas Luftës së Dytë Botërore numri i grupeve terroriste është rritur vazhdimisht, dhe sot në tërë botën kemi qindra grupe terroriste, të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre ilegal mbi bazën e kauzave të ndryshme.

Ndër grupet terroriste më të njohura në botë janë: ETA (Spanjë), PKK (Turqi), Brigade Rose (Itali), RAF (Gjermani), IRA (Irlanda Veriore), FARK (Kolumbi), Al-Qaeda (ndërkombëtare), Hezbollah (Liban), Hamas (Rripi i Gazës, Palestinë), Fatah (Bregu Perëndimor, Palestinë), Shtatori i Zi (Palestinë), Lëvizja për Çlirimin e Palestinës-PLO (Palestinë), Gama

Islammia(Egjipt),Vëllazëria Myslimane(Egjipt),Abu Sajaf(Filipine),Jamma Islamy (Indonezi),Al Shabab (Somali),FIS (Algjeri), Lashkar-I-Taiba(Pakistan),Boko Haram,ISIS (Irak-Siri).Dekadave të fundit të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI bota ka njohur edhe shumë grupe të tjera terroriste si në Evropë, Amerikën Latine,Afrikë e Azi.Për shkak të formatit të këtij punimi është e pamundur që të trajtohen të gjitha këto grupe terroriste.Më tutje do të paraqesim shkurtimisht disa të dhëna për grupet terroriste të cilat kanë pasur njëndikim më të madh gjatë aktivitetit të tyre.

Al-Qaeda(Baza) operon në më shumë se 60 shtete të botës përmes një rrjeti të fragmentuar,duke përdorur operativë të disa nacionaliteteve.(Michel N. Schmitt, “Counter-Terrorism and the use of force in International Law”,p.3). Nga Filipinet deri në Afrikën Veriore,kjo organizatë është shumë aktive dhe me një prezencë mjaft të madhe të operativëve dhe financuesve të saj në terren.Në shtetet e zonës evropiane apo në SHBA ekzistojnë disa “celula të fjetura”,të cilat në momente të caktuara aktivizohen.Al-Qaeda paraqet kërcënimin më të madh për SHBA-në dhe aleatët e saj,dhe luftimi i kësaj organizate ka qenë dhe mbetet mjaft sfidues.Themeluesit e kësaj organizate ishin Osama Bin Laden dhe Abdallah Azzam me disa militantë të tjerë.Organizata u themelua rreth vitit1988-1989 gjatë Luftës Ruso-Afgane.(Bill Moyers Journal. A Brief History of Al Qaeda.PBS.com. July 27,2007.Marrë më 10.08.2018). Kjo organizatë është e njohur si organizatë terroriste nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara(UNSC),NATO,BashkimiEvropian(EU),Shtetet e Bashkuara të Amerikës(SHBA),Rusia,India dhe shtete të tjera.

Kjo organizatë është udhëhequr nga shtetasi saudit Osama Bin Laden,i cili më 2 maj 2011 ishte vrarë nga njësitet speciale të Ushtrisë amerikane në qytetin Abotabad të Pakistanit. Disa muaj më vonë udhëheqjen e organizatës e ka marrë Ayman Al-Zawahiri,shtetas egjiptian,i cili më parë ishte zëvendësi i Osama Bin Ladenit.Me vrasjen e Osama Bin Ladenit organizata ka pësuar një goditje të rëndë,por nuk mund të thuhet se ajo është mposhtur.Asaj tani i mungon ideatori, themeluesi, dhe lideri karizmatik, i cili me qasjen dhe aktivitetin e tij ishte shndërruar në simbol të luftës kundër “të pafeve”, e në anën tjetër për SHBA-të dhe aleatët e saj ishte shndërruar në një makth të vërtetë.Al-Qaeda edhe sot është shumë aktive dhe paraqet kërcënim serioz për sigurinë e shumë shteteve.Ajo ka një organizim shumë konspirativ dhe shumë funksional.Al-Qaeda më së miri mund të karakterizohet si rrjet i rrjeteve.Lidershipi qendror i organizatës ofron fondet,udhëzimet dhe ekspertizën për celulat e saja,ndërsa koncepti operacional është i zhvilluar nga poshtë lartë,por edhe anasjelltas. Celulat e vogla lokale kanë një pavarësi dhe iniciativë të konsiderueshme në planifikimin dhe ekzekutimin e sulmeve terroriste,me një koordinim të vogël nga lidershipi qendror.(Michael

A.Sheehan,“Diplomacy”,PTSS 10-03,3213-E, p2,“European Centre For Security Studies”,
“George C. Marshall”,Garmish-Partenkirchen,Gjermani)

Edhe pse viteve të fundit ISIS disi ka zbehur ndikimin e Al-Qaedas,megjithatë duke marrë parasysh aktivitetin e saj rreth tridhjetë vjeçar,shkallen e sulmeve terroiste,mënyrën e organizimit dhe ekzekutimit të sulmeve,mund të konkludojmë se Al-Qaeda është edhe më tutje shumë rrezikshme dhe me potencial të madh që të kryej sulme terroriste edhe atëherë kur nuk pritet.

Militantët e Al-Qaedas kanë kryer sulmet më të tmerrshme në historinë e njerëzimit duke filluar nga 29 dhjetor 1992,kur në qytetin e Jemenit-Adan shpërthen një bombë në një hotel dhe vriten dy turistë austriak,ndërsa dy mysliman shtetas të Jemenit të trajnuar në Afganistan,u arrestuan më vonë nga shërbimet sekrete amerikane.Sipas zyrtarëve të shërbimeve sekrete,ky akt konsiderohet sulmi i parë i Osama Bin Ladenit dhe përkrahësve të tij kundër SHBA-ve.(New York Times, 21.08.1998).Radha e sulmeve të tjera është e gjatë,e ndër sulmet më të mëdha konsiderohen tentativa e rrënimit të Qendrës Tregtare Botërore më 1993, sulmet në ambasadat amerikane në Kenia dhe Tanzani në 1997, sulmet e 11 shtatorit 2001, sulmet në Bali të Indonezisë më 2002, sulmet në trenat në Madrid më 2004,sulmet në metronë e Londrës më 2005,si dhe qindra e mijëra sulme të tjera në Irak,Afganistan,Pakistan, Jemen,dhe në pjesë të tjera të botës.

Deri në vitin 1996 bazat kryesore të Al-Qaedas kanë qenë në Sudan,nga ky vit deri më 2001 në Afganistan,e pas pushtimit të Afganistanit dhe rrëzimit të Talebanëve nga pushteti, vërehet qartë një kalim i liderëve dhe shumë militanteve të Al-Qaedas në Pakistan,nga ku edhe e ushtrojnë aktivitetin e tyre,në shumë raste të ndihmuar nga struktura të caktuara të institucioneve pakistaneze.

Ndihma e strukturave të caktuara institucionale pakistaneze ofruar militanteve të Al-Qaedas dëshmohet më së miri me rastin e vrasjes së liderit të kësaj organizate Osama Bin Laden me datën 02.05.2011.Vrasja e Osama Bin Laden padyshim se është një ngjarje shumë e rëndësishme në luftën globale kundër terrorizmit.Vrasja e Osama Bin Laden-it ka qenë një moment kthese në këtë luftë të tejkujtur dhe të përgjakshme,e sidomos kur kemi parasysh faktin se në shtëpinë e Osama Bin Laden-it,pas vrasjes së tij u konfiskuan 10 hard disqe të jashtme,5 kompjuter dhe rreth 100 CD dheUSB.(Explorer TV,Histori,22.06.2018, 23:30).Marrja e këtyre informatave nga autoritet amerikane,ndikuan keq te Al-Qaeda,sepse vlera e informata që kishte në zotërim lideri i tyre i vrarë,ishin shumë të sakta dhe të detajuara

si për anëtarët, e poashtu edhe për organizimin, financimin dhe veprimet e organizatës, e këto informata në duar të amerikanëve e bënin të cenueshëm çdo anëtar të organizatës.

Euskadi Ta Askatasua(ETA) në përkthim e ka kuptimin “Atdheu dhe Liria Baske”. ETA është një organizatë terroriste me një traditë dhe aktivitet të gjatë terrorist. Aktiviteti i saj ka filluar që në vitet e ’50 të shekullit të kaluar nga disa studentë baskë, ndërsa zyrtarisht është formuar si organizatë më 31 korrik 1959. (“ETA: from student group to Basque bombers”, *The Daily Telegraph*, 20 October 2011) Qëllimi i krijimit të kësaj organizate terroriste ka qenë çlirimi i rajoneve me popullsi baske nga diktatura e Frankos në Spanjë, krijimi i një shteti të pavarur bask, të cilit gjithmonë sipas udhëheqësve të kësaj organizate do t’i bashkoheshin edhe territore të banuara me popullsi baske në Francë. Gjatë historisë së aktivitetëve të saj, ETA ka kryer me qindra vrasje të zyrtarëve shtetëror dhe të civilëve të pafajshëm, gjithmonë duke pretenduar se aktet e tilla kryhen më qëllim të realizimit të synimeve të tyre politike. Shënjestrat e sulmeve terroriste ishin zyrtarët e përzgjedhur shtetëror. Gjithashtu, zyrtarët policor, ushtarak, të shërbimeve sekrete, të burgjeve kanë qenë shumë herë viktime të sulmeve të ETA-s.

HAMAS(Harakat al-Muqāēama al-Islāmiyya) është një organizatë Islamike e cila aktivitetin e saj e ushtron në Rripin e Gazës. HAMAS në përkthim nga gjuha arabe do të thotë “Lëvizja e Rezistencës Islamike” e cila si parti politike apo si lëvizje politike ushtron kontrollin politik duke udhëhequr me qeverinë e zgjedhur në territoret e Rripit të Gazës në Palestinë. Themeluesi i saj ishte sheiku Ahmad Yassin dhe organizata u themelua në vitin 1987.

Hamas ka një strukturë mjaft mirë të organizuar, të ndarë në dy pjesë, në krahun politik dhe atë ushtarak. Krahu politik i HAMAS-it është i ndarë në dy pjesë, ku njëri krah ushtron aktivitet të përditshëm në Gaza dhe për çështjet e brendshme ka fuqi më të madhe vendimmarrëse, dhe krahu tjetër i cili ushtron aktivitetin politik nga Damasku i Sirisë, dhe ky krah konsiderohet përgjegjës për politikën që kanë të bëjnë me çështjet jashtë Gaza-s. (Yoram Cohen & Jeffery White “Hamis in Combat, The Military Performance of the Palestinian Islamic Resistance Movement”, PTSS 2010-3, Study Trip Israel-Jordan, # 5046 E, p.7, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish-Partenkirchen, Gjermani) Aktiviteti i saj ushtarak dhe politik është i orientuar ekskluzivisht kundër shtetit të Izraelit dhe interesave të këtij shteti në rajonin e Lindjes së Mesme.

HEZBOLLAH (Partia e Zotit) është lëvizje e cila vite me radhë u është kundërvënë forcave izraelite si në beteja të hapura, ashtu edhe në sulme terroriste. (Mr.Sc. Besim Arifi, “Këqyrja e vendit të ngjarjes”, Prishtinë 2012, p. 167) Kjo lëvizje është krijuar, trajnuar dhe financuar nga Garda Revolucionare Iraniane. Që nga viti 1982 deri në ditët e sotme, kjo lëvizje ka sfiduar forcat izraelite dhe të aleatëve të saj si në Liban, po ashtu edhe në pjesë të tjera të Izraelit. Ka një strukturë jashtëzakonisht funksionale me krahun e saj ushtarak dhe krahun politik. Edhe pse e cilësuar nga shumë shtete si organizatë terroriste, në vitin 2008 u bë pjesë e qeverisë së Libanit, dhe si pasojë pati shumë reagime ndërkombëtare. Viteve të fundit vërehet një aktivitet i ngjeshur i Hezbollahut në Irak duke i trajnuar dhe mbështetur militantët Shiit kundër forcave të SHBA-ve, e gjithashtu Hezbollah si organizatë ka pasur një rol shumë të madh edhe në luftën e Sirisë, ku duket qartë se drejtpërdrejt ishin vënë në shërbim të diktatorit Bashar Al Asad.

Shteti Islamik (ISIS) është organizata terroriste e cila u shfaq fuqishëm në fillim të vitit 2014 në pjesë të territorit të Irakut dhe Sirisë. Kjo organizatë njihet me emra të ndryshëm si ISIS (Islamic State of Iraq and Al Sham / Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit) ISIL (Islamic State of Iraq and Levant / Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit) dhe DAESH në kuptimin e gjuhës arabe. Kjo organizatë e vetëquajtur edhe si shtet u rrit në mënyrë të frikshme gjatë verës së vitit 2014, e sidomos pas pushtimit të qyteteve të mëdha irakiane Mosul dhe Sinjar. Dhuna e ushtruar ndaj kundërshtarëve, por edhe ndaj çdo kujt që nuk ishte në anën e tyre ka qenë e tmerrshme. Anëtarët e kësaj organizate kanë kryer krimet më të tmerrshme të para nga njerëzimi gjatë viteve dhe dekadave të fundit. Madje mizoritë e tyre ua kalonin edhe atyre të nazistëve gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore, apo edhe krimeve të serbëve të kryera në ish- Jugosllavi. Pamjet e djegies së gjallë të kundërshtarëve, prerja e kokave të personave të ndryshëm në vende publike, shkatërimi i muzeve me vlera të shumta historike, përdhunimi masiv i grave dhe vajzave, tregëtia me skllëvër etj, ishin pamjet që botës së civilizuar i dërgoheshin çdo ditë nga ky grup.

Kjo organizatë që kishte shpallur edhe shtetin e saj, ku pretendohet të zbatohet ligji i shariatit pati një rritje të hovshme ku shumë të rinjë nga pjesë të ndryshmetë botës, e sidomos nga Lindja e Mesme, Afrika Veriore dhe Evropa, iu bashkuan kësaj çmendurie masive e cila e kishte sjellë në pikëpyetje të madhe humanizmin njerëzor. Mungesa e një reagimi ndërkombëtar të koordinuar kundër ISIS-it bëri që kjo krijesë monstruoze të rritej në vazhdimësi.

Për fat të keq,në mesin e shumë personave që iu bashkuan kësaj organizate,ishin edhe shumë të rinjë nga Kosova dhe visetë tjera shqiptare.Këta të rinjë u manipuluan nga Imamët radikal të cilët nëpër xhamitë ilegale dhe gjysmë ilegale mbanin ligjërata të ndryshme duke i manipuluar të rinjtë me tema të tilla siç ishin” triumfi i shpejtë i muslimaneve dhe shkatërrimi i të krishterëve dhe judëve,për vdekjen martire ku xhihadisti shpërblehet me 72 gra te virgjëra.(Dr. Kolë Krasniqi,“Paraqitja dhe Zhvillimi i Ekstremizmit Islamist në Kosovë dhe në Vendet e Rajonit”, Tiranë 2018, Faqe 62)Madje të rinjtë shqiptarë arritën që me kalimin e kohës të marrin edhe poste udhëheqëse në hierarkinë e kësaj organizate siç është rasti i Lavdrim Muhaxherit dhe Ridvan Qazimit.Që të dy këta persona, por edhe dhjetëra të tjerë u vranë gjatë luftimeve të zhvilluara kundër palëve të tjera e që në fakt shumë palë të tjera ishin kundër ISIS-it,duke filluar nga regjimi Sirian,Forcat Irakiane,pasatj Ushtria Ruse, Ushtria Amerikane me aleatët e tyre,grupet tjera kryengritëse në terren,Forcat Kurde etj. Nga raportimet e mediave të cilat ijanë referuar deklaratave të zyrtarëve të Policisë së Kosovës,janë rreth 300 të rinjë kosovar të cilët kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për të iu bashkangjitur ISIS-it,ndërsa rreth 55 prej tyre kanë mbetur të vrarë/vdekur atje.Rreth 140 persona tëkthyer janë arrestuar,ndërsa besohet se atje tani kanë ngelur edhe rreth 100 persona,nga të cilët rreth 70 prej tyre janë të angazhuar në aktivitete të Shtetit Islamik ,i cili padyshim se tani është në fundin e tij.(<http://www.botasot.info/aktuale-lajme/609878/policia-jep-detajet-ja-sa-është-numri-i-shqiptarëve-në-siri-mbi-55-janë-të-vrare,16.08.2018>)

1.4 Ekstremizmi i dhunshëm që shpie në Radikalizëm dhe Terrorizëm

Shtetet, përmes agjencive përkatëse policore e kanë për detyrë që të mbrojnë të gjithë individët brenda juridiksionit të tyre ndaj akteve terroriste, kjo si pjesë e detyrimeve të tyre në kuadrin e të drejtave të njeriut për garantimin e së drejtës për jetën,të drejtës për siguri dhe të drejta të tjera,në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.Kjo kërkon që shtetet të përdorin një çasje gjithëpërfshirëse në luftën kundër terrorizmit,duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm (VERLT).

Efikasiteti dhe legjitimiteti i veprimeve të një shteti kundër akteve terroriste do të minoheshin,nëse shteti në fjalë,përmes cilësdogjencitë të tij,përdor pushtetin e vet për të shkelur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.Duke qenë se në këtë kontekst, policia luan një rol tepër të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit, merr rëndësi të posaçme fakti që policia të japë llogari për veprimet e veta,me qëllim garantimin e legjitimitetit, besimit,besueshmërisë dhe mbështetjes nga publiku.(Parandalimi i terrorizmit dhe lufta

kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin, Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Vjenë, mars 2014, p. 19)

1.5 Motivet e ekstremizmit, tipologjia dhe faktorët

Nëse i referohemi historikut të akteve terroriste mund të vërejmë forma të ndryshme të paraqitjes së tij, mjete të shumëllojshme, motive nga më të ndryshmet dhe poashtu një numër të pakufizuar të viktimave me cilësi dhe tipare të ndryshme.

Mënyrat (format) më të shpeshta të paraqitjes së akteve terroriste në përgjithësi janë: marrja dhe rrëmbimi i pengjeve; rrëmbimi i mjeteve të udhëtimit masiv (aeroplanëve, anijeve autobusëve, trenave); torturimi dhe vrasja (atentati) i kundërshtarëve politik, përfshirë zhdukjen e tyre; eksplozivet; bombardimi (granatimi) i vendeve të banuara me civilë; shfrytëzimi i armëve për shkatërrim masiv (armët nukleare, kimike, biologjike) si dhe vrasja e civilëve. (Prof. Dr. Vesel Latifi, “Kriminalistika”, Prishtine 2011, p. 312)

Poashtu ka edhe raste të tjera të sulmeve nga persona të armatosur, anëtarë të grupeve terroriste nëpër vende të frekuentuara (sheshe, stacione, qendra tregtare, objekte fetare) siç ka ndodhur në sulmet në Mumbai të Indisë ku 10 persona të armatosur anëtarë të grupi “Lashkr-e-Taiba” nga data 26 deri më 29 nëntor 2008, sulmuan me granata dore dhe AK 47 në 4 lokacione të ndryshme në këtë qytet të mbipopulluar, në orët e piknikut, duke shkaktuar vdekjen e 164 personave përfshirë edhe vetë sulmuesit. (Colonel Behram A. Sahukar, “The Mumbai Attack, Analysis and Impact”, Program on Terrorism and Security Studies, (PTSS 10/3), “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish-Partenkirchen, Gjermani)

Mjetet të cilat i përdorin terroristët për realizimin e akteve të tyre janë të shumta si në numër, e po ashtu edhe në lloje. Pas Luftës së Dytë Botërore grupet terroriste kanë përdorur zakonisht armët e zjarrit, kryesisht ato automatike, për të realizuar sulmet e tyre. Por, edhe pse më rrallë, nga kjo kohë fillon përdorimi edhe i mjeteve të improvizuara shpërthyes (bombave) për realizimin e sulmeve terroriste. Vendosja e bombave në vende të frekuentuara publike, në objekte fetare, ndërtesa qeveritare, në vetura të personave të shënjestruar, prona private etj, është duke u rritur vazhdimisht. Një karakteristikë tjetër e përdorimit të bombave është edhe realizimi i sulmeve vetëvrasëse. Sulmuesit vetëvrasës që njihen si “bombat njerëzore” (human bombs) përdoren në shumë raste ku për shkak të fshehjes bombave në trup dhe për faktin se mund të arrijnë deri afër shënjestrës së tyre, paraqesin rrezik shumë më të madh. Sulmuesit vetëvrasës të njohur si “kamikazë” kanë ndërmarrë shumë herë sulme të tmerrshme terroriste duke shkaktuar viktimë të shumta dhe dëme të pallogaritshme materiale.

Përdorimi i Mjeteve të Improvizuara Shpërthyesë(MISH)krijon disa avantazhe për terroristët me rastin e kryerjes së një sulmi terrorist.Në radhë të parë përdorimi i MISH shkatërron pothuajse të gjitha provat materiale në vendin e ngjarjes,sepse fuqia e shpërthimit dhe zjarri pas shpërthimit shkatërrojnë në masë të madhe provat në vendin e ngjarjes.Arsyet tjera pse grupet terroriste i përdorin MISH në rastet e sulmeve terroriste janë: këto mjete me rastin e shpërthimit shkaktojnë vrasje dhe lëndime të shumta trupore të shumë njerëzve; shkaktojnë panik të madh te masat e njerëzve, sepse shpërthimi krijon një panik dhe pasiguri tëjashtëzakonshme në opinionin publik;përdorimi i MISH i mundëson kryerësve të akteve terroriste që lehtë të largohen (ikin) nga vendi i ngjarjes,sidomos kur ato aktivizohen për shpërthim nga distanca;me përdorimin e MISH arrihet më lehtë efekti mediatik si edhe fakti i fundit mbështetet në atë se përdorimi i MISH preferohet për shkak të lehtësisë së përgatitjes së tyre.(Material nga Akademia Policore në Ankara-Turqi,Trajnimi “Post Blast Investigation”,19.09-28.09.2007)

Përdorimi i mjeteve të transportit (vetura, kamion, anije..) të mbushura me eksploziv ka ndodhur në shumë raste, por, si rast shumë i veçantë dhe unik deri më sot është përdorimi i aeroplanëve si mjete për realizimin e sulmeve terroriste. Rasti i tillë është rrëmbimi i katër aeroplanëve më 11 shtator 2001.

Motivet të cilat i vënë në lëvizje grupet dhe organizatat terroriste janë të shumta. Terrorizmi edhe në të kaluarën,por edhe në ditët e sotme është kryer për motive politike, ideologjike,fetare,çlirimtare,financiare etj.Individë të ndryshëm të arsimuar apo të paarsimuar,të varfër apo të pasur,indoktrinohen nga rekrutuesit dhe liderët e organizatave terroriste.Roli i ideologjive qofshin ato majtiste,djathtiste,nacionaliste a teologjike është shumë i madh.Religjioni në ditët e sotme, sidomos ai i lidhur me grupet terroriste islamike, ka rol vendimtar.Kulti i martirizimit dhe përkrahja popullore për terroristët(sidomos vetëvrasës),kontributi për të luftuar për kauzën e grupit,nevoja për mbrojtje,nevoja për hakmarrje.... janë vetëm disa nga motivet që i shtojnë terroristët të ndërmarrin aksionet e tyre të terrorit.Një tjetër motiv që i shtynë shumë individ të kryejnë sulme terroriste është cenimi i shumë të drejtave që iu bëhet atyre nga autoritetet shtetërore,si e drejta në shkollim,në punë, në arsimim,liria e shprehjes, liria e lëvizjes, etj.Në pamundësi që t'i realizojnë këto të drejta dhe në pamundësi të ballafaqohen me autoritetet e atyre shteteve, shumë të rinjë ndërmarrin sulme terroriste.

Lidhur me motivet që i shtojnë individët të kryejnë sulme terroriste,shumë autor të punimeve të ndryshme shkencore sjellin shembuj ku zakonisht persona të rinjë në moshë i

bashkohen organizatave terroriste dhe në shumë raste edhe janë të gatshëm të vetëflijohen për qëllime të organizatës apo të kauzës së tyre. Varfëria, jeta në varfëri të madhe që nga fëmijëria është një ndër faktorët që ndikojnë në ngritjen e motivit për të kryer sulme terroriste. Shpesh herë edhe emocionet si zemërimi, pikëllimi, frika, kënaqësia, dashuria, befasia, neveria, turpi, i motivojnë personat e ndryshëm që të merren me aktivitete terroriste. Injoranca është tjetër faktor me ndikim në motivimin e të rinjëve për të kryer sulme terroriste, sepse ata janë të paarsimuar, të pavetëdijshëm për veprimin e tyre, dhe shpesh janë viktima të kësaj gjendje të tyre. Mashtrimet dhe manipulimet fetare janë shkaktarë të fuqishëm të motiveve për kryerjen e sulmeve terroriste. Publikimi i lajmeve të rrejshme dhe në mënyrë të pamatur nga mediat, gjithashtu kanë efekte te personat e ndryshëm që ata të motivohen për kryerjen e ndonjë sulmi. (MA. Shkelzen Marevci, "Luftimi i Terrorizmit Bashkëkohor", Botimi Prishtinë, p, 78-130)

Të gjithë personat para se të kryejnë ndonjë sulm terrorist, ata fillimisht kapen nga një ndjenjë e esktrimizmit dhe radikalizmit, e cila është si shkallë kaluese deri te terrorizmi.

Viktimat-çdo sulm terrorist ka një shënjestër dhe çdo organizatë terroriste ka caqe dhe shënjestra ku përmes sulmeve ndaj tyre synon arritjen e qëllimeve të veta. Vite më parë, në të shumtën e rasteve, cak i sulmeve terroriste kanë qenë objektet dhe zyrtarët shtetëror edhe pse vetëm një numër i vogël i tyre e kanë pësuar, ndërkaq viktimat më të mëdha kanë qenë qytetarët-kalimtarë të rastit. Zakonisht caqe të sulmeve, për vite me radhë, kanë qenë ambasadat e ndryshme të shteteve që kanë qenë shënjestër e organizatave dhe grupeve terroriste, pastaj objektet e administratës shtetërore, shtëpitë dhe veturat private të zyrtarëve të lartë politik dhe ushtarak të një shteti si dhe rrëmbimi i tyre apo i familjarëve të tyre me qëllim që të ushtrohet trysni gjatë procesit të vendimmarrjes së udhëheqësve të lartë shtetëror për ndonjë çështje që është në interes të grupeve terroriste. Vështruar në aspektin viktimologjik, viktimat e akteve terroriste mund të klasifikohen si:

- Viktima që gjoja ishin përgjegjëse apo fajtoresh, ku përfshihen njerëz në pozita të cilëve iu drejtohej kritika, qortimi dhe ataku terrorist.

- Viktima simbolike ndaj të cilave terroristët luftojnë si p.sh. simbolet tradicionale të shtetit apo kundërshtarit, përfaqësitë diplomatike, personat e uniformuar, politikanët e njohur.

- Marrja peng e viktimave, të cilët në çfarëdo forme kanë lidhje me kundërshtarët e grupeve terroriste, si mjet për shantazh, kërcënim apo edhe për t'i shfrytëzuar si mur të gjallë në rast të sulmit dhe për t'u mbrojtur gjatë ikjes.

- Viktimat jo kritike, të cilat nuk kanë lidhje me kundërshtarët e grupeve terroriste siç janë turistët, punëtorët humanitarë, gazetarët etj.(Dr.Ragip Halili,"Viktimologjia",Prishtinë 2009 , p, 94.)

Kjo ndarje dhe ky klasifikim i viktimave në trendet e tanishme të sulmeve terroriste nuk është absolut.Nga fundi i shekullit të kaluar,sidomos me fillimin e shekullit XXI nuk mund të thuhet më se kush është shënjestër e vërtetë e sulmeve terroriste.Civilët të cilët dekadave të kaluara,disi,ishin kursyer nga grupet terroriste,tanimë janë bërë shënjestër e **përzgjedhur** e akteve terroriste. "Dëmet anësore",siç njihen në literaturën ushtarake kanë qenë qytetarët e pafajshëm,nxënës shkollash,studentë,fëmijë,udhëtar,turistë apo kalimtar të rastit në ato zona ku është kryer sulmi terrorist.

1.6.Kuptimi dhe përmbajtja e sigurisë shoqërore

Njeriu dhe shoqëria që nga fillet e paraqitjes së jetës në tokë është sfiduar në mënyra të ndryshme për të mbijetuar,sepse nevoja për siguri më të madhe ka qenë gjithnjë kërkesë reale e kohës.Shoqëria njerëzore që nga zanafillat e para të mbijetesës njerëzore është përballuar me kërcënime të ndryshme dhe i janë shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe dëme të mëdha si shkaktar të vuajtjes së njerëzimit.(Doc.dr.Mevledin MUSTAFI,Siguria Publike dhe Funksonet e të drejtës Penale në Mbrojtjen e Shoqërisë Bashkëkohore, faqe 298)

Siguria është një koncept mjaft i gjerë dhe autor të ndryshëm sjellin pikëpamje të ndryshme lidhur me këtë nocion.Po ashtu,ky nocion merr kuptim të ndryshëm në vende të caktuara dhe në periudha të caktuara kohore.Nocioni tradicional i sigurisë si pikënisje ka pasur fuqinë ushtarake,vëzhgimin dhe rendin shtetëror.Këto përkufizime bazohen në tri supozime:se shteti është i vetmi përgjegjës për sigurinë;se politika e sigurisë qëllim të vetëm ka ruajtjen e gjendjes ekzistuese dhe se mbrojtja ushtarake është çështje e interesit parësor.

Me kalimin e dekadave e viteve koncepti për sigurinë ka evoluar dukshëm sepse edhe sfidat e sigurisë sidomos në periudhën e globalizimit janë të një natyre tjetër.Pikëpamjet bashkëkohore të sigurisë janë të bazuara në dy koncepte dominuese,edhe ato janë:

-Koncepti i universalitetit- i cili nënkupton përfshirjen e plotë të konceptit të sigurisë, dhe
-Koncepti i demilitarizimit i cili nënkupton shfuqizimin e lidhjes së deritanishme që i është bërë sigurisë me forcën ushtarake.(Haxhi Ferati, Gjeopolitika dhe Gjeostrategjia, Botimi mars 2013, p, 224-228)

Nocioni Siguri rrjedh nga fjala latine securitas që do të thotë,pa shqetësime dhe preokupime,gjegjësisht shmangie nga pasiguria,evitimi nga kërcënimet dhe rrezikimi i sigurisë,

po ashtu përfshihet edhe mbrojtja e qytetarëve nga kriminaliteti, ekstremizmi politiko-religjioz, terrorizmi etj. Më e rëndësishmja në këtë kontekst është sigurimi i sistemit politik nga armiqtë e brendshëm. Nga ana tjetër sipas një definicioni të reduktuar, siguria është mënjanimi i të gjitha aktiviteteve që synojnë të rrezikojnë personat, rendin kushtetues, objektet apo hapësirën e caktuar. (Mevledin Mustafi, PhD UDC: 378.091:355.45 Shoqëria Bashkëkohore në sisteme të sigurisë ndërkombëtare, kërcënimet ndaj mbijetesës dhe ballafaqimet me sfidat e sigurisë në të ardhmen, p, 170)

Siguria është funksioni themelor i secilit shtet, për shkak se pa një nivel përkatës të sigurisë nuk mund të flitet as për pushtet demokratik, as për stabilitet shoqëror në përgjithësi. Siguria është një prej parakushteve fundamentale për ekzistencën e bashkësisë shoqërore.

KAPITULLI II:

2. Format dhe përhapja e ekstremizimit

2.1 Terrorizmi ndërkombëtar si problem i paqes dhe sigurisë botërore

Sulmet e 11 shtatorit të vitit 2001 kanë pasur ndikim të madh në zhvillim e rrjedhës së ngjarjeve si në fushën e sigurisë,të politikës,por,edhe në fusha të tjera.Këto sulme kanë detyruar shtetet e ndryshme që të rishikojnë edhe një herë gjendjen dhe të ballafaqohen me sukses me kërcënimet.Sulmet e 11shtatorit e kanë futur botën në një periudhë të re të zhvillimit të terrorizmit,sepse realisht në krahasim me sulmet e më hershme terroriste,pas këtyre sulmeve,vërejmë disa karakteristika veçuese të grupeve terroriste sa i përket natyrës së sulmeve si dhe përzgjedhjes së shënjestrave,bashkëpunimit ndërkombëtar mes grupeve dhe organizatave terroriste.

Përveç shkallës së pasojave të shkaktuara dhe gatishmërisë për të kryer sulme në çdo kohë dhe në çdo vend,terrorizmi pas sulmeve të 11 shtatorit ka marrë disa karakteristika të veçanta, të cilat e dallojnë dukshëm nga periudhat e mëhershme si për nga forma e kryerjes së sulmeve,e po ashtu edhe për nga mënyra e organizimit dhe funksionimit të grupeve terroriste:

- Strehimi i terroristëve nëpër regjione të pakontrolluara në tërë botën,si në zona mes Afganistanit dhe Pakistanit, Irakut, pjesë të Jemenit, disa zona në shkretëtira në mes të Malit, Mauritanisë dhe Algjerisë ,ku në këto zona, me mijëra aktivistë dhe militantë mund të kryejnë trajnime të papenguara nga askush dhe mundësia e hetimit të aktiviteteve të tilla në këto zona është shumë e vogël;

- Kamuflimi dhe fshehja e terroristëve në zona urbane,në mes të popullatës civile;
- Frika dhe shqetësimi më i madh i tërë shteteve demokratike, të cilat në çfarëdo forme janë të angazhuara në luftën kundër terrorizmit,është mundësia e përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë nga ana e grupeve dhe organizatave terroriste.(John Gearson,“The nature of Modern Terrorism”, E# 2737, faqe 12, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”,Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Terroristët,të cilët synojnë të përdorin armët e shkatërrimit në masë nuk brengosen për vrasje masive;qëllimi i tyre është që të fitojnë publicitet,të shfrytëzojnë propagandën për ndikim në njerëz, të shkaktojnë frikë e kolaps, detyrim në kapitullim dhe demoralizim, kërcënim me aktivizim të bombës atomike, të përhapin dozat vdekjeprurëse të radiacionit në atmosferë dhe forma tjera kërcërimi e manifestimi.

Disa karakteristika të tjera të cilat e dallojnë terrorizmin në botën bashkëkohore janë edhe numri shumë i madh i viktimave të sulmeve terroriste,ku shumica dërmuese e këtyre viktimave janë civilë të pafajshëm.Caqe të sulmeve terroriste viteve të fundit janë vendet e frekuentuara nga qytetarët (qendrat tregtare,stacionet,sheshet,objektet e kultit,etj),ndërsa llojlojshmëria e armëve dhe mjeteve me të cilat kryhen aktet terroriste është e madhe dhe e pallogaritshme.

2.2 Terrorizmi pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA

Sulmet e 11 shtatorit në SHBA konsiderohen si sulmet më të mëdha terroriste në historinë e njerëzimit.Si për nga numri i viktimave,si për nga mënyra e ekzekutimit këto sulme kanë dëshmuar se asnjë shtet,asnjë komb nuk është imun dhe imbrojtur nga terrorizmi. Sulmet e 11 shtatorit 2001 janë ngjarje e cila ka ndryshuar rrjedhën e historisë botërore sepse pas këtij sulmi u morën vendime të rëndësishme dhe filluan edhe luftra të reja duke i dhënë një dimension krejt tjetër terrorizmit dhe luftimit të tij.Një avion i errët si hije që zhytej mes xhamave dhe çelikut;njerëz që varehin nëpër parmakët e dritareve dhe pastaj lëshoheshin në boshllëk;ulurimat dhe dënesjet poshtë dhe,në fund re pluhuri me shtëllunga që zinin diellin. Me 11 shtator amerikanët patën ndjesinë se bota e tyre u përmbys.(Prof.Dr.Vesel Latifi, “Kriminalitika”,Prishtinë 2011, p, 311)

Pas hetimeve të para lidhur me sulmet terroriste të “11 shtatorit”,FBI shumë shpejt doli me konstatimin se përgjegjës kryesor për këto sulme ishte Al-Qaeda.Për autoritetet më të larta amerikane,duke filluar nga presidenti Bush,Senati dhe Kongresi,ishte shumë e lehtë që të drejtohet gishti drejt fajtorëve,dhe fajtorë ishte Al-Qaeda dhe rrjedhimisht edhe qeveria Talebane në Kabul,të cilët nga viti 1996 ofronin strehim për organizatën e Bin Ladenit.

Përveç masave urgjente që u ndërmorën në orët e para pas sulmit,si mbyllja e hapësirës ajrore amerikane dhe masa tjera parandaluese,presidenti Bush ndërmori disa veprime të shpejta si aktivizimi i komponentës rezervë të ushtrisë,shtimin e kompetencave për Zyrën e Thesarit,krijoi Zyrën dhe Këshillin “Homeland Security” (HMS) për koordinimin e të gjitha aktiviteteve anti-terroriste.(Michel N. Schmitt,” Counter-Terrorism and the use of force in International Law”, p 5)

Këto dhe disa veprime të tjera ishin mesazh i qartë se SHBA-të nuk do të rrinin duarkryq pas katastrofës që i kishte goditur.Në anën tjetër, Kongresi Amerikan autorizoi presidentin Bush që të përdorte forcën ushtarake ndaj atyre që kishin sulmuar SHBA-të.(Michel N. Schmitt,” Counter-Terrorism and the use of force in International Law”,Faqe 5)Për më pak se

një muaj nga sulmet e “11 shtatorit” erdhi edhe kundërpërgjigjja ushtarake amerikane ndaj Afganistanit.

Një javë pas sulmeve të 11 shtatorit, Senati votoi 98 me 0 dhe Kongresi 40 me 1 për t'i dhënë Presidentit autoritetin, që të përdorte të gjitha forcat e nevojshme dhe të përshtatshme kundër atyre vendeve, organizatave ose personave që ishin prapa sulmeve. Interesimi për forcat e armatosura dhe kërkesat për t'u futur në CIA u rritën ndjeshëm, ndërsa në të gjithë Amerikën të rinjtë vendoseshin në shërbim të vendit. (Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p.346)

Më 6 Tetor 2001 presidenti Bush bëri kërcënimin e fundit, ndërsa më 7 tetor 2001 filloi sulmi ajror ushtarak në caqet e Al-Qaedas dhe Talebanëve në Afganistan. Menjëherë filloi edhe implementimi i operacioneve nga toka dhe deti. Me ndihmën edhe të ushtarëve të Aleancës së Veriut, trupat amerikane përparuan shpejt dhe për një kohë të shkurtër pushtuan tërë Afganistanin duke rrëzuar Qeverinë Talebane.

Aktivitetet terroriste të Al-Qaedas dhe Talebanëve pas pushtimit të Afganistanit, posaçërisht pas vitit 2002 janë rritur në mënyrë rapide. Me kalimin e muajve, konkretisht gjatë verës së vitit 2002 shumë operativë të nivelit të mesëm të Al-Qaeda-s, morën në dorë organizatën dhe filluan organizimin e shumë sulmeve terroriste, dhe në këtë kohë Al-Qaeda ishte po aq e fuqishme sa në kohën kur udhëhiqej nga vetë Osama Bin Laden nga territori i Afganistanit. (Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p. 346) Pas verës së vitit 2002 e këtëj, Al-Qaeda dhe Talebanët ndërmorën me dhjetëra e qindra aksione kundër trupave të ISAF-it dhe forcave ushtarake e policore afgane. Në shumë raste shënjestër ishin edhe civilët e pafajshëm, të cilët goditeshin pa mëshirë nëpër vende të frekuentuara publike.

Lufta në Afganistan në mes të forcave të ISAF-it dhe Qeverisë së Kabulit në njërën anë dhe militantëve të Al-Qaedas dhe Talebanëve në anën tjetër, ka pasur ndikim të madh në rritjen e numrit të sulmeve terroriste, jo vetëm në rajon, por në tërë botën. Në këtë aspekt, efektet e luftës në Afganistan së tepërmi janë ndjerë në Pakistanin fqinj, ku qeveria e Islamabadit i kishte lejuar SHBA-ve dhe aleatëve të saj të shfrytëzojnë hapësirën tokësore dhe ajrore për furnizimin e trupave në Afganistan. Lëvizjet e trupave aleate nëpër Pakistan kanë qenë shënjestër e lehtë dhe e vazhdueshme e sulmeve të militantëve Taleban (si atyre afgan e po ashtu atyre pakistanez). Pas sulmeve të tilla gjithnjë kishte një përgjigje të dhunshme nga ushtria e Pakistanit ndaj grupeve militante apo kishte edhe sulme me aeroplan pa pilot nga Ushtria amerikane, sulme këto që shoqëroheshin me “dëme kolaterale” (dëme

anësore) në civil. Kjo pastaj, ishte arsye e mjaftueshme e militantëve islamikë për të sulmuar policinë, ushtrinë dhe qytetarët në qytetet e mbipopulluara të Pakistanit, sepse në rastet e reagimeve të tilla të autoriteteve pakistaneze, militantët kishin një “arsye” më shumë për të besuar se qeveria përkrahte dhe punonte për interesat amerikane në rajon. Në këtë mënyrë është krijuar një rreth vicioz, ku për çdo sulm realizohej edhe një sulm tjetër si hakmarrje.

Për herë të parë që nga themelimi i saj në vitin 1949 NATO iu referua nenit 5 të kartës së saj, duke rënë dakord që një sulm ndaj njërit prej anëtarëve të saj do të konsiderohej si sulm ndaj të gjithë të tjerëve. Me të drejtën që i takonte dhe me mbështetjen nga të tjerë, SHBA -të brenda një muaji arritën që të përzënë nga Kabuli qeverinë e Talebanëve, ndërsa militantët e Al- Qaedas u vranë, u arratisën ose u kapën. Mungesa e presionit të mjaftueshëm ushtarak në Tora Bora bëri që Osama Bin Laden të mund t’u shpëtonte nga duart. (Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, Faqe 247)

Por, pas luftës në Afganistan beteja kundër terrorizimit mori një kahje të papritur, tani në shënjestër ishte Iraku. Në vend të një vlerësimi të ndershëm të aprovimeve dhe kundërshtimeve të fushatës ushtarake, Administrata Amerikane nisi një ofensivë në fushën e marrëdhënieve me publikun; fshehu raportet e shërbimve sekrete, për të mos cenuar kauzën e vet, duke minimizuar në mënyrë trashanike sa kostot, ashtu edhe numrin e njerëzve që nevoiteshin për veprim ushtarak, duke evokuar fantazmën e këpurdhave atomike. Aty nga vjeshtat e vitit 2002, shumica e amerikanëve ishin të bindur se Sadam Huseini posedonte armë të shkatërrimit në masë dhe të paktën 66 % e tyre besonin (në mënyrë të gabuar) se lideri i Irakut ishte i përfshirë në sulmet e 11 shtatorit. (Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 248)

Sadami mund të kishte armë kimike bakteriologjike dhe, mund të kishte dëshirë të kishte edhe armë bërthamore. Për vite të tëra ishte talluar me rezolutat e OKB-së dhe kishte kryer krime të ndryshme ndaj popullësisë në shtetin e tij, sidomos ndaj kurdëve. Por, ai asesi nuk ishte aq naiv sa të mbështeste organizatat terrosite dhe Al-Qaedan, e aq më pak të përfshihej në sulmet e 11 shtatorit kundër Amerikës.

Logjika e Administratës së Bush-it për nevojën e luftës në Irak, ishte e brishtë dhe e motivuar ideologjikisht, kur nuk kishte mbaruar ende plotësisht as lufta në Afganistan. Lufta në Irak ishte një luftë e verbër, e nxituar, e bazuar në pasion dhe jo në arsye, një luftë e bazuar në politikë dhe jo në parime. Lufta në Irak kërkonte një operacion ushtarak që nuk dihej sa do të zgjaste, sa do të kushtonte dhe çfarë pasojash do të kishte. Okupimi i Irakut pa ndonjë bazë të fortë logjike dhe pa mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, do të kufizohej, do të prodhonte vetëm nxitjen e flakëve në Lindjen e Mesme, do të inkurajojë ndjenjat më të këqija amerikane

në botën arabe dhe, do të ndikonte në forcimin e radhëve të Al-Qaedas.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi,p 350)

Dhe ,vërtetë lufta në Irak kishte këto pasoja,ku dallimet sektare u theksuan edhe me shumë,ku militantët e sekteve të ndryshme u infiltruan edhe në radhët u forcave të rendit që po ringriteshin në Irakun post Sadam Husein-ist.Në Irakun e pas okupimit përveç problemeve sektare ,një problem që po ndikonte në përkeqësimin e situatës së sigurisë ishte edhe varfëria e madhe,ku p.sh në krahinën Anbar papunësia arrinte deri në 70 % te meshkujt(për punësimin e femrave as nuk ia vlen të flitet).Një fëmijë i mitur për 2-3 dollarë mund të hidhte një bombë në drejtim të forcave amerikane, apo atyre irakiane.Ndërtimi i shkollave,rrugëve,spitaleve, stacioneve elektrike,mbajtja e hapur e rrugëve të furnizimeve etj, kishin për qëllim që sadopak të zbusin zemërimin e popullësisë ndaj forcave amerikane.Përpyekjet për të ringritur Irakun ishin të mëdha pasi qëllimi kryesor ishte që Iraku të mos bëhej bazë për veprime terroriste.(Barak Obama,“Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 355-357)Por, nëse i referohemi zhvillimeve të mëvonshme në Irak dhe në shtetet e tjera në atë rajon(Irak ,Siri) pikërisht ka ndodhur e kundërta, sepse militantët nga e gjithë bota arabe dhe më gjerë erdhën në Irak,duke u stërvitur,duke kryer sulme terroriste dhe duke sfiduar seriozisht forcat amerikane.Vetë krijimi i mëvonshem i ISIS në këtë pjesë të botës tregon më së miri se amerikanët kishin dështuar që të evitonin terrorizmin dhe krijimin e terroristëve të rinjë në Irak.

Pushtimi i Irakut qartësisht u bë një nga arsyt kryesore për rritjen e aktiviteteve terroriste në Lindjen e Mesme.Më 19 mars 2003 një koalicion i forcave të përbëra nga SHBA-të me 148.000 trupa, Mbretëria e Bashkuar me 45.000 trupa,Australia me 2000 trupa dhe Polonia me 194 trupa, sulmuan Irakun,dhe deri më 9 Prill 2003 i tërë vendi u pushtua dhe me këtë edhe regjimi i Sadam Huseinit u rrëzua. Në këtë fitore dhanë kontribut edhe forcat kurde, të cilat zhvilluan disa beteja në Veri të Irakut.

Iraku pas vitit 2003 u bë strehë për shumë terroristë nga rajoni dhe bota,dhe situata vetëm disa muaj pas invadimit filloi të marrë drejtim të rrezikshëm.Iraku për shkak edhe të pozitës së përshtatshme gjeografike ishte shndërruar në vendstrehim për militantët islamik, por edhe si vend transit,sidomos për anëtarët e Al-Qaeda-s.Sulmet terroriste ndaj forcave ndërkombëtare filluan të bëhen përditshmëri,ku viktima të këtyre sulmeve çdo ditë e më shumë ishin edhe civilët irakianë.Nëvitin 2004 organizata“Al-Tawhid wal-Jihad”, ethemeluar nga Abu Musab Al Zarqawi u shndërrua në Al-Qaeda-n,dega në Irak.Dega e AQ në Irak luftonte kundër prezencës së trupave amerikane dhe perëndimore në Irak si dhe për shkak të përkrahjes perëndimore për krijimin dhe ekzistimin e shtetit të Izraelit.

Është fakt i pamohueshëm se popullsia myslimane në Lindjen e Mesme me një përqindje të madhe ka ndjenja dhe disponim anti-amerikan dhe anti-perëndimor. Ky disponim i tillë i ka rrënjët, sidomos që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, saktësisht nga viti 1947, me rastin e krijimit të shtetit të Izraelit në territoret arabe të Palestinës. Përkrahja e vazhdueshme e perëndimit dhënë Izraelit në çdo fazë, dhe për çdo çështje ka nxitur zemërim dhe urrejtje të madhe tek popullsia myslimane në Lindjen e Mesme. Lufta e Gjirit Persik në vitin 1990 dhe vendosja e trupave perëndimore, poashtu ishte një tjetër faktor i rritjes së mëtutjeshme të urrejtjes ndaj Perëndimit, edhe pse qeveritë e shteteve arabe dhe shteteve të tjera në Lindjen e Mesme, në masë të madhe ishin servile ndaj kërkesave amerikane, gjithnjë në këmbim të ushtrimit të diktaturës për të mbajtur pushtetet e tyre familjare.

Pushtimi i Afganistanit dhe Irakut ishte kulminacioni i padrejtësive sipas konceptit të shumë qytetarëve të Lindjes së Mesme, por edhe me gjërë. Urrejtja e akumuluar për disa dekada, tanimë kishte shpërthyer dhe nën ndikimin e zhvillimeve në Afganistan, e sidomos në Irak. Në vitet në vazhdim, bota njohu disa sulme terroriste shumë të mëdha, me pasoja katastrofale, sulme të cilat ishin të ideuara, motivuara nga krerët e Al-Qaedas, të strehuar në Pakistan.

Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit. Nuk ka asnjë profil të vetëm i cili do të përfshinte të gjithë terroristët, sikundërse nuk ekziston asnjë rrugë “e prerë me thikë”, e cila i çon individët në rrugën drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërthurur në mënyrë unike për çdo rast specifik. Profilet që ndërtohen mbi bazën e supozimeve të stereotipizuara, mbi bazën e përkatësisë fetare, racore, etnike, gjinore, statusit shoqëror dhe ekonomike etj, jo vetëm që janë diskriminuese, por po ashtu janë edhe të paefektshme. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së hedhin poshtë me vendosmëri identifikimin e terrorizmit me kombësinë, përkatësinë fetare apo etnike. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht kjo mund ta bëjë një individ të mbështesë, të veprojë në mbështetje apo të përfshihet në terrorizëm. Megjithatë, nuk ka asgjë të prerë sa i përket rrugës së përfshirjes në terrorizëm. Radikalizmi terrorist mund të ndodhë në një sërë rrethanash nga më të ndryshmet dhe me shpejtësi po kaq të ndryshme. Çdo rast radikalizmi terrorist dhe rekrutimi për qëllime terrorizmi është rezultat i një ndërthurjeje unike të një mjedisi lehtësues me rrethanat dhe psikologjinë personale të çdo burri apo gruaje.

Ekzistojnë një numër kushtesh strukturore të natyrës sociale, ekonomike dhe politike që mund t'i shtyjnë individët drejt terrorizmit, të tilla si: diskriminimi dhe forma të tjera të shkeljes së

të drejtave të njeriut (duke përfshirë ato që vijnë si rezultat i masave antiterrorizëm), mungesa e aksesit në arsim etj, të cilat nuk mjaftojnë në vetvete për t'u konsideruar si radikalizëm terrorist. Është e rëndësishme të mbahen parasysh një sërë faktorësh të tjerë psikologjikë, ndërpersonalë dhe ideologjikë për të shpjeguar mobilizimin. Këta faktorë mund të shpjegojnë se përse një individ i caktuar mund të ndjekë një rrugë të radikalizmit terrorist, ndërsa një tjetër me rrethana dhe historik të ngjashëm të mos e bëjë një gjë të tillë. Faktorët psikologjikë dhe njohës, si p.sh. imazhi për vetveten, ndjesia e identitetit dhe përkatësisë, pritshmëritë, besimet dhe qëndrimet janë dinamike dhe formësojnë mënyrën sesi një person i përjeton dhe reagon ndaj mjedisit dhe ngjarjeve të tij/ saj. Ato mund të ndikojnë në zhvillimin e ndjenjave negative të zhvendosjes, së të qenit “ndryshe”, për shembull, të ndjenjat e të qenit i përjashtuar, i refuzuar, privimi relativ, ndjenjat e poshtërimit, viktimizimit, padrejtësisë, zhgënjimit, revoltës apo epërsisë. Kjo mund ta shtyjë dikë të jetë pre e terrorizmit më shumë nga të tjerët. Të rinjtë shpesh kanë rezultuar më të dobët ndaj VERLT, në përshtypje me çështjet e identitetit, vendit të tyre në botë dhe të ardhmes, ata janë më të prirë për të marrë në “sy” rrezikun dhe për të sfiduar gjendjen ekzistuese. Cenueshmëria psikologjike mund të rritet papritur dhe në mënyrë dramatike, si rrjedhojë e traumës së shkaktuar nga një ngjarje e cila ka ndikuar rëndë dhe ndjeshëm tek një person (Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin, Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Vjenë, mars 2014, p.37)

Autorë të tjerë të cilët e kanë studiuar radikalizimin dhe terrorizmin sjellin edhe arsye të cilat ndikojnë në masë të madhe në rritjen e nivelit të ekstremizmit dhe radikalizmit. Shkaqe të tilla mund të jenë:

- Nxitja ekonomike- sociale;
- Perceptimi i përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit;
- Rrjetet shoqërore dhe dinamikat brenda grupeve;
- Diskriminimi shoqëror;
- Nevojat sociale dhe ekonomike të papërbushura;
- Nxitësit politik;
- Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile;
- Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut;
- Nxitësit “pushtim i huaj” dhe “cënim politik ose ushtarak”;
- Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave të fuqishme;
- Zonat e paqeverisura ose me qeverisje të dobët;
- Kërcënimi apo frikësimi nga grupet ekstremiste të dhunshme;

- Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shtete/popujt musliman;
- Nxitësit kulturor;
- Perceptimet e sulmeve kundër islamit;
- Kërcënimi i përgjithshëm ndaj kulturës;
- Axhendat “portative” fetare.(Radikalizmi i dhunshëm dhe ekstremizmi në Shqipëri, Botimi 2015, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetesim (IDM), p,39-94.)

Sulmet e 11 shtatorit në SHBA kanë krijuar rrethana krejtësisht të reja në zhvillimet globale në fushën e sigurisë dhe të politikës.Sfidat në luftën kundër terrorizmit,krimit të organizuar,sfidat ndaj fatkeqësive natyrore,kërcënimeve të përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë etj,kërkojnë një angazhim maksimal të të gjitha kapaciteteve të organizatës. Ballafaqimi me këto sfida, por jo vetëm këto, kërkon një bashkëpunim dhe koordinim edhe më të madh së pari të vet anëtarëve të organizatës,të organizatës me shtetet partnere dhe me shtetet tjera jo partnere(fuqitë tjera botërore si Rusia, Kina, India etj), si dhe bashkëpunimin me organizata të tjera ndërkombëtare dhe rajonale si OKB, BE etj.

Përgjegjësia e kufizuar e deritanishme e NATO-s për të mbrojtur vetëm shtetet anëtare,tani më i takon të kaluarës sepse pritet ndaj kësaj organizate në shekullin e ri janë shumë më të mëdha.Roli i NATO-s edhe në zonat tjera të krizës si Lindja e Mesme, Afrika e Veriut apo Kaukazi Verior me kalimin e viteve do të jetë dukshëm më i madh, sepse NATO tani më po na bind se përkundër dallimeve historike të shteteve anëtare ,megjithatë është një organizatë shumë e fuqishme ndërkombëtare,roli i së cilës po bëhet gjithnjë e më vendimtar.Sipas strategjisë së re NATO-ja do të evoluoj nga një Aleancë e mbrojtjes kolektive në një Aleancë me mision edhe të menaxhimit të krizave,përkatësisht të menaxhimit të sigurisë në kuptimin më të gjërë,për të arritur kështu të përfaqësoj një komunitet vlerash si demokracia dhe të drejtat e njeriut, po aq sa edhe një komunitet interesash.(Haxhi FERATI, “ Gjeopolitika dhe Gjeostrategjia”, p,247, Prishtinë 2013)

2.3Rruga që ndjekin ekstremistët për t’u rekrutuar në organizatat terroriste

Ekstremizmi i dhunshëm kulmon me radikalizëm dhe terrorizëm.Asnjë shoqëri nuk është immune ndaj rrymave ekstremiste të cilat me kalimin e kohës prodhojnë individ me potencial për të ndërmarrë veprime terroriste.Këtu nuk duhet kufizuar mendimin vetëm për rrezikun e ekstremizmit islamik në vendin tonë,në rajon apo edhe më gjerë.Po aq i rrezikshëm sa ekstremizmi islamik është edhe ekstremizmi i formave dhe ideologjive të tjera , veçanërisht ekstremizmi djathtist në disa shtete të Evropës Perëndimore e Lindore (Gjermani,

Poloni),edhe në SHBA është në rritje e sipër ky lloj ekstremizmi.Grupe neo-naciste me politika të ashpra kundër të huajve dhe njerëzve me ngjyrë kanë kryer dhe kryejnë njëmori sulmesh duke ndjellur frikë e pasiguri të madhe.

Grupet terroriste në tërë botën kanë nevojë për njerëz.Pa burime të mjaftueshme njerëzore nuk mund të zhvillohet aktiviteti i grupi terrorist.Për këtë arsye individët me ndikim në shoqëri të caktuara shfrytëzohen nga grupet terroriste,ku fillimisht aplikohet një kampanjë e propagandës e cila përmban doza të larta të ekstremizmit fetar,e më tutje duke vazhduar me shpërlarjen e trurit individët e njejtë radikalizohen dhe arrijnë deri në atë pikë sa t'i bashkangjiten grupeve terroriste dhe duke kryer edhe sulme terroriste.

2.4 Roli i religjionit në ekstremizëm dhe radikalizëm që shpie në Terrorizëm

Feja është një shprehje e kulturës e jo burim i saj,ajo është një nga mënyrat-jo domosdoshmërisht mënyra më e mirë-me të cilën njeriu mundohet të zotërojë atë çka nuk mund të njoh dhe të kuptojë të vërtetat më të thella të jetës.Feja bazohet në të vërteta të pa demonstrueshme nëpërmjet arsyesimit normal të njeriut dhe bazohet në besimin në gjërat që nuk shihen.Feja është një fenomen që duhet të trajtohet me respektin e duhur dhe me distancën e duhur emocionale.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet”Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 249-266)

Ndikimi i fesë në politikë duhet të jetë me të vërtetë i shëndetshëm,një frenim për ambiciet personale,një savurre si ajo e anijeve për të mos u dhënë ndaj ëndrrave të sotme që shtynjë drejt nevojës për reputacion personale dhe oportunitizëm politik.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 249-266)

Rrallë ndodh që feja të praktikohet e izoluar, feja është e organizuar dhe më e pakta është mjaft publike.Besimtarët mund të ndihen të shtyrë nga feja e tyre që të praktikojnë atë kudo dhe kurdo që u jepet rasti.Atyre mund t'u duket se shteti laik nxit vlera që e fyejnë drejtpërdrejt besimin e tyre. Ata mund të duan që e tërë pjesa tjetër e shoqërisë të njohë dhe të përforcojë pikëpamjet e tyre.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 249-266)

Diskutimet politike lidhur me fenë nuk janë shumë të shpeshta, sepse pjesëmarrësit nëpër gara të ndryshme zgjedhore,por edhe zyrtarët shtetëror i shmangin diskutimet lidhur me vlerat e religjionit nga frika se mos fyhet dikush tjetër,besimtarët e besimeve të tjera.Edhe në ato pak diskutime që bëhen për fenë në debate publike gjithmonë trajtohet vetëm aspekti negativ i fesë.Eventualisht mund të ketë debat shumë sipërfaqësor lidhur me praktikimin e saj, por pa u thelluar në vlerat e vërteta pozitive që ka feja në një shoqëri. Dhe në këtë mënyrë duke iu shmangur debatit lidhur me fenë,krijohet një boshllëk,dhe ne automatikisht i krijojmë

mundësi personave me njohuri të kufizuara dhe me vizion shumë të ngushtë për fenëqë ata me cinizëm të shfrytëzojnë këtë mundësi për qëllimet e veta përçarëse.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 249-266)

Për të tejkaluar këto probleme lidhur me ndikimin e fesë, debatet mes personave me prirje laike dhe fetare duhet të jenë më të shpeshta dhe më publike,dhe kështu tensionet dhe dyshimet në mes të dy palëve duhet të përballohen me sinqeritet dhe të dyja palët duhet të pranojnë disa rregulla bazë për të vazhduar debatin.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 249-266)

Vetëm gabimi ka nevojë për mbështetjen e shtetit,sepse e vërteta mund të qëndroje vetë , madje më mirë akoma..... pa mbështetjen e tij. .(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p,264)

Për historinë,gjeografinë,kulturën,traditën,religjionin që e ka çdo vend është unik.Mrekullitë e globalizmit mundet poashtu që të nxisin paqëndrueshmëri ekonomike, përhapjen e pandemive dhe të terrorizmit.Globalizmi ka të bëjë jo vetëm me sfidat e ekonomisë, por edhe me sfidat e reja në fushën e sigurisë. (Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p,344)

Rrjetet terroriste mund ta përhapin doktrinën e tyre sa i hap e i mbyll sytë; do të kërkojnë të godasin hallkat më të dobëta të sistemit ekonomik duke e ditur se një sulm në Londër ose Tokio do të ketë ndikim në Nju Jork ose Hong Kong;armë dhe teknologji deri një pronë ekskluzive e shteteve tani mund të blihen në tregun e zi dhe mund të bien në dorë të terroristëve,modelet e tyre të projektimit mund të shkarkohen dhe shkarkohen nga interneti, qarkullimi i lirë i njerëzve dhe i mallrave përmes kufijve si elementi jetësor i ekonomisë globale mund të shfrytëzohet për qëllime vrastare.(Barak Obama, “Guximi për të shpresuar”, Botimet “Dudaj” Tiranë 2008, Përkthyer nga Diana Ndroqi, p, 363)

Edhe më tutje ekziston rreziku serioz që armët e shkatërrimit në masë të bien në duart e terroristëve pasi që regjimet e ndryshme kriminale,kontribuojnë në rrëzimin e shteteve të ndryshme (BRRS, SIRIA),korrupsioni i lartë tek ushtarakët,varfëria e shkenctarëve dhe rrënimi i plotë i sistemeve të kontrollit,krijon mundësi që materialet dhe tekonologjia e rrezikshme bërthamoe të bien në duart e terroristëve dhe të përdoren nga ta.

Pjesa e dytë: Pjesa ligjore

KAPITULLI III:

3. Aspektet e drejtësisë penale, terrorizmi dhe konceptet e përgjithshme të saj në Kodin Penal të Kosovës

Trajtimi i terrorizmit si vepër penale dallon mjaft nga trajtimet sipas këndvështrimeve të tjera që i bëhen terrorizmit. Kjo për arsye se studimi nga ky këndvështrim është më i fokusuar dhe trajton çështjet kryesore të terrorizmit, ka për qëllim sqarimin e atyre karakteristikave, që përbëjnë elementet e figurës së veprave penale të terrorizmit në mënyrë që çdo veprim i ndonjë individi apo grupi, të mund të konsiderohet ose jo, si vepër penale e terrorizmit, e paraparë sipas Kodit Penal të Kosovës. Është e evidente se terrorizmi është trajtuar dhe duhet trajtuar edhe nga këndvështrime të tjera, qofshin ato kriminologjike (fenomenologjike, etiologjike), psikologjike e sociologjike.

3.1 Përkufizimi i terrorizmit sipas Kodit Penal të Kosovës

Kodi Penal i Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2013 ka avancuar dukshëm me kodin paraprak sa i përket rregullimit të neneve me të cilat veprimet e ndryshme kundërligjore konsiderohen vepra penale. Në nenin 135, "Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit" për qëllime të neneve 121-145, paragrafi 1, në mënyrë mjaft gjithpërfshirëse e përkufizon terrorizmin si një vepër penale. Sipas këtij neni *terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit-nënkupton* kryerjen e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare: (Kodi Penal i Kosovës, Neni 135, paragrafi 1)

1.1 Vrasja apo vrasja e rëndë në shkelje të nenit 178 dhe 179 të këtij Kodi;

1.2 Shtytja apo ndihma në vetëvrasje në shkelje të nenit 183 të këtij Kodi;

1.3 Sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor në shkelje të neneve 187-189;

1.4 Veprat penale kundër integritetit seksual në shkelje të neneve 230-232, 235-239 dhe 241 të këtij Kodi;

1.5 Marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria në shkelje të neneve 175, 194 ose 196 të këtij Kodi;

1.6 Ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore, ndotja ose shkatërrimi i mjedisit në shkelje të neneve 270 dhe Kapitullit XXVIII të këtij Kodi;

1.7 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, zjarrvënia apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia në shkelje të neneve 334 dhe 365 të këtij Kodi;

1.8 Shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik në shkelje të neneve 129, 366, ose 380 të këtij Kodi;

1.9 Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;

1.10 Përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumtimet për ose ndërtimi i armëve biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;

1.11 Rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht në shkelje të nenit 173 të këtij Kodi;

1.12 Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 174 të këtij Kodi;

1.13 Rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes në shkelje të nenit 164 ose rrëmbimi i mjeteve tjera të transportit publik apo të transportit të mallrave;

1.14 Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil në shkelje të nenit 165 të këtij Kodi;

1.15 Rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar në shkelje të nenit 166 të këtij Kodi;

1.16 Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental;

1.17 Përvetësimi, përdorimi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare, në shkelje të nenit 176;

1.18 Kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare në shkelje të nenit 177 të këtij Kodi;

1.19 Kanosja për kryerjen e ndonjëres prej veprave të cekura në nenet nga 1.1 deri 1.18 të këtij paragrafi.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 58-60)

Në këtë paragraf të Kodit Penal të Kosovës janë përmbledhur 68 vepra penale si dhe kanosja për të kryer ndonjëren prej tyre,të cilat konsiderohen si vepra terroriste nëse kryhen për qëllime terroriste.Të gjitha këto vepra penale në mënyrë individuale janë të sanksionuara në Kodin Penal të Kosovës,nëpër kapituj të ndryshëm dhe për to janë paraparë sanksione të veçanta, mirëpo në këtë nen (135), siç u cek më lart, këto veprime sanksionohen nëse me to është kryer një vepër penale e cila për nga shënjestra,qëllimi dhe karakteristikat tjera mund të konsiderohet si vepër penale e terrorizmit.Në rastet kur kryhet një ose disa nga veprat e lartcekura,me qëllim të frikësimit të popullsisë,me qëllim të detyrimit të padrejtë të institucioneve të veprojnë apo të mos veprojnë lidhur me një çështje të caktuar,apo me qëllim të destabilizimit apo të shkatërrimit të strukturave shtetërore në tërë shtetin apo në një pjesë të tij, atëherë veprat e tilla do të konsiderohen si vepra penale terroriste.Në të kundërtën,nëse mungojnë këto qëllime apo veprat kryhen për qëllime të tjera,kryerësi do të përgjigjet për atë vepër penale konkrete e jo për vepër të terrorizmit.

Kodi Penal i Kosovës përmban tri elemente thelbësore për t’u konsideruar një vepër si vepër terroriste. Për t’u konsideruar vepër penale e natyrës terroriste çdo veprim duhet që në mënyrë kumulative të përmbajë këto elemente,ose përndryshe mungesa e ndonjërit nga këto elemente mund të përbëjë vepër të natyrës tjetër ,por jo vepër penale terroriste.Ndërmarrja e veprimit me *qëllim të frikësimit serioz të popullatës;me qëllim të detyrimit të padrejtë* të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre,me *qëllim që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë* strukturat themelore politike,ekonomike ose sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare.

a) Fondet

Në nenin 135, paragrafi 2, ligdhënësi ka bërë interpretimin autentik të kuptimit të shprehjes “fonde” duke mos lënë shumë hapësirë dhe mundësi për interpretim nga organet ligjzbatuese, sepse interpretimi autentik i obligon gjykatat dhe organet tjera ta zbatojnë ligjin ashtu siç e ka interpretuar ligdhënësi.Shprehja“**fonde**” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe

dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë dhe pa u kufizuar në kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letër- kreditë. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 135, paragrafi 2) Pra çdo person i cili grumbullon fonde të tilla dhe të cilat në çfarëdo forme do të përdoren për aktivitete terroriste do të konsumonte veprën penale.

b) Burimet financiare

Shprehja “**burime financiare**” përfshin, por nuk kufizohet në dhënien me qira të objekteve e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejtshëm, shërbimet financiare, pajset, personelin, armët, mjetet e transportit, pajset e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 135, paragrafi 3)

c) Grupi terrorist

Ndërsa sipas paragrafi 3 të nenit 135 me “**grup terrorist**” nënkuptohet grupi i strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit. Grup i strukturuar nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.

3.2 Kryerja e veprave Terroriste

Mënyrat, mjetet dhe veprimet me të cilat kryhet një akt terrorist janë të shumta. Për t’u konsideruar si vepër terroriste, cilado vepër e kryer sipas nenit 135, paragrafi 1 të KPK, ajo duhet të kryhet me këto qëllime: **a)** me qëllim të frikësimit serioz të popullatës; **b)** me qëllim të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre; **c)** me qëllim që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike ose sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare. (Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2014, Botimi I, p, 391, Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani)

a) Veprat penale terroriste shkaktojnë frikë dhe pasiguri të madhe tek qytetaret në çfarëdo forme dhe me çfarëdo mjeti që kryhen. Në rastet ku si mjet i sulmit përdoren “Mjetet e Improvizuara Shpërthyesë” (MISH), kur kemi rrëmbim të aeroplanëve apo mjeteve të tjera të transportit, rrëmbim pengjesh, vrasje, etj. frika dhe pasiguria është shumë e madhe. Në vendin e ngjarjes, në sulmet terroriste shumë njerëz vdesin dhe plagosen, dhe këto pamje të

dhëna nëpër media me të vërtetë krijojnë terror të opinionit, krijojnë frikë e pasiguri. Ky edhe është njëri prej qëllimeve të grupeve terroriste, sepse ata duan me çdo kusht që qytetarët e një vendi të caktuar, të një etnie apo të një religjioni të caktuar të përjetojnë terror psikologjik, dhe që ata qytetar të mos ndjehen të sigurtë askund. Kjo frikë dhe pasiguri e qytetarëve, pastaj ka një reflektim zinxhiror në tërë aktivitetet e tyre shoqërore si puna, shkolla dhe aktivitetet tjera. Shumë aktivitete reduktohen për shkak të frikës dhe kjo frikë pastaj vështirëson jetën e qytetarëve, dhe si pasojë mund të vijnë shumë reagime, ankesa dhe pakënaqësi në drejtim të autoriteteve qeveritare, duke krijuar dhe përforcuar ndjenjën e mosbesimit ndaj forcës së autoriteteve shtetërore. (Material nga Akademia Policore në Ankara-Turqi, Trajnimi “Post Blast Investigation”, 19.09-28.09.2007) Dhe, pikërisht ky është qëllimi të cilin e kërkojnë grupet terroriste, pra që pas sulmeve terroriste, opinionit publik t’i bëjë presion qeverisë në mënyrë që qeveria në çfarëdo forme të dorëzohet para këtij presioni dhe që pastaj grupet terroriste të realizojnë qëllimet e tyre.

Qëllimi për frikësimin serioz të popullatës është edhe njëri ndër synimet kryesore të grupeve terroriste. Krijimi i ndjenjes së frikës te popullsia ndikon në zvogëlimin e aktivitetit të tyre jetësor, sepse njerëzit e frikësuar kufizojnë lëvizjet e tyre, e kjo rrjedhimisht si pasojë ka edhe humbjen e besimit të qytetarëve tek institucionet shtetërore.

Frika dhe pasiguria e shkaktuar te qytetarët me rastin e një sulmi terrorist duhet të jetë kolektive, sepse në të kundërtën do të kishim veprë penale të kanosjes ndaj një individi të caktuar. Kjo frikë ka të bëjë me rrezikun ndaj jetës, shëndetit, pasurisë, lirive dhe të drejtave apo edhe të ndonjë të mirë tjetër juridike, të cilat rrezikohen apo dëmtohen me rastin e një akti terrorist.

Vepra penale e terrorizmit konsiderohet se ekziston, është përfunduar, nëse me kryerjen e njëres apo disa nga veprat e cekura në dispozitat e sipërpërmendura është shkaktuar pasoja, është shkaktuar ndjenja e frikës, pasigurisë. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p. 65)

b) Qëllimi i dytë i cili dëshirohet të arrihet me rastin e kryerjes së një sulmi terrorist, i paraparë në Kodin tonë penal është “detyrimi i padrejtë i një organi publik, qeverisë ose organizatës ndërkombëtare për të kryer ose mos kryer ndonjë veprim”. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 135, paragrafi 1)

Për t’u konsideruar se është kryer vepra penale e terrorizmit duhet që njëra nga veprat sipas paragrafit 1 të nenit 135 të KPK të kryhet me qëllim të detyrimit të institucioneve

shtetërore apo atyre ndërkombëtare,të veprojnë ose mos veprojnë ashtu siç kërkohet nga terroristët e me këto veprime ata synojnë t'i realizojnë qëllimet e tyre politike, ideologjike, nacionaliste, fetare a të tjera.

Shpeshherë ndodh që grupet terroriste kërcënojnë autoritetet shtetërore se do të kryejnë sulme terroriste apo edhe i kryejnë ato sulme,duke kërkuar prej tyre të përmbushin ndonjë kusht,duke vepruar apo mos vepruar për ndonjë çështje që për ta mund të jetë e rëndësishme.Kërcënime apo kërkesa të tilla mund t'u drejtohen institucioneve shtetërore, rajonale apo edhe ndërkombëtare.Në disa raste grupet terroriste kanë kryer sulme të shumta terroriste për t'i detyruar qeveritë e shteteve përkatëse që të veprojnë ashtu siç kërkohet nga ta lidhur me një çështje të caktuar.Rast tipik është sulmi në stacionin hekurudhor në Madrid-Spanjë,ku më datë 11 mars 2004 pas shumë kërcënimeve të përcjellura me kërkesën për tërheqjen e ushtrisë spanjolle nga Afganistani,militantët e Al-Qaeda-s kryen një seri prej 10 sulmeve,duke vrarë 191 persona dhe duke plagosur 1800 të tjerë.Në ditët në vazhdim, Kryeministri spanjoll Aznar urdhëroi tërheqjen e trupave nga Afganistani.Ky është një shembull tipik se si grupet terroriste përmes sulmeve terroriste arrijnë qëllimet e tyre.Një shembull tjetër ku përmes akteve terroriste qeveritë e shteteve të ndryshme detyrohen të veprojnë lidhur me një çështje,është edhe rasti i sulmeve të koordinuara në Bejrut të Libanit, ku në të njëjtën kohë në vitin 1982 u sulmua Baza e Marinsave Amerikan dhe Baza e Ushtrisë Franceze,dhe si rezultat i këtyre sulmeve këto shtete tërhoqën forcat e tyre nga misioni paqeruajtës në Liban.(John Gearson, "The nature of Modern Terrorism", E# 2737, p, 8, "European Centre For Security Studies", "George C. Marshall",Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Kërkesa të tilla drejtuar autoriteteve shtetërore apo atyre ndërkombëtare ndodhin me rastin e vendosjes së bombave në pika të frekuentuara nga qytetarët,(stacione autobusësh apo trenash,qendra tregtare,aeroporte,objekte sportive,objekte të infrastrukturës vitale etj), përmes rrëmbimit të pengjeve, apo edhe përmes rrëmbimit të aeroplanëve ku nga autoritetet mund të kërkohet tërheqja e forcave ushtarake nga ndonjë vend i caktuar,lirimi i të burgosurve të organizatës,kërkesa lidhur me procesin negociator,kërkesa të natyrës financiare, vendimmarrje politike lidhur me ndonjë çështje të caktuar si autonomi për ndonjë rajon, njohje dhe mbrojtje ndërkombëtare të të drejtave të qytetareve në një rajon të caktuar, etj. Sulmet terroriste apo kërcënimet për sulme terroriste mund të kryhen në një shtet,ndërsa kërkesa mund t'i drejtohet shtetit apo organizatës tjetër.

Në këtë paragraf, përveç institucioneve vendore të Republikës së Kosovës, janë të mbrojtura edhe institucionet e një shteti tjetër (ambasadat, konsullatat, etj) si dhe institucionet

ndërkombëtare të cilat në Kosovë janë të angazhuara që nga përfundimi i Luftës në vitin 1999, të tilla si NATO, OSCE, UNMIK, BE, KE.

Duhet theksuar se sulmet terroriste mund të orientohen edhe ndaj institucioneve ndërkombëtare apo institucioneve tjera të vendosura në Kosovë. Fare lehtë mund të ndodh që të sulmohen forcat e KFOR-it dhe pastaj të kërkohet nga NATO që t'i tërheq forcat e saj nga Kosova, e ngjashëm mund të ndodh edhe OSBE-në edhe institucionet tjera ndërkombëtare. Poashtu, vlen të ceket se mund të ndodhin edhe sulme ndaj ambasadave të shteteve të ndryshme të akderituara në Kosovë, ndërsa si kërkesë të paraqitet veprimi ose mosveprimi i caktuar në një shtet të tretë. Në të dy këto raste përmbushen elementet e veprës penale terroriste.

c. Qëllimi i tretë të cilin synojnë ta arrijnë grupet terroriste që njëherit në KPK përbën edhe kushtin e tretë që një vepër të konsiderohet si vepër terroriste është qëllimi "që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare". (Kodi Penal i Kosovës, Neni 135, paragrafi 1) Sulmet e fuqishme terroriste mund të ndikojnë që disa institucione shtetërore, për një periudhë të shkurtër apo të gjatë kohore, të jenë jofunksionale apo të shkatërrohen në tërësi. Gjithashtu, ndodh që në një pjesë të caktuar të territorit të një shteti, disa apo të gjitha institucionet shtetërore të jenë jofunksionale, si rezultat i sulmeve terroriste. Në raste të tilla organet e administratës, gjyqësisë, policisë apo edhe të ushtrisë së një shteti nuk ushtrojnë asnjë aktivitet apo kontroll mbi zona të caktuara të shtetit. Zona të tilla të pakontrolluara ka në shumë shtete të cilat sfidohen nga grupet terroriste, duke filluar nga Turqia, Jemeni, Iraku, Afganistani, Pakistani etj. Sulmet terroriste ndikojnë në punën e ambasadave, të cilat shpesh mbyllen për shkak të kërcënimeve. Edhe pse nuk pranohet publikisht, situatë të tillë kemi në pjesën veriore të Mitrovicës, ku autoritete kosovare që nga paslufta asnjëherë nuk kanë arritur ta shtrijnë sovranitetin e tyre për shkak të akteve kriminale që mund të quhen edhe si akte terroriste. Arritja e një qëllimi të tillë në të vërtetë do të ketë si pasojë shkatërrimin total të shtetit apo të një pjese të tij. Ngjashëm kishte ndodhur në Siri e Irak ku ISIS përmes veprimeve terroriste kishte shkatërruar strukturat shtetërore në disa rajone të këtyre dy shteteve, madje kishte arritur deri në atë pikë sa kishte krijuar strukturat e saj që siç pretendonin ishin struktura të një shteti të ri.

Te kryerja e veprës penale të terrorizmit është e mundur edhe tentativa, nëse p.sh. është vënë eksplozivi i cili nuk ka eksploduar, apo nëse nuk është aktivizuar mjeti i cili sipas dashjes së kryesit është dashur të shkaktojë zjarrin.

Tentativa e kësaj veprë penale dënohet. Gjithashtu edhe veprimet përgatitore hyjnë në zonën kriminale, ndëshkohen. Madje edhe vetëm anëtarësimi në organizatën kriminale për kryerjen e akteve terroriste dënohet.

Kryerës i veprave terroriste mund të jetë çdo person (*delicta communia*). Vepra mund të kryhet vetëm me dashje direkte dhe me motivet e cekura më sipër. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 58-60)

Në nenin 136, në paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës, ligjvënësi përveç formës së rëndomtë të kryerjes, ka paraparë edhe format e rënda të kryerjes së kësaj veprë. Në rast se sulmi rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me jo më pak se 10 (dhjetë) vjet burgim, ose në rast se sulmi rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim së paku 15 vjet ose me burgim të përjetshëm. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 136, paragrafet 2 dhe 3)

Subjekt aktiv i kryerjes së veprës penale të terrorizmit mund të jetë çdo person (*delicta comunia*). Këto vepra zakonisht kryhen në bashkëkryerje nga individ të organizuar dhe strukturuar në grupe terroriste, edhe pse në disa raste këto vepra kryhen nga individë të vetëm, të cilët në literaturën amerikane njihen si “Ujqit e Vetmuar”. Rastet e tilla janë të rralla, por nuk mund të thuhet se nuk kanë ndodhur asnjëherë. Në vitin 1995 Timoty Mc Wigh një simpatizues i grupeve djathtiste në SHBA parkoi një kamionetë të mbushur me eksploziv para ndërtesës së FBI në Oklahoma City, dhe pastaj nga shpërthimi humbën jetën 166 persona, (Associated Press. June 20, 2001, “Victims of Oklahoma City Bombings”) dhe deri në sulmet e 11 Shtatorit 2001 në New York dhe Uashington ky ka qenë sulmi më i madh terrorist në tokën amerikane.

Si subjekte pasive apo si viktima të veprave penale terroriste paraqiten një gamë më e gjërë e personave. Përfaqësuesit diplomatik, zyrtarët e policisë dhe të ushtrisë, personeli i sistemit të drejtësisë, biznesmenët, gazetarët që me shkrimet e tyre shfaqin kundërshti për grupet terroriste, klerikët, rivalët nga grupet tjera, qytetarët e pafajshëm (civilët) dhe grupime tjera njerëzish që mund të jenë viktima të akteve terroriste.

3.3 Ndhimja në kryerjen e terrorizmit

Neni 137 i KPK (Ndhimja në kryerjen e terrorizmit), në paragrafët 1-3, ka inkriminuar edhe rastet kur personi nuk lajmëron përgatitjen apo kryerjen e aktit terrorist, nuk lajmëron kryerësin e aktit terrorist, apo rastin kur një person pas kryerjes së aktit terrorist e ndihmon kryerësin apo kryerësit t’i shmangen arrestimit nga organet e rendit, apo pas kryerjes ndihmon kryerësit duke iu siguruar fonde apo burime të tjera. Shprehjet “fonde” dhe “burime

financiare” ashtu siç janë të parapara në nenin 135, paragrafët 2 dhe 3 janë sqaruar më lartë. Edhe pse ndihma dhe llojet e saj janë përcaktuar në nenin 33 të KPK, në këtë nen edhe veprimet dhe mosveprimet e lartcekura konsiderohen si ndihmë në kryerjen e veprës penale të terrorizmit.

Ndihma është ndërmarrje e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryej vepër penale. Veprimet e ndihmës janë jashtë veprimit të kryerjes ku ndihmësi vetëm e ndihmon kryerësin të kryej vepër, ndërsa vetë nuk merr pjesë, e ato veprime të ndihmës duhet të paraqesin kontribut në realizimin e veprës penale. (Dr Ismet Salihu, “ E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë 2012, p, 397) Ndihma si formë e bashkëpunimit kriminal mund të ofrohet si ndihmë fizike dhe psikike dhe në çdo rast, për çdo vepër penale, ndihma është e ndëshkueshme.

Ndihma fizike dhe psikike për kryerjen e një akti terrorist mund të ofrohet duke i vënë në dispozicion kryerësit armë apo mjete të tjera që shërbejnë për kryerjen e veprës, duke i mënjeluar pengesat, transportimi i personit deri në vendin ku kryen aktin dhe pastaj ndihma që ai të largohet. Ndihmë konsiderohet dhënia e këshillave si kryhet vepra, si përdoren armët dhe mjetet e caktuara, si të fshihen dhe eliminohen provat që e lidhin kryerësin me ngjarjen, ofrimi i planit të detajuar si të kryhet vepra, apo ndërmarrja e veprimeve me të cilat forcohet vullneti i kryerësit të kryej veprën.

Në çdo rast kur gjykata trajton dhënien e ndihmës kryerësit të veprës terroriste, ajo duhet patjetër që përveç ndihmës së dhënë sipas nenit 137 të KPK, të vërtetojë edhe faktet lidhur me ndihmën e dhënë sipas nenit 33 të KPK.

Të gjitha këto tri forma të cekura në nenin 137 të KPK, kryhen vetëm me dashje. Dënimet me burgim për formën e parë të kësaj ndihme janë paraparë 6 muaj deri në 5 vjet, për formën e dytë , prej 3 deri në 10 vjet dhe ,për formën e tretë prej 3 deri në 10 vjet. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 67)

3.4 Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit

Është vepër penale mjaft specifike e cila përfshin disa situata mjaft të veçanta të cilat edhe pse të ngjashme me ndihmën nga neni 137 KPK, kanë disa dallime esenciale. Ky dallim konsiston në faktin se veprimet e lehtësimit me qëllim të kryerjes së terrorizmit, në krahasim me ndihmën, përveç që janë më specifike, janë edhe në distancë më të largët me ndihmën dhe janë veprime më të buta dhe më të sofistikuar. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 67)

Në këtë nen vërehen shumë elemente të financimit të terrorizmit, fenomen të cilin shumë shtete në Kodet e tyre penale e kanë paraparë si veprë të veçantë penale. Njëjtë ka vepruar Shqipëria, e cila në Kodin e saj Penal në nenin 230/a-d ka paraparë shumë veprime të cilat konsiderohen se i shërbejnë financimit të terrorizmit.

Forma e parë e kryerjes së kësaj veprë konsiderohet se kryhet kur “kushdo që në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijëni apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdoren tërësisht ose pjesërisht për apo nga grupi terrorist, apo për kryerjen e veprës terroriste”. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 138, paragrafi 1)

Kryerës të kësaj veprë sipas këtij neni konsiderohet edhe personi që ofron fonde apo të mira materiale, por edhe ai që kërkon, mbledh apo fsheh fondet apo të mirat materiale me qëllim të kryerjes së aktit terrorist. Kjo formë kryhet me dashje direkte, por në rast se personi vetëm e di, apo ka bazë të arsyeshme se fondet apo mjetet materiale mund të përdoren për kryerjen e akteve terroriste, atëherë kjo veprë mund të kryhet edhe me dashje eventuale (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p.68) Dënimi me burgim për këtë veprë është paraparë prej 5 deri 15 vjet.

Forma e dytë e kësaj veprë (paragrafi 2), është një lloj i veçantë i dhënies së ndihmës kryerësit të veprës penale pas kryerjes së veprës, dhe dallimi nga forma e parë konsiston në faktin se këtu nuk i jepet ndihmë kryerësit me qëllim të fshehjes së tij organeve të drejtësisë, por vetëm i sigurohen fonde apo mjete të tjera materiale që ai të ekzistojë edhe pas kryerjes së veprave terroriste.

Kjo formë e dytë e lehtësimit mund të kryhet vetëm me dashje direkte dhe dënimi i paraparë është nga 2 deri 15 vjet. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p.68)

Çështjen e financimit të terrorizmit e inkriminon edhe Ligji mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, ligj që parasheh subjektet shtetërore të cilat janë kompetente për luftimin e financimit të terrorizmit, detyrimet e autoriteteve bankare dhe bizneseve tjera që të raportojnë për të hyrat e tyre si dhe disa çështje të tjera me rëndësi të kësaj fushe. Sipas nenit 36b të këtij ligji, veprën penale të financimit të terrorizmit e kryen:

1. Kushdo, që me qëllim kryen, merr pjesë si bashkëpunëtor, siguron ose mbledh fonde apo organizon ose drejton të tjerët drejtpërdrejtë të ofrojnë ose të mbledhin fonde, apo përpjekja

për ta bërë këtë,përmes çfarëdo mjete,drejtëpërdrejt ose tërthorazi,me qëllim që ato të përdoren,ose në njohuri se ato do të përdoren në mënyrë të plotë ose pjesërisht për:

1.1. për të kryer një akt terrorist;

1.2. nga një terrorist, ose

1.3. nga një organizatë terroriste;

do të konsiderohet të ketë kryer aktin e financimit të terrorizmit.

2. Vepra penale është kryer pavarësisht se a ka ndodhur një akt terrorist i përmendur në paragrafin 1. ose nëse fondet janë përdorur, në fakt për të kryer një akt të tillë.

3. Financimi i terrorizmit do të jetë i dënueshëm me një gjobë deri pesëqind mijë (500,000) euro ose me burgim shtatë (7) deri njëzetë (20) vite, apo ndonjëra nga këto dënime.

4. Tentativa për të kryer veprën penale të financimit të terrorizmit apo ndihmesa, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi në kryerjen e ndonjë vepre të tillë, do të dënohet sikur vepra të kishte përfunduar.(Ligji mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Neni 36 B,Ligji Nr. 04/L-178)

Dallimi kryesor, madje kontradiktor, mes nenit 138 të KPK dhe nenit 36B të Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (LPPPFT), është lartësia e dënimit, sepse sipas KPK kryerësi i kësaj vepre dënohet nga 5 deri në 15 vite burgim, ndërsa ligji mbi financimin e terrorizmit parasheh dënim prej 7 deri në 20 vjet. Këtu kemi një situatë ku vihen në kundërtënie disa parime bazë të së drejtës, por konsiderojmë se duke marrë parasysh parimin “lex specialis derogat leg generali” me rastin e kryerjes së veprës penale të financimit të terrorizmit duhet të zbatohet dispozita e LPPPFT të Kosovës.

Lidhur me financimin e terrorizmit dhe detyrimin ndërkombëtar të shteteve që të bashkëpunojnë mes tyre është miratuar Rezoluta e OKB me numër 1373 e datës 28 shtator 2001. Sipas kësaj rezolute të miratuar vetëm disa ditë pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001, shtetet janë të obliguara të parandalojnë financimin e terrorizmit; të kriminalizojnë (parashohin si veprë penale) mbledhjen e fondeve për qëllime të terrorizmit; të ngrijnë asetet financiare të çdokujt që merr pjesë ose lehtëson terrorizmin dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm në parandalimin e shtetasve të vet, ose personave tjerë të krijojnë ose mbledhin fonde, mjete financiare apo çfarëdo ndihme tjetër direkte apo indirekte që mund të përdoret për kryerjen e akteve terroriste (Rezoluta e KS OKB 1373, neni 1 paragrafët a,b,c,d.)

Financimi i terrorizmit ngelet njëra ndër çështjet më të ndërlikuara dhe më sfiduese për qeveritë e shteteve të cilat ballafaqohen me terrorizmin. Ndërpreja e financimit të grupeve terroriste gjithmonë mbetet synim i organeve shtetërore sepse ndërpreja e fondeve nënkupton edhe zvoglimin apo edhe ndërprerjen e aktiviteteve terroriste. Edhe pse duhet theksuar se vet akti i kryerjes së një sulmi terrorist nuk kërkon shpenzime të mëdha dhe me fare pak mjete financiare mund të kryhet sulmi terrorist.

Organizatrat terroriste mjetet e tyre financiare i sigurojnë nga burime të ndryshme duke filluar nga sponzorizimi shtetëror deri tek vjedhjet e vogla, nga kontrabanda ndërkombëtare e drogave, deri tek zhvataja e bizneseve lokale, nga donacionet e bamirëse të dhëna nga diasporat e shpërndara e deri tek përdorimi i pasurive private të individëve të pasur që financojnë organizatat të këtilla. (MA. Shkelzen Marevci, "Luftimi i Terrorizmit Bashkekohor", Botimi Prishtinë, faqe 62)

3.4 Rekrutimi për terrorizëm

Grupet terroriste çështjes së rekrutimit të anëtareve të rinjë i kushtojnë rëndësi të madhe, sepse nga procesi i rekrutimit varet edhe e ardhmja e vet grupit. Rekrutimi, thirrja për rekrutim, zakonisht bëhet përmes mjeteve të informimit, por edhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta. Format e rekrutimit janë të shumta, por një ndër format më efikase dhe e shfrytëzuar gjerësisht, njihet rekrutimi përmes realizimit të sulmeve terroriste ku simpatizantët binden për fuqinë e grupit dhe kur organet shtetërore ndërmarrin veprime me përdorim brutal të forcës. Zakonisht personat e caktuar rekrutohen nëpër lagje të varëfra, shkolla, burgje, komunitete fetare apo kulturore. Rekrutuesit zakonisht shënjestrojnë persona të cilët kanë shkathtësi dhe njohuri të veçanta në ndonjë fushë të caktuar, si p.sh. shkathtësi në përdorimin e armëve, njohuri në ndërtimin e mjeteve shpërthyes, në përdorimin e mjeteve elektronike, njohuri në fushën e financave, kimisë, teknologjisë apo fushave tjera që u hynë në punë. Me person të rekrutuar nënkuptohet ai person i cili ka shkuar përtej pranimin të mesazheve terroriste, i cili është indoktrinuar nga këto mesazhe dhe është bërë anëtar i organizatës duke marrë vlerësimin paraprak nga rekrutuesi se ai është i pjekur dhe i gatshëm për t'iu bashkuar grupit terrorist. (National Security Research Division, "Al-Qaeda- Terrorist Selection and Recruitment", p.16)

Kodi Penal i Kosovës në nenin 139 ka paraparë si vepër penale të dënueshme nga 5 deri 15 vjet rekrutimin për terrorizëm. Rekrutimi për të kryer akte terroriste është një lloj veprimi specifik në spektrin e të gjitha llojeve të veprave penale terroriste. Termi rekrutim në sensin e këtij inkriminimi, i paraparë në dispozitën e cekur më lartë, nënkupton këto veprime:

a) thirrjen apo inkurajimin e personit tjetër që të bëhet anëtar,të anëtarësohet në grupin terrorist;b) kur thirret ndokush që të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste;c) kur thirret që të marrë pjesë në aktivitetet e grupit terrorist;ç) kur thirret të sigurojë fonde ose burime materiale,të cilat do të përdoren për kryerjen e veprave terroriste apo aktiviteteve të tjera terroriste.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 68)

Kryerës i kësaj vepre mund të jetë çdo person i cili u bën thirrje personave të tjerë të marrin pjesë në aktivitetet terroriste,në mbledhjen dhe grumbullimin e fondeve ose të mirave materiale.Kjo vepër kryhet vetëm me dashje direkte.

3.5 Trajnimi për terrorizëm

Pas rekrutimit të suksesshëm të anëtarëve të rinjë është e domosdoshme që ata të trajnohen në fusha të përgjithshme apo edhe specifike,lidhur me përdorimin e armëve, ndërtimin dhe vendosjen e mjeteve të improvizuara shpërthyes,teknika të dyluftimit, drejtimin e mjeteve të ndryshme, etj.Varësisht nga operacioni i planifikuar,trajnesit përzgjedhin kandidatët më të përgatitur fizikisht,profesionalisht dhe moralisht dhe vetëm pas përfundimit të trajnimit caktohen kandidatët më të përgatitur për të realizuar sulmin.Një praktikë të tillë kishte ndjekur grupi terrorist pakistanez ”Lashkar I Taiba”ku 32 kandidat të përzgjedhur ishin trajnuar 18 deri 24 muaj në përdorimin e armëve dhe eksplozivëve dhe në fund vetëm 10 prej tyre ishin dërguar në Mumbai të Indisë, ku nga data 26 nëntor deri 29 nëntor 2008 kishin sulmuar disa caqe të përzgjedhura, duke vrarë 166 njerëz, nga ta 150 civilë dhe 16zyrtarëtë forcave të sigurisë.(Colonel Behram A.Sahukar, “The Mumbai Attack, Analysis and Impact”, Program On Terrorism and Security Studies, (PTSS 10/3), “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani)

Kodi Penal i Kosovës, në nenin 140 ka paraparë si vepër të veçantë trajnimin për terrorizëm.Sipas paragrafit 1 të këtij neni, kjo vepër penale kryhet në formën e të ashtuquajturit bashkëpunim të domosdoshëm, ngase për kryerjen e saj duhet të marrin pjesë së paku dy persona dhe atë trajnesi në një rën anë dhe personi i cili trajnohet, i merr mësimet-udhëzimet nga personi tjetër.Pra, këtë vepër penale e kryen personi i cili e trajnon, e aftëson tjetrin për të kryer akte terroriste si dhe personi i cili i merr,i pranon, përkatësisht i cili aftësohet për të kryer akte terroriste.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 69)

Për qëllime të këtij neni, shprehja “trajnim për terrorizëm” nënkupton trajnimin ose udhëzimin për prodhimin ose përdorimin e mjeteve shpërthyes, armëve të zjarrit ose armëve tjera, apo substancave të dëmshme apo helmuese, ose me metoda apo teknika të tjera specifike, me qëllim që të kryejë apo të kontribuojë në kryerjen e veprës terroriste, duke ditur se shkathtësitë e mësuara kanë për synim që të përdoren për këtë qëllim. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 140, paragrafi 2) Siç shihet, kryerësi do të konsiderohet përgjegjës vetëm nëse trajnuesi e ka ditur se mësimet e njohuritë e dhëna si dhe trajnimi i dhënë do të shfrytëzohen për kryerjen e ndonjë veprë terroriste.

Këtë veprë penale mund ta kryejë çdo person i cili ka njohuri për t’i aftësuar të tjerët për kryerjen e akteve terroriste dhe kryhet me dashje direkte, por mund të kryhet edhe me dashje eventuale. Dënimi për këtë veprë është paraparë nga 5 deri në 15 vite burgim. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p. 69-70)

3.6 Shtytja për kryerjen e veprave terroriste

Kjo veprë penale kryhet kur ndokush në mënyrë publike, ose me anë të mjeteve të informimit publik thërret ose dërgon mesazhe me qëllim që të shtytë persona të pacaktuar që të kryejnë vepra terroriste. Ftesa, mesazhi apo rekomandimi për të kryer akte terroriste mund të jetë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Me rëndësi është që thirrja apo mesazhi të jenë publik dhe me aso përmbajtje, aso natyre dhe performance, të cilat shkaktojnë rrezik ndaj një apo më shumë personave; të ekzistojë qëllimi që të ushtrojnë ndikim për të kryer një apo më shumë vepra terroriste. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p. 70). Thirrje të tilla publike për t’i shtytur personat e pacaktuar që të ndërmarrin veprime terroriste, përveç mjeteve të informimit bëhen edhe në objekte të kultit, shoqata të ndryshme të kamufluara si shoqata të karakterit kulturor, gjatë revoltave apo trazirave të qytetarëve, etj. Persona të caktuar brenda organizatave terroriste, klerikë me ndikim, apo udhëheqës të grupeve iu drejtohen masave të caktuara duke iu bërë thirrje të kryejnë akte terroriste.

Kjo lloj shtytje dallon nga shtytja si formë e bashkëpunimit kriminal, sepse i drejtohet personave të pacaktuar, pra bëhet thirrje publike, e përmes kësaj thirrjeje synohet që ndonjë person, cilido qoftë ai, të kryejë një apo shumë vepra terroriste.

Kjo veprë, siç është paraparë në nenin 141 të KPK, konsiderohet e kryer me vet faktin e ndërmarrjes së veprimit me qëllim që të ndikohet tek personi tjetër apo personat e tjerë të kryejnë akte terroriste. Pra, për ekzistimin e kësaj veprë nuk është e domosdoshme që edhe të jetë kryer një apo më shumë vepra terroriste. Këtë veprë mund ta kryejë çdo person dhe kryhet

me dashje direkte,por mund të kryhet edhe me dashje eventuale dhe dënimi i paraparë është prej 1 deri 5 vite burgim.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 69)

3.7 Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste

Në nenin 142, paragrafi 1 i KPK është paraparë si vepër e posaçme penale rasti kur ndokush ka informacion apo njohuri se është themeluar grupi terrorist dhe se atë grup apo ndonjërin nga anëtarët e tij i *fsheh*,apo në çfarëdo forme pengon organet e rendit që gjatë hetimit të tyre të *zbulojë dhe arrestojë* ata.Si veprime të kryerjes së veprës nga paragrafi 1 të këtij neni konsiderohen rastet kur ndokush:**a)** fsheh ekzistimin e grupit terrorist ose anëtarët e tij;**b)** kur e pengon zbulimin e grupit të tillë;**ose c)**kur pengon arrestimin e grupit apo anëtarëve të tij.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p,71)

Paragrafi 2 i nenit 142 të KPK inkriminon rastet kur ndonjë person *fsheh apo nuk e lajmëron përgatitjen e veprës penale*; nëse përgatitja është bërë me qëllim të kryerjes së veprës së terrorizmit.Moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale është paraparë në nenin 385 të KPK,por ky nen(142) ka të bëjë vetëm me moslajmërimin e përgatitjes së veprave të terrorizmit.Në këtë paragraf po ashtu parashihet si vepër e veçantë edhe moslajmërimi i kryerësit të veprave penale terroriste,sipas nenit 386 e si rezultat i moslajmërimit vepra terroriste është kryer apo ka pasur tentativë për kryerjen e saj.

Në paragrafin 3 të nenit 142 të KPK-së,është paraparë si formë e posaçme sanksionimi i fshehjes,moslajmërimit,pengimit të zbulimit apo arrestimit të kryerësve të veprës penale terroriste apo dhënies ndihmë pas kryerjes së veprës penale të terrorizmit sipas nenit 388 të këtij Kodi.Ndihma e dhënë pas kryerjes së veprës penale terroriste përfshin strehimin e kryesit apo personit të dënuar me parë nga drejtësia për vepër të tillë,fshehjen e provave që e lidhin kryerësin me veprën penale, etj.

Këtë lloj të veprës penale në të tri format mund ta kryejë çdo person dhe kryhet vetëm me dashje.Dënimet për formën e parë të kësaj vepre janë paraparë nga 3 deri në 10 vjet,për formën e dytë prej 6 muaj deri në 5 vjet dhe për formën e tretë është paraparë dënimi prej 3 deri në 10 vite burgim.(Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 71)

3.8 Organizimi dhe pjesëmarrja në grupin terrorist.

Shumica e veprave penale terroriste kryhen në bashkëpunim mes dy e më tepër individëve, të cilët përbëjnë një grup të caktuar terrorist. Rrezikshmëria e veprave terroriste të

kryera nga grupi është shumë më e madhe se kur ato kryhen nga një individ i vetëm, sepse veprat e kryera nga grupi planifikohen më mirë, marrin pjesë më shumë persona me aftësi specifike në fusha të caktuara, e udhëzime dhe role të ndara gjatë realizimit të aktit. Ka raste kur një person i vetëm mund të kryejë një akt terrorist me pasoja shumë të mëdha. Shembulli më i mirë është rasti i sulmit në Oslo të Norvegjisë më 22 korrik 2011. (**Andres Bering Breivik** një person me pikëpamje dhe ide të ekstremit të djathta, me një islamofobi të shprehur haptas, kreu sulmin më të rëndë terrorist në historinë e Norvegjisë)

Duke parë rrezikshmërinë e madhe që paraqesin veprat terroriste të kryera në bashkëpunim (në grup), KPK ka paraparë mundësinë e inkriminimit si vepër penale edhe të veprimeve përgatitore qysh në fazën e krijimit të grupit terrorist, pavarësisht se vepra terroriste ende nuk është kryer.

Neni 143 i KPK në paragrafin 1 ka paraparë si vepër penale të veçantë organizimin, drejtimin apo udhëheqjen e një grupi terrorist duke paraparë dënim me gjobë deri në 500.000 euro dhe dënim me burgim prej 10 deri në 20 vjet. Ky paragraf ka të bëjë vetëm me udhëheqësit e grupeve terroriste dhe është e vetmja vepër penale e kësaj natyre, e cila përveç dënimit me burgim sanksionohet edhe me dënim me gjobë.

Përkufizimi i grupit terrorist është dhënë në nenin 135 paragrafi 2 të këtij kodi, ndërsa me *organizimin* e një grupi terrorist duhet nënkuptuar këto veprime: gjetjen e personave të cilët anëtarësohen në grupin terrorist, marrjen e pëlqimit të tyre, strukturimi i tyre, përgatitja e planit, planifikimi i sulmeve terroriste dhe sigurimi i ndihmës. Shprehja drejton një grup terrorist, nënkupton rastin kur personi i cili vihet në krye të organizatës terroriste, i cili drejton, përkatësisht e udhëheq veprimtarinë e saj. Në vazhden e aktiviteteve kriminale, udhëheqësi i cakton personat konkret të cilët do të kryejnë veprimet e caktuara.

Rëndësia e arrestimit dhe dënimit të udhëheqësve të grupeve terroriste shihet qartë edhe në Kodin Penal të Kosovës, sepse arrestimi i tyre apo eliminimi në ndonjë formë tjetër është synim i vazhdueshëm i organeve shtetërore të përfshira në hetimin dhe ndjekjen e këtyre veprave. Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, SHBA për 10 vite me radhë ndoqën kreun e Al-Qaedas Osama Bin Laden, duke angazhuar forca të shumta ushtarake, njësitë speciale, agjentë sekret të CIA-s dhe FBI-së apo teknologjinë e fundit satelitore. Për shumë grupe terroriste, sidomos për Al-Qaedan, lideri i saj ka përfaqësuar simbolin dhe vetë ideologjinë e organizatës, prandaj arrestimi apo vrasja e liderëve të grupeve terroriste do të ndikojë në dobësimin e organizatës apo në shuarjen e plotë. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p, 72)

Paragrafi 2 i këtij neni sanksionon pjesëmarrjen në një grup terrorist të çdo personi, dhe për t'u konsumuar kjo vepër nuk është e domosdoshme të jetë kryer ndonjë akt terrorist, pra në këtë paragraf sanksionohet pjesëmarrja në grupin terrorist, e nëse personi si anëtar i grupit kryen p.sh. vrasje për qëllime të terrorizmit, ai nuk do të akuzohet se ka kryer dy vepra, por vetëm një vepër, edhe atë veprën penale të vrasjes e cila e konsumon veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist. (Dr. Ismet Salihu, "E drejta Penale, Pjesa e Posaçme", Kolegji Fama, Prishtinë 2014, faqe 72) Personi i cili shpallet fajtor për pjesëmarrje në grup terrorist dënohet nga 5 deri në 10 vjet burgim.

Edhe udhëheqjen apo drejtimin e grupit terrorist, edhe pjesëmarrjen në grupin terrorist mund t'i kryej çdo person, dhe këto vepra kryhen vetëm me dashje.

Kjo vepër penale, organizimi dhe pjesëmarrja në grupet terroriste, kohëve të fundit po kryhet gjithnjë e më shumë nga shtetas kosovarë, të cilët po marrin pjesë në luftën në Siri, ku shumë prej tyre janë rreshtuar në radhët e grupeve që kanë lidhje të drejtpërdrejta me Al-Qaeda, siç është Al-Nusra. Rreth 150 shtetas të Kosovës po marrin pjesë në luftimet në Siri, e nëse llogarisim numrin e shqiptarëve nga Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora, numri i tyre arrin deri në 450. Deri më tani si pasojë e luftimeve mes grupeve të ndryshme dhe në luftimet kundër forcave qeveritare janë vrarë 8 shtetas shtetas shqiptarë, 21 shtetas kosovarë, 10 shtetas maqedonas të nacionalitetit shqiptarë, dhe 1 shqiptar tjetër nga Lugina e Preshevës. (<http://www.gazetatema.net/web/2014/09/14/ne-siri-dhe-irak-deri-tani-40-shqiptare-te-vrare>, 19.09.2014, 13:40h)

3.9 Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës

Sipas nenit 144 të KPK-së, veprimet përgatitore për kryerjen e veprës penale terroriste janë paraparë si vepër penale, ashtu siç e parashikon edhe neni 27, paragrafi 1 i këtij Kodi (përgatitja e veprës penale). Për shkak të rrezikshmërisë së madhe që paraqesin veprat terroriste edhe veprimet përgatitore janë inkriminuar si vepër penale, më konkretisht çdo person që përgatit kryerjen e ndonjëres nga veprat e parapara në nenet 135-142 të KPK-së, konsiderohet fajtor edhe pse vetë vepra mund të mos jetë kryer.

Në paragrafin 2 të këtij neni, si “përgatitje e veprës penale” përfshihet furnizimi apo aftësimi me mjete funksionale kryerësve të veprës penale, eliminimi e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshjen, planifikimin apo organizimin me personat e tjerë për kryerjen e veprës penale, si dhe çfarëdo veprimi tjetër, që krijojnë kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë vetë veprën penale. (Kodi Penal i Kosovës, Neni 143, paragrafi 3)

Në paragrafin 3 janë paraparë këto lloje të veprimeve përgatitore për kryerjen e veprave terroriste dhe veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës; dërgimi në Kosovë apo jashtë Kosovës i armëve, eksplozivit, helmeve, pajisjeve, municionit apo material tjetër për kryerjen e një apo shumë veprave penale të këtij Kapitulli.

Në paragrafin 4 janë paraparë veprime përgatitore specifike për veprat penale të këtij Kapitulli. Në sensin e këtij paragrafi, këto veprime përgatitore konsiderohen se kryhen në rastet kur ndokush, me qëllim të kryerjes së veprave penale kundër rendit kushtetues të Kosovës dhe sigurisë së saj, dërgon apo bart grupe të armatosura, pajisje ose burime tjera materiale në Kosovës apo jashtë saj. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, p,74)

Forma e parë e kryerjes së kësaj veprë, sipas paragrafit 1 dënohet nga 1 deri në 5 vjet; forma e dytë, sipas paragrafit 3 dënohet prej 5 deri 15 vjet burgim, ndërsa forma e tretë, sipas paragrafit 4 dënohet nga 10 deri në 20 vjet burgim. Të gjitha format e kësaj veprë penale mund të kryhen vetëm me dashje.

3.10 Rëndësia e përgatitjessë kryerjes së veprës terroriste

Në dispozitën e nenit 145 të KPK-së është paraparë shprehimisht se veprat penale sipas neneve 135-144, konsiderohen të kryera, të përfunduara me vetë faktin që janë ndërmarrë veprimet përgatitore. Në mënyrë specifike dhe shprehimisht në këtë nen është përcaktuar se për këto vepra penale, personat do të ndëshkohen edhe për veprimet përgatitore, sikur të kishin kryer veprën penale, sikur të kishin përfunduar veprën. (Dr. Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Kolegji Fama, Prishtinë 2014, faqe 74) Edhe pse nuk është realizuar sulmi terrorist, siç mund ta kenë planifikuar kryerësit e një akti të tillë, çdo veprim përgatitor për kryerjen e sulmit nënkupton përgjegjësi penale për personat e përfshirë në ato veprime përgatitore.

Sipas nenit 27 të KPK-së përgatitja e veprës penale përfshinë furnizimin ose aftësimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale; mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale;

marrëveshjen, planifikimin ose organizimin me personin tjetër për kryerjen e veprës penale si dhe veprimet tjera me të cilat krijohen kushtet për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk përbëjnë veprimin e kryerjes. (Kodi Penal Kosovës, Neni 27, paragrafi 2)

3.11 Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare

Perveç veprave penale të parapara në Kapitullin -Vepra të terrorizmit, lidhur me këtë çështje edhe veprat penale lidhur me kalimin ilegal të kufirit apo veprat që kryhen në zonat kufitare, kanë një ndërlidhje me veprat e terrorizmit. Në Kodin Penal të Kosovës si vepër e posaqme është paraparë edhe Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare.

1. Sipas nenit 146 të KPK-s kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend, përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare, dënohet me dyqind e pesëdhjetë (250) euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili është i shoqëruar nga një fëmijë ose ndonjë person tjetër, kryerësi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet nëse: 3.1. kryesi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen; 3.2. gjatë kohës së kapjes, kryesi ik, përpiqet të ik ose në ndonjë mënyrë tjetër i reziston kapjes nga policia ose KFOR-i; 3.3. kalimi është bërë ndërmjet orës tetë (8:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës gjashtë (6:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes, gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars; ose 3.4. kryerësi posedon armë, municion ose rroba ushtarake, furnizime apo pajisje

4. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni është e dënueshme.

5. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni për kalimin në një pikë kufitare të paautorizuar të kufirit shtetëror, nëse kalimi ka ndodhur në një vendkalim i cili është hapur përkohësisht nga Komandanti i KFOR-it.

6. Kurrfarë procedure penale që përfshin veprën nga ky nen nuk mund të fillohet apo të vazhdohet kundër asnjë refugjati në mirëbesim ose kundër personit të zhvendosur brenda vendit, që vjen nga territori ku jeta apo trupi i tij, ose liritë apo të drejtat themelore janë të rrezikuara, me kusht që ai t'i jetë paraqitur policisë apo KFOR-it brenda një kohe të arsyeshme dhe të tregojë arsye bindëse për kalimin e vendkalimit apo pikës kufitare të paautorizuar. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 146, paragrafët 1-5)

Veprat e kësaj natyre janë të rëndësishme edhe për fushën e terrorizmit sepse grupet terroriste i shfrytëzojnë kontrollet më të dobëta të kufijve për të kaluar në mënyrë ilegale, si personat e poashtu edhe mjetet dhe paisjet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për propagandë, trajnime apo edhe për vet kryerjen e veprave penale terroriste. Procesi i globalizimit ka sjellë në këtë epokë dhe rrjedhimisht kemi një hapje të kufijve mes shteteve, madje edhe koncepti i ruajtjes së kufijve ka ndryshuar. Këto mundësi të kalimit të kufirit në mënyrë më të lehtë, sigurisht që janë një favor për grupet terroriste.

3.12 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik

Kjo vepër penale ashtu siç është paraparë edhe KPK është mjaft e përhapur dhe zakonisht konsumohet sidomos në fazat e radikalizmit të të rinjëve për t'i drejtuar pastaj drejt veprimeve terroriste. Me këtë vepër penale është paraparë që personat që në çfarëdo forme nxisin urrejtje dhe mos durim fetar, etnik, gjinor etj, do të ndëshkohen sipas kësaj dispozite.

Është interesant të theksohet se me këtë vepër penale janë akuzuar dhe madje në disa raste edhe janë dënuar zakonisht imamët e xhamive nëpër Kosovë, sepse përmes ligjëratave të tyre ata shpreh herë kanë rënë ndesh me këtë dispozitë ligjore, duke fyer kombësitë dhe religjionet tjera dhe pastaj duke bërë thirrje direkte ose indirekte për pjesëmarrje në luftra të të rinjëve Kosovar në Siri dhe Irak.

Sipas nenit 147 të Kodit Penal të Kosovës 1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. (Neni 147 i KPK-s, paragrafët 1-4)

Sipas kësaj dispozite parashihen dënime shumë të larta për personat që mund të kryejnë këtë vepër e një mundësi të tillë kanë të gjithë personat. Tutje kjo dispozitë e konsideron si

formë të rëndë të kësaj vepre,nëseajo është kryer dhe si pasojë janë shkaktuar trazira publike apo çfarëdo forme tjetër e dhunës.Formë më e rëndë e kësaj vepre është situata kur kjo vepër kryhet nga personat zyrtar.(Komentari i Kodit Penal të Kosovës, Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Faqe 403, Botimi I, Prishtinë, 2014)

KAPITULLI IV:

4. Aspekti krahasues i legjislacioneve penale të Kosovës me atë të Maqedonisë

4.1 Rregullimi i veprave penale lidhur me ekstremizimin e dhunshëm në Kodin Penal të Maqedonisë

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë sikur se edhe kodet tjera penale të shteteve bashkëkohore ka paraparë disa veprime konkrete ,të cilat nëse ndërmerren nga një person ose disa persona,paraqesin vepër penale të natyrës së terrorizmit.Përfshirja e këtyre veprave në Kodin penal është një masë parandaluese sepse në një mënyrë iu bëhet e qartë të gjithë individëve dhe grupeve se ndërmarrja e këtyre veprimeve do t'i fuste në zonën e përgjegjësisë penale.

Më poshtë do t'i paraqesim veprat penale terroriste të cilat i paresheh Kodi Penal i Maqedonisëduke përfshirë format e kryerjes së këtyre veprave,cilët persona mund t'i kryejnë,format themelore dhe format e cilësuar,lartësinë dhe llojin e dënimeve, etj.

4.2 Organizata Terroriste (Neni 394-a)

(1)Ai i cili formon grup,bandë,apo organizatë tjetër kriminale për kryerjen e veprave penale të: vrasjes,lëndimit trupor,rrëmbimit të personave,shkatërrimit të objekteve publike,sistemeve transportuese,objekteve të infrastrukturës,sistemit të informimit dhe objekteve tjera për përdorim të përgjithshëm,rrëmbimit të aeroplanëve apo mjeteve tjera për transport publik,prodhimit,posedimit apo tregtisë me armë nukleare,armëve biologjike,kimike dhe llojeve tjera të armëve dhe materieve të rrezikshme,lëshimit të substancave të rrezikshme apo shkaktimit të zjarrit apo eksplodimit,shkatërrimit të instalimeve për furnizime me ujë,energji apo të burimeve tjera themelore të rrezikshme,me qëllim të krijimit të ndjenjës së pasigurisë apo frikës te qytetarët apo për kërcënimin e rendit kushtetues të vendit apo interesave të organizatës ndërkombëtare apo të shtetit të huaj,do të dënohet së paku me tetë vjet burgim.

(2)Pjestari i grupit, bandës apo organizatës tjetër kriminale,si dhe ai icili siguron mjete për financimin apo i ndihmon në mënyrën tjetër,do të dënohet me burgim prej katër deri në dhjetë vjet.(Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,Shkup 2015, Botimi i Dytë,p, 324)

(3) Me dënimin nga paragrafi 2 do të dënohet edhe ai i cili publikisht thërret, nxit apo e përkrah formimin e organizatës kriminale.

(4) Kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i cili me zbulimin e organizatës apo në mënyrë tjetër do ta pengojë kryerjen e veprave të planifikuara, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet, por mundet edhe të lirohet nga dënimi.

(5) Kryerësi nga paragrafi 2 i cili do ta zbulojë organizatën para se të kryejë në përbërje të saj apo për të ndonjë nga veprat e parapara në paragrafin 1, do të lirohet nga dënimi.

(6) Paluajtshmëritë të shfrytëzuara dhe sendet dhe mjetet e destinuara për përgaditjen e veprave nga paragrafët 1, 2 dhe 3, merren (Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 394, paragrafi a)

4.3 Terrorizmi (Neni 394-b)

(1) Ai i cili do të kryejë një apo më tepër vepra të vrasjes, lëndimit trupor, rrëmbimit të personave, shkatërrimit të objekteve publike, sistemeve transportuese, objekteve të infrastrukturës, sistemeve kompjuterike dhe objekteve tjera që janë në përdorim të përgjithshëm, rrëmbim të aeroplanëve apo mjeteve tjera të transportit publik, prodhimit, posedimit, transportit, tregtisë, furnizimit apo aplikimit, me armë nukleare, biologjike, kimike dhe llojeve tjera të armëve dhe materieve të rrezikshme, si dhe hulumtime në drejtim të zhvillimit të armës biologjike dhe kimike, lëshim të substancave të rrezikshme radioaktive, helmuese dhe substancave të rrezikshme apo shkaktim të zjarrit apo eksplozimit, shkatërrim të instalimeve për furnizim me ujë, energji apo burime tjera themelore natyrore, me qëllim të kërcënimit të jetës dhe trupit dhe krijimit të ndjenjës së pasigurisë apo frikës te qytetarët, do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. (Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2015, Botimi i Dytë, p. 325)

Ai i cili seriozisht do të kërcënohet me kryerje të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni, drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt, me përdorim të mjeteve elektronike apo në mënyrë tjetër, me qëllim të kërcënimit të jetës dhe trupit dhe të krijimit të ndjenjës së pasigurisë apo frikës te qytetarët, do të dënohet me së paku tetë vjet burgim.

Ai i cili publikisht thërret, me përhapje apo vënie në çfarëdo qoftë mënyrë tjetër e bën të arritshme për publikun porosinë, me qëllim për nxitje në kryerje të ndonjëres nga veprimet e parapara me paragrafin (1) të këtij neni, kur vetë thirrja krijon rrezik për t'u kryer veprimi i tillë, do të dënohet me burgim prej katër deri në dhjetë vjet.

Me dënimin nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet edhe ai që do të detyrojë në kryerje të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni me forcë apo kërcënim serioz se do ta sulmojë jetën apo trupin e tij apo jetën dhe trupin e ndonjë të afërmi të tij.

Me dënimin nga paragrafi 2 do të dënohet edhe ai i cili do të merret vesh me person tjetër për kryerje të veprës nga paragrafi 1, ose do të thërret tjetërkënd që t'i bashkangjitet shoqatës apo grupit me qëllim të kryerjes së veprës nga paragrafi 1.

Ai i cili organizon përpunim, përgatit, përpunon, shet, blen, bartë apo mban eksploziv, armë zjarri apo armë tjetër apo substanca të rrezikshme, të destinuara për kryerjen e veprës nga paragrafi 1, si dhe ai i cili bën trajnim apo në mënyrë tjetër përgatit tjetërkënd për kryerjen e veprës nga paragrafi 1, do të dënohet me më së paku katër vjet burgim.

Ai i cili do të kryejë vepër të vjedhjes së rëndë që të vijë te sendet për kryerje të veprës nga paragrafi 1 të këtij neni, do të dënohet me më së paku katër vjet burgim.

Nëse veprën e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë. (Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2015, Botimi i Dyte, p, 326)

Paluajtshmëritë e shfrytëzuara dhe sendet si dhe mjetet e destinuara për përgatitjen dhe kryerjen e veprave, do të merren. (Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 394, paragrafi b)

4.4 Financimi i Terrorizmit (Neni 394-c)

(1) Ai i cili në çfarëdo qoftë mënyre, direkte apo indirekte, jep, siguron apo grumbullon para apo pasuri tjetër, me qëllim që ato të përdoren, apo duke pasur njohuri se ato do të shfrytëzohen tërësisht apo pjesërisht për të kryer veprën penale rrëmbim të fluturakës apo lundrueses (neni 302), kërcënim i sigurisë së komunikacionin ajror (neni 303), kërcënim terrorist të rendit kushtetues dhe të sigurisë (neni 313), organizata terroriste (394-a), terrorizëm (neni 394-b), krimet kundër njerëzimit (neni 403-a), terrorizmi ndërkombëtar (neni 419), marrja e pengjeve (neni 421), apo vepër tjetër të terrorizmit e paraparë me këtë ligj apo veprim tjetër i kryer me qëllim që të shkaktojë vdekje apo lëndim të rëndë trupor qytetarëve apo personave tjerë të cilët nuk janë të inkuadruar në konflikt, i cili ka karakter të konfliktit të armatosur, sipas të drejtës ndërkombëtare me qëllim të krijoj ndjenjë të pasigurisë apo frikës te qytetarët apo detyrohet shteti që në ndonjë organizatë ndërkombëtare të kryej apo të abstenoj nga kryerja e veprimeve të caktuara, do të dënohet me më së paku tetë vjet burgim.

(2) Ai i cili në çfarëdo qoftë mënyre drejtpërdrejt apo jodrejtpërdrejt, jep, siguron apo grumbullon para apo pasuri tjetër me qëllim që ato të shfrytëzohen për përgatitje të veprës nga paragrafi (1) të këtij neni apo në çfarëdo qoftë mënyre siguron apo grumbullon para apo

pasuri tjetër, me vetëdije me qëllim që ato të shfrytëzohen ose me dijeni se pjesërisht apo plotësisht do të shfrytëzohen nga ana e terroristit apo organizatës terroriste, do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(3) Ai i cili publikisht thërret, me përhapje apo vënie tjetër e bën të arritshme për publikun porosinë me qëllim për nxitje në kryerje të ndonjëres nga veprimet e parapara në këtë nen, kur vetë thirrja krijon rrezik për t'u kryer veprimi i tillë, do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(4) Me dënimin nga paragrafi 3 do të dënohet edhe ai i cili do të merret vesh me person tjetër për kryerje të veprës nga ky nen, ose do të thërret tjetërkënd t'i bashkangjitet shoqatës apo grupit me qëllim të kryerjes së veprës nga ky nen.

(5) Ai i cili do të krijojë grup apo bandë që ka për qëllim kryerjen e veprës penale nga ky nen, do të dënohet me më së paku dhjetë vjet burgim.

(6) Pjesëtari i grupit apo i bandës nga paragrafi (5) do të dënohet me më së paku pesë vjet burgim.

(7) Pjesëtari i grupit apo i bandës, i cili do ta zbulojë grupin, përkatësisht bandën para se të kryejë ndonjë veprë tjetër penale në përbërje të saj apo për të, do të lirohet nga dënimi.

(8) Personi zyrtar, personi përgjegjës në bankë apo në institucion tjetër financiar, apo personi i cili kryen punë me karakter publik, i cili sipas ligjit është i autorizuar të ndërmerri masa dhe veprime për pengimin e financimit të terrorizmit, që me vetëdije do të lëshojë t'i ndërmerri masat e parapara me ligj dhe dotë mundësojë kryerje të veprës penale nga ky, dotë dënohet me së paku katër vjet burgim. (Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2015, Botimi i Dytë, p. 327)

(9) Me dënimin nga paragrafi (8) të këtij neni do të dënohet personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili në mënyrë të paautorizuar do t'i zbulojë klientit apo personit të paautorizuar të dhëna që kanë të bëjnë me procedurën e ekzaminimit të transaksioneve të dyshuara apo të zbatimit të masave dhe veprimeve tjera për pengimin e financimit të terrorizmit.

(10) Ai i cili veprat nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni do t'i kryejë, edhe pse nuk ka qenë i vetëdijshëm për mundësinë e shkaktimit të pasojave të dëmshme, kurse sipas rrethanave dhe sipas vetive të veta personale ka qenë i obliguar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm për atë mundësi, do të dënohet me së paku tre vjet burgim.

(11) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë dhe me pushim të personit juridik.

(12) Paratë dhe pasuria të destinuar për përgatitjen dhe kryerjen e veprave nga ky nen, do të merren. (Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 394, paragrafi c)

4.5 Raste specifike të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni

Edhe Republika e Maqedonisë i është ekspozuar ndikimit të shtrirjes së ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm njëjtë sikur edhe pjesa tjetër e regjionit tonë. Fatkeqësisht njëjtë sikur edhe në Kosovë dhe Shqipëri, në shumicën e rasteve ekstremizmi është mbjellë dhe kultivuar tek popullata shqiptare e besimit musliman. Të rinjtë me shkollim të limituar, me vështërsi të shumta sociale kanë qenë pre e ligjëratave të imamëve të ndryshëm nëpër xhamitë dhe institucionet tjera fetare, duke mos përjashtuar edhe mediat lokale dhe rrjetet sociale. Ligjërimi i këtyre imamëve ku ligjëratat dhe literatura e shfrytëzuar nga ta ka qenë e pa kontrolluar, kanë ndikur deri në atë masë sa që individët e caktuar janë përfshirë në veprimtari kundërligjore që ka rezultuar deri me pjesëmarrjen e tyre aktive në luftrat në Lindjen e Mesme.

4.6 Qelia

Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm rrezikon pothuajse të gjitha shtetet dhe vendet e botës, dhe nuk mund të thuhet lirshëm se ndonjë shtet mund të paraqitet si imun ndaj këtij fenomeni. Rastet e ndryshme kriminale kanë ndodhur edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë ku përfshirja e qytetarëve shqiptar të besimit islam ka qenë dukshëm e theksuar. Si rast i cili është etiketuar si ekstremizëm i dhunshëm me prapavijë religjioze është rasti „Celula” i cili është zhvilluar në dy aksione, **celula1** dhe **celula 2** dhe i njëjti ka marrë epilog gjygjësor. Poashtu rast i cili ka të gjitha tiparet e terrorizmit të shtytura nga ekstremizmi i dhunshëm kryesisht ai politik është rasti i ngjarjeve të 27 prillit 2017 të ndodhura në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Rasti akoma nuk ka zgjidhje përfundimtare përkatësisht zbardhja e tij e plotësishme nuk është arritur, edhe pse janë ndërmarrë një sërë veprimesh, ku janë sjellur edhe disa vendime gjygjësore, megjithatë kualifikim adekuat të kësaj vepre dhe përgjegjësi për të gjithë të përfshirët në të akoma nuk ka.

Rasti Celula është rasti i parë i plasuar në opinion si ekstremizëm i dhunshëm në Republikën e Maqedonisë. Më 6 gusht 2015 autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm ndërmorrën aksionin Celula, me që rast u arrestuan 9 persona nën dyshimin e organizimit dhe rekrutimit të luftëtarëve për ushtritë e huaja. Ata kanë planifikuar të shkojnë në vatrat e luftës në Siri dhe t’i bashkëngjiten kësaj organizate. Tre nga të arrestuarit janë nga Kumanova, ndërsa dy nga Shkupi. Ata janë të moshës prej 18 deri 24

vjeç.“Të denoncuarit një kohë të gjatë kanë ndjekur predikimet fetare në qytetet e tyre ku ka filluar indoktrinimi dhe radikalizimi i tyre ku kanë qenë të përfshirë persona që janë arrestuar në aksionet e mëhershme në kuadër të aksionit policor “Celula”.MPB edhe në periudhën e ardhshme vazhdon me marrjen e masave të mëtejshme për sigurimin e provave edhe kundër personave tjerë që janë të përfshirë në indoktrinimin,radikalizimin dhe logjistikën për dërgimin e personave që të luftojnë në radhët e ISIS-it në Siri dhe Irak”,27 persona u konsideruan si të pakapshëm për autoritet,prej ku për 20 persona u supozua se janë bashkangjitur organizatës ekstremiste ISIS në Siri.Ky aksion ngërtheu në vete një sërë veprimesh, autoritet nga MPB kanë realizuar të gjitha veprimet parahetimore dhe më pas në ditën kritike kanë realizuar edhe bastisje në disa qytet si në Kumanovë,Shkup,Tetovë, Gostivar dhe Strugë,me që rast janë kontrolluar disa shtëpi private,banesa,OJQ, internet kafe dhe dy xhami.(24vesti. Akcia Kelija (Aksioni Celula) <http://24vesti.mk/policiskata-akcija-%E2%80%9Ekjelija%E2%80%9C-na-mvr-uapseni-9-teroristi-27-se-vo-begstvo> publikuar më 06.gusht.2015, i qasshëm më 11.nëntor.2017) Të gjithë këta persona akuzoheshin për veprën penale të paraparë në KPM neni 322-a pjesëmarrje në formacion të huaj ushtarak, policor, paraushtarak apo parapolicor. Më 9 korrik 2016 MPB filloi operacionin Celula 2 dhe arrestoi 4 persona të dyshuar për pjesëmarrje në organizatat e huaja paraushtarake.(Vecer,detail za operacija keltja 2 (detaje për operacionin celula2) <http://vecer.mk/makedonija/detali-za-kjelija-2-eve-koi-se-uapsenite-pominale-voeno-terroristichka-obuka-vo-sirija> publikuar më 9.korrik.2016 i qasshëm më 11.nëntor.2017)Në mesin e të dyshuarve,pesë janë nga Shkupi,një nga Tetova dhe një nga Kumanova.Janë kapur B.G. (23), F.I.(31),E.U.(36) dheM.M.(38),përderisa B.S. (32) ndodhet në arrati, kurse për S.R.(26)nga Shkupi dheS.I.(27) nga Kumanova konsiderohet se ndodhen në Siri.Këta persona në opinion u cilësuan si ekstremist të dhunshëm me pretekst religjioz të cilët në bazë të aftësive ushtarake të fituara në vendet e krizës në lindje të mesme Siri dhe Irak dhe aplikimit të aftësive të fituara në territorin e Republikëssë Maqedonisë do të cenonin sigurinë e saj, por jo vetëm të saj ,por duke përfshi këtu edhe shtetet e rajonit.Ky rast edhe pse mori epilog gjygjësor,në opinion la shumë paqartësi dhe kontradikta,e gjithë kjo si rezultat i humbjes së besueshmërisë në institucionet shtetërore.

4.7 Rasti i 27 Prillit 2017

Përpos rastit Celula, rast tjetër i ekstremizmi të dhunshëm i ndodhur në praktikë paraqet edhe ngjarja e 27 prillit 2017 në Kuvendin e Maqedonisë përkatësisht në shtëpinë e demokracisë. Për shkak të ndikimit të shumë rrethanave ky rast akoma nuk është kualifikuar saktësisht, respektivisht nuk ka arritur të definohet dhe të dihet dhe më pas të njoftohet opinioni se çka në realitet ndodhi në këtë datë. Ky rast dëshmon qartë se ekstremizmi dhe radikalizmi mund të jetë edhe i natyrave të tjera, e jo vetëm i asaj fetare. Në këtë sulm mbi institucionin më të lartë të demokracisë në Republikën e Maqedonisë ekstremistët nacionalistë sulmuan ashpër jo vetëm përfaqësuesit e zgjedhur të popullsisë shqiptare në Maqedoni, por viktimat ishin edhe përfaqësuesit maqedonas. Në këtë sulm u rrezikuan jetrat e shumë personave, ndërsa që rreziku më i madh ka qenë arritja eventuale e sukseseve të këtyre ekstremistëve për të imponuar zgjedhjet e tyre të dhunshme dhe duke e mohuar vullnetin e popullsisë në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë.

Është e rëndësishme të theksohet se si u zhvillua e gjithë kjo ngjarje dhe si arriti në pikën kulminante. I gjithë tensioni politik filloi me një proces të udhëhequr nga opozita në krye me LSDM dhe kryetarin e saj Zoran Zaev. Opozita e filloi procesin e njohur si „E vërteta për Maqedoninë”, nëpërmjet të ashtuquajturave „bomba” plasoi në opinion skandale shumë të rënda të pushtetarëve apo të njerëzve më me ndikim në Maqedoni për disa vite me rradhë. Për të dalur nga kjo situatë e krijuar si zgjidhje parashihej mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare me çka populli do të vendoste se kush në realitet ka të drejtë dhe si rrjedhojë e kësaj më 11 dhjetor të vitit 2016 në Republikën e Maqedonisë u zhvilluan zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Rezultati i ngushtë i këtyre zgjedhjeve thelloi edhe më shumë krizën pasi dy partitë kryesore ishin shumë afër njëra tjetrës përkatësisht VMRO DPMNE fitoi 51 deputet dhe LSDM 49, dhe kështu filloi lufta se cila nga këto parti do të formojë qeverinë e ardhshme. Në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, shumë qartë parashihet se cila parti ose koalicion mund të formojë qeverinë edhe atë në bazë të nenit 90 të kushtetutës „Kryetari i shtetit është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga konstituimi i parlamentit mandatin për formimin e qeverisë t’ia dorëzoj kandidatit të partisë, përkatësisht partive të cilat kanë shumicë në parlament. (Neni 90 i Kushtetutës së R.M., së [https:// www. sobranie. mk/ WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf](https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf)-i qasshëm më 11.nëntori.2017) Pas kësaj situatë të krijuar kryetari i shteti e luajti rolin më destruktiv dhe ndikoi në përkeqësimin edhe më të madh të tërë këtij procesi duke e zëvendësuar obligimin e tij për dhënien e mandatit ashtu siç parasheh kushtetuta në të drejtë ekskluzive të tij. I njejtë veproi në kundërshtim me kushtetutën,

pasi që pa e pasur asnjë garancion zyrtar për sigurimin e shumicës në parlament, ai mandatin për formimin e qeverisë ia dorëzoi kandidatit i cili thirrej në fitore të zgjedhjeve edhe pse i njëjti nuk kishte shumicë të deputetëve në parlament, por, vetëm numër më të madh të deputetëve, e që këtë e arsyetoi në një praktikë apo rregull të pashkruar të zhvilluar në Republikën e Maqedonisë. Shumica në parlament përbëhet prej 61 deputetëve, ndërsa kandidati i cili mori mandatin kishte 51 deputetë. I njëjti pasi mori mandatin edhe pse në mënyrë të kundërligjshme zhvilloi bisedime për formimin e qeverisë vetëm me një parti shqiptare atë të Bashkimit Demokratik për Integrim, pasi dy të tjerat Besa dhe Aleanca për Shqiptarët ishin kategorikisht të prerë se nuk do bënin koalicion me VMRO DPMNE në asnjë mënyrë. Pas kalimit të 20 ditëve, afat ky kushtetues ligjor për themelimin e qeverisë VMRO DPMNE nuk mundi të siguroj shumicë në parlament, shumicë kjo e supozuar dhe në këtë mënyrë nuk arriti të formojë qeveri. Pas këtij momenti u paraqit një situatë e re, me që rast ata të cilët nuk arritën të formojnë qeverinë kërkonin zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare. Në anën tjetër gjithnjë duke u thirrur në rregulla të pashkruara apo në praktikën e mëparshme partia e cila ishte e dyta me numër më të madh të deputetëve kërkonte që mandati për formimin e qeverisë t'i dorëzohej asaj, dhe e njëjta pretendonte se ka shumicë të siguruar të deputetëve në parlament. Kryetari i shtetit duke u thirrur në të drejta ekskluzive të cilat në realitet nuk i ka, vazhdoi ta ndërlikojë edhe më shumë situatën. Ai fillimisht refuzoi që t'ia ndaj mandatin të njëjtës ndërsa më pas me një sërë shtytjesh nga ana e ndërkombëtarëve, ai pranoi ta ndaj mandatin, por këtë herë ashtu siç e kërkon edhe kushtetuta duke u siguruar se mandatarin i ri ka shumicë në parlament, madje duke kërkuar edhe nënshkrime nga 61 deputetët e zgjedhur në parlamentin e Maqedonisë. E gjithë kjo periudhë kohore në të cilën u zhvilluan këto ngjarje, krijuan pakënaqësi në masë edhe pse njëra palë arriti që t'i kontrolloj siç ishte LSDM, ndërsa pala tjetër simpatizues të VMRO- DPMNE-së gjithnjë e më shumë e shfaqnin pakënaqësinë e tyre, duke zhvilluar fillimisht protesta nëpër rrugët e Shkupit, e më pas edhe në disa qytete të tjera. Nga frika e humbjes së pushtetit disa vjeçar dhe përballja me institucionet e drejtësisë partia e cila nuk arriti të formojë qeverinë, gjithnjë e më shumë filloi mobilizim në popull, madje duke e ndërlidhur pushtetin e tyre me fatin e Republikës së Maqedonisë dhe kështu gjatë protestave të zhvilluara thirreshin gjithmonë me parulla antishqiptare dhe anti LSDM, respektivisht parulla kundër bashkëqytetarëve të tyre. Poashtu protestuesit bënin thirrje për një „Maqedoni të pastër” ose „Maqedonia e maqedonasve”, me çka nga këto parulla shfaqet apo vërehet ekstremizmi nacional dhe etnik. Elementet kryesore me të cilat rasti i 27 prillit mund të cilësohet si terrorizëm i shtytur nga ekstremizmi i dhunshëm politik duke mos munguar edhe ai etnik dhe nacional, filluan të dalin në pah që gjatë zhvillimit të protestave disa mujore të udhëhequra nga nacionalistët maqedonas dhe organizata ekstreme të formuara

me qëllim kinse për mbrojtje të atdheut të tyre si nëpërmjet parullave të sipërpërmendura ashtu edhe me veprime tjera dhe duke arritur pikën kulminante më datën kritike. Elementi kryesor që mund të vërehej te këta ekstremistë të cilët protestonin me muaj, ishte se kërkesat që paraqisnin në opinion ishin të njëjta me ato të partisë e cila tashmë e kishte kuptuar se ka humbur pushtetin dhe e njëjta dëshironte që me çdo çmim të shkoj deri në fund. Të njëjtit paralajmëronin se në rast se zgjidhet ndonjë shumicë e re, respektivisht në rast se zgjidhet kryetari i parlamentit, ata do t'i sulmojnë institucionet shtetërore, madje në raste të caktuara duke përdorur edhe terme si „do të derdhet gjak” apo „do të ketë luftë” dhe meqë një ndër elementet kryesore të terrorizmit është vënia apo shkaktimi i frikës, pasigurisë, tmerrit në masë respektivisht popull, thirrjet e këtilla ndikuan të shkaktojnë drojë te qytetarët e thjeshtë se diçka e tmershme do të ndodh në Republikën e Maqedonisë, që do të thotë se elementi i vënies së frikës në popull dalëngadalë filloi të instalohet. Nga ana tjetër realiteti i ri respektivisht shumica e re me vëmendje ndërmerre çdo hap që mos të vijë deri te eskalimi i situatës, mirëpo duke u bazuar në parimet themelore të demokracisë shumica e re e kishte për obligim që të ndërmarrë veprime konkrete për zgjidhjen e ngërçit dhe konstituim të institucioneve në mënyrë që shteti të funksionojë normalisht. Dita në të cilën shumica e re vendosi të ndërmarrë veprime konkrete ishte pikërisht 27 prill 2017, me që rast kjo ditë tashmë është shënuar në historinë moderne të Republikës së Maqedonisë. Ky rast, padyshim që përmbush të gjitha elementet e ekstremizmit të dhunshëm kryesisht politik sepse me anë të dhunës u tentua të ndryshohet realiteti i ri politik i shfaqur në bazë të parimeve themelore të demokracisë nëpërmjet zgjedhjeve të lira, ndërsa autorët e kësaj ngjarjeje padyshim se duhet të përgjigjen për çënim të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, respektivisht për terrorizim. Më 27 prill me sulmin ndaj përfaqësueve të zgjedhur, fillimisht u sulmuan qytetarët e Republikës së Maqedonisë më pas demokracia dhe çdo vlerë e saj. Vënia e drejtësisë për këtë ngjarje do të jetë satisfaksion për të qetësuar të gjithë ata qytetarë të cilët në këtë datë kritike u frikësuan dhe u tmerruan se çka në realitet do të ndodhë në vendin e tyre.

4.8 Rasti Monstra

Njëra ndër ngjarjet që e ka tronditur opinionin publik në Maqedoni ka qenë edhe rasti i vrasjes së pesë të rinjëve të nacionalitetit maqedon te liqeni artificial i Smilokves (Smilkovci) në afërsi të Shkupit. Kjo ka qenë ndër ngjarjet më të rënda kriminale në historinë e Maqedonisë dhe reagimet kanë qenë të shumta. Fillimisht për këtë rast ishin arrestuar dhe akuzuar 4 shtetas maqedon të nacionalitetit shqiptar si kryerës të kësaj vepre. Madje, Gjykata e

Shkupit i kishte shpallur fajtor dhe dënuar me burgim të përjetshëm të katërt prej tyre. Mirëpo, pas disa vitesh Gjykata Supreme e Maqedonisë pasi e ka trajtuar këtë rast i ka liruar të katër të dënuarit duke e trajtuar rastin në mënyrë shumë profesionale, sepse shkeljet procedurale gjatë gjykimit në shkallën e parë ishin të shumta. Të dënuarit dhe mbrojtja e tyre në mënyrë kategorike gjatë tërë rrjedhjes së procesit gjyqësor, e kanë mohuar kryerjen e kësaj veprë penale, por mohimi i tyre nuk u mor parasysh nga gjykata, e cila edhe përkundër mungesës se provave bindëse mori aktgjykim dënues për katër të pandehurit shqiptarë dhe ky vendim shihej si një vendim i ndikuar politik.

Ky rast i njohur në opinion si rasti MONSTRA, kishte krijuar polarizime të shumta në shoqërinë maqedonase, ku nacionalistët maqedonas kishin ndërmarrë edhe disa veprime hakmarrëse duke e përkeqësuar edhe më tutje situatën. Sidoqoftë, pas ndryshimit të pushtetit politik në Maqedoni, ky rast ka marrë trajtimin e duhur profesional, të pa ndikuar politik nga gjyqësori në Maqedoni.

KAPITULLI V:

5. Ekstremizmi i dhunshëm dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

5.1 Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në luftën kundër ekstremizmit, radikalizmit që shpiejnë në terrorizëm

Një ndër çështjet më të diskutuara në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe të terrorizmit në veçanti është respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Në vazhdimësi janë dëgjuar akuza të shumta nga individët, grupe për të drejtat e njeriut dhe nga mediat se në luftën kundër terrorizmit ka shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Qeveritë e shteteve të akuzuara kanë mohuar në vazhdimësi akuzat e bëra, por, ka pasur edhe raste kur kanë shpërthyer edhe skandale të mëdha lidhur me keqtrajtimin e të burgosurve të dyshuar për terrorizëm. Raste të tilla kanë ndodhur në burgun Abu Graib në Irak, në Guantanamo, por akuzat ka pasur edhe për torturim të të burgosurve palestinez në burgjet izraelite.

Format më të shpeshta të përdorimit të torturës, jo vetëm në marrjen në pyetje të të dyshuarve për terrorizëm, por në përgjithësi janë të llojllojshme, dhe qëllimi kryesor është shkaktimi i tronditjes së fortë fizike dhe psikike i personit ndaj të cilit ushtrohet tortura. Tortura fizike përfshinë rrahje sistematike në pjesë të ndryshme të trupit, tortura elektrike, djegie me mjete të ndryshme, zhytje në ujë, thyerje të dhëmbëve të shëndoshë, mos dhënie të ushqimit dhe ujit, etj. Tortura psikike përfshijnë privimin nga e drejta në kontakte me njerëz të tjerë, privimi nga e drejta egjimit dhe pushimit, poshtërimi, tallja, kërcënimet, apo edhe imitimi i ekzekutimit. (Prof. Dr. Vesel Latifi, "Politika Kriminale", Prishtinë 2008, p. 102-104)

Akt i torturës, do të thotë kryerje ose moskryerja e një akti me anë të të cilit me qëllim shkaktohet dhembja e rëndë ose vuajtja, qoftë fizike ose mendore e personit me qëllim të marrjes së informacionit a deklaratës nga personi i tillë, ose nga personi i tretë, e cila ka për qëllim dënimin e personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e kanë kryer, apo edhe frikësimin edetyrimin e personit ose personit të tretë. Akti i torturës nuk përfshin cilindo akt ose mungesën e tij, që rrjedh vetëm nga aktet e

pashmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.(Kodi Penal i Kosovës,Neni 199,paragrafi 3)

Sa i përket përdorimit të torturës dhe kërcënimeve gjatë trajtimit të të dyshuarve për terrorizëm, shumica dërmuese e akterëve që merren me çështjet e terrorizmit janë të mendimit se këto janë metoda të ndaluara dhe të papranueshme. Mirëpo, edhe në këtë rast gjërat nuk mund të merren bardh e zi. Përkundër faktit se Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka aprovuar *Deklaratën për mbrojtjen e të gjithë personave nga tortura dhe veprimet e tjera johumane dhe poshtëruese apo ndëshkimi*, dhe mbi këtë bazë në vitin 1984 ka aprovuar edhe *Konventën kundër torturës dhe veprimeve të tjera mizore, johumane dhe poshtëruese apo ndëshkuese*, (Kjo konvente ka hyrë në fuqi rreth 3 vjet pas aprovimit, konkretisht kjo është bërë e obligueshme nga data 26 qershor 1987) megjithatë nuk mund të thuhet se këto konventa janë plotësisht të zbatueshme.

Konventa e lartcekur e definon torturën si çdo akt që shkakton dhembje ose mundim (fizik ose psikik), të cilin e bën ose e çyt personi zyrtar, në mënyrë që nga personi i keqtrajtuar ose nga personi i tretë të fitojë informata ose pohim ose që personi i tillë të dënohet për veprën e akuzuar (neni 1 i Konventës). Akt i torturës konsiderohet cenimi flagrant i të drejtës së njeriut, të cilin duhet penguar çdo shtet. Konventa gjithashtu parasheh aktivitete komplekse preventive në formë të aktivitetit edukues dhe informativ, të mbikëqyrjes sistematike mbi organet hetuese dhe burgjet, të drejtën e ankesës dhe kompensimin e viktimave të torturës (nenet 17-24). (Dr. Ejup Sahiti, “Psikologjia Gjyqësore”, p,90, Prishtinë 2007)

Por ,cilat janë aktet torturuese për të cilat organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, mediat dhe të akuzuarit për terrorizëm (ose mbrojtësit dhe familjarët e tyre) pretendojnë se janë zbatuar nga zyrtarët e disa shteteve të ndryshme? Pasi është e pamundur të numërojmë të gjitha metodat e përdorura, të cilat është vështirë të dallohen nëse janë legale apo ilegale, ne do të përmendim vetëm një të njërën prej tyre, që ka sjellur deri te zbulimi i vendndodhjes së Osama Bin Ladenit.

Metoda **Waterbordig** është përdorur gjerësisht viteve të fundit në burgun e Guantanamo, në burgjet në Irak e Afganistan. Kjo metodë edhe nga presidenti Obama në fillim të mandatit të tij të parë në 2009 është konsideruar si torturë, mirëpo çuditërisht me kalimin e kohës jo vetëm kjo metodë, por edhe metoda të tjera që konsideroheshin torturuese u rishikuan dhe u gjet një shprehje e re për to. Këto metoda u quajtën “teknika te avancuara të marrjes në pyetje”, dhe si të tilla iu paraqitën Kongresit amerikan dhe publikut.

Metoda Waterbordig aplikohet ndaj të dyshuarve për terrorizëm në atë mënyrë që ata pasi lidhen dhe shtrëngohen fort pas një karrigeje,forcërisht iu hapet goja dhe i vendoset një shami (apo diçka e tillë) dhe pastaj një gyp me shtypje të konsiderueshme të ujit i futet në gojë.Organizmi i të dyshuarit nuk mund ta përballojë dhe kontrollojë sasinë e ujit që i jepet me forcë dhe kjo shkakton një tronditje të fuqishme fizike dhe psiqike.Dëmtimet fizike janë të mëdha në organet e brendshme, ndërsa efekti më i madh arrihet në psiqikën e të dyshuarit, të cilit i krijohet iluzioni se është në mes të një liqeni dhe në pamundësi për të notuar dhe lëvizur do të vdes shpejt. Kjo metodë përdoret disa herë gjatë seancave të intervistimit, derisa personi i dyshuar të fillojë të japë informacionet që kërkohen prej tij.

Në një ligjeratë në Tashkent,Uzbekistan,më 17 Prill 2000,Sekretarja amerikane e shtetit,zonja Medlin Olbright lidhur me përdorimin e torturës dhe shkeljen e të drejtave të njeriut deklaroi:“Një nga tundimet më të rrezikshme të një qeverie që merret me kërcënimet e dhunshme është përgjigjja ndaj asaj dhune në mënyrë të ashpër duke i shkelur të drejtat e qytetareve të pafajshëm.Terrorizmi është një akt kriminal dhe duhet të trajtohet në përputhje me rrethanat,e kjo nënkupton që ligji duhet të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të vazhdueshme.Nga përvoja në tërë botën,ne kemi vërejtur se mënyra më e mirë për të mposhtur kërcënimet nga terrorizmi është pikërisht ngritja e kapaciteteve të forcave të rendit, dhe në të njëjtën kohë,promovimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut”.(Keith Weston, “Law Enforcement in a Democratic State”, Madeleine Albright, US Secretary of State, University of World Economy and Diplomacy,Tashkent, Uzbekistan, 17 April 2000.)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në dispozitat e nenit 23,në mënyrë të qartë e fuqizon dinjitetin e njeriut si bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të tij, ndërsa në nenin 26 përcaktohet pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psiqik të secilit person që gjendet apo jeton në Republikën e Kosovës.Me dispozitën e nenit 27 të kësaj Kushtetute,decidivisht garantohet e drejta e çdo njeriu se nuk do t’i nënshtrohet torturës,ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.Kështu, edhe Kodi penal dhe Kodi i Procedurës Penale i mbron këto të drejta dhe liri themelore të secilit qytetar të Republikës së Kosovës.

Kodi Penal i Kosovës ka sanksionuar si vepër penale çdo veprim të personit zyrtar, i cili duke përdorur dhunën,forcën fizike apo kanosjen,tenton të marrë informata nga personi i marrur në pyetje.Çdo person zyrtar, i cili duke keqpërdorur detyrën zyrtare përdor forcën apo kanosjen serioze ose mjete apo mënyra të tjera të ndaluara me qëllim të detyrimit të të dyshuarit,të pandehurit,dëshmitarit,ekspertit apo personit tjetër për të dhënë ndonjë deklaratë-dënohet.(Kodi Penal i Kosovës, Neni 197, paragrafi1)Edhe pse KPK nuk i përcakton se cilat

janë mjetet dhe mënyrat e ndaluara, si të tilla konsiderohen përdorimi i mjeteve medicinale, të cilat ndikojnë që ai të japë deklaratë pa vullnetin e tij. Duhet theksuar se marrja e deklaratës me anë të forcës, kanosjes apo torturës është e ndaluar edhe sipas dispozitave të KPPK, dhe një provë e tillë është e papranueshme edhe për trupin gjykues.

5.2 Liria e mendimit, ndërgjegjjes dhe fesë apo besimit fetar

Lufta kundër terrorizmit imponon edhe vendime dhe veprime të institucioneve shtetërore të cilat mund të kenë pasojë edhe ndalimin, kufizimin apo edhe shkeljen e disa të drejtave elementare të njeriut, të cilat janë të mbrojtura me kushtetutë dhe akte ndërkombëtare.

Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme kundër terrorizmit në zona të caktuara mund të sjellë në situatë kur kufizohen të drejtat si, liria e lëvizjes, apo të drejta të tjera të ngjashme. Mirëpo, në asnjë rrethanë nuk guxon të krijohet aso situatë, kur institucionet shtetërore do të ndalojnë lirinë e mendimit, shprehjes apo lirinë e zgjedhjes dhe praktikimit të besimit fetar. Ky do të ishte veprimi më i gabuar i çdo shteti, nëse duke përdorur çfarëdo forme të dhunës apo presion në emër të luftimit të terrorizmit do të bënte veprime të tilla atëherë lufta kundër këtyre dukurive do të jetë shumë më e vështirë dhe e komplikuar, mbështetja ndaj institucioneve shtetërore do të ishte shumë më e vogël si nga opinion publik, e poashtu edhe nga shtetet tjera partnere.

Liria e mendimit e cila nënkupton mendimin e lirë dhe shprehjen e atij mendimi është kategori kushtetuese. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, vendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, neni 40, paragrafi 1)

Megjithatë, duhet kuptuar se liria e shprehjes dhe mendimit ka dhe kufizimet e veta, sidomos në rastet kur duke e keqpërdorur këtë të drejtë në situatë të caktuar mund të ketë akte tënxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Në raste të tilla shteti mund të intervenojë dhe të kufizojë këto të drejta. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, neni 40, paragrafi 2)

KAPITULLU VI:

6. Aplikimi i masave Parandaluese

6.1 Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpiejnë në Terrorizëm, konceptet kryesore të tyre

Duke pasur parasysh përhapjen e terrorizmit, fleksibilitetin e përshtatjes me rrethanat në terren të grupeve terroriste,avantazhin e lëvizjes së lirë që ofron procesi i globalizmit, mund të konstatohet se është e pamundur që lufta efikase kundër terrorizmit të bëhet nga një shtet i vetëm, cili do qoftë ai.

Edhe pse grupet terroriste për dekada me radhë, në një mënyrë, iu kanë qëndruar besnik ideve të tyre, megjithatë është vërejtur një fleksibilitet në aplikimin e taktikave, metodave dhe pajisjeve të reja.Ky ndryshim i vazhdueshëm ka të bëjë me aplikimin e metodave të reja të kryerjes së sulmeve,dhe jo vetëm kaq,sepse për vite me radhë grupet terroriste kanë sofistikuar metodat e tyre edhe sa i përket komunikimit me përkrahësit e tyre, dërgimin e mesazheve përmes mediave të shkruara,vizive dhe elektronike,mënyrat e rekrutimit të anëtarëve të rinjë,mënyrat e financimit dhe udhëheqjes së organizatës dhe përzgjedhjen e caqeve.

Terrorizmi në shumë pjesë të botës po paraqitet si një formë e re e konfliktit, shumë e ndryshme nga luftërat konvencionale apo luftërat guerile.Disa nga këto veçori të luftës guerile janë modifikuar nga grupet terroriste,por këto grupe, zakonisht kanë numër të vogël të njerëzve të përfshirë në ndonjë operacion,kanë armatim të lehtë, mjete shpërthyes, nuk bartin uniforma, aplikojnë taktika të rrëmbimit të njerëzve,përdorin veturat-bomba,përdorin pengjet si mburojë,nuk e kufizojnë aktivitetin e tyre në një zonë të caktuar,por e përhapin atë deri në nivel rajonal apo edhe ndërkombëtar.(A.Merari in V.S.Ramachandran, “Encyclopaedia of Human Behaviour”,Volume 4, (San Diego, CA., Academic Press, 1994), p, 401 with amendments by T. Maley in 2008.)

Sfida më e madhe në luftën kundër terroristëve dhe kryengritësve është identifikimi i tyre. Ata nuk bartin uniforma apo pajisje të kamufluara ushtarake apo policore, të cilat në çfarëdo forme do t'i identifikonin. Përkundrazi, ata janë të fshehur mes popullatës civile nëpër zonat urbane e jo në malet e thella, sikur guerilët e dekadave të kaluara. Për t'u ballafaquar në mënyrë të suksesshme me grupet terroriste dhe kryengritëse është bërë ri-dizajnimi i forcave të sigurisë dhe krijimi i njësiteve jo shumë të mëdha numerikisht, por të paisura me armatim funksional dhe të trajnuar për konflikte në zonat urbane.

Sfida të tjera në luftën kundër terrorizmit janë edhe ndërprerja e financimit të grupeve apo organizatave terroriste; zbehja e përkrahjes së masave të gjëra për aktivitetin dhe ideologjinë e tyre, sepse pa një përkrahje nga masat e gjëra, si në zonat e konfliktit e po ashtu edhe larg tyre është e pamundur që një grup ose organizatë terroriste të ushtrojë aktivitet në mënyrë të vazhdueshme. Radikalizmi është një sfidë shumë e madhe, dhe në shumë raste sfida kryesore në luftimin me sukses të grupeve dhe organizatave terroriste në shekullin tonë.

Jo stabiliteti politik i shteteve, të cilat rrezikohen nga terrorizmi, pastaj mungesa e kapaciteteve të strukturave të sigurisë; mungesa e përkrahjes së opinionit publik për masat e ndërmarrja, apo edhe ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të pamjaftueshme e strategji jo funksionale.

Pak është e besueshme se terrorizmi do të çrrënjohet njëherë e përgjithmonë. Gjasat për një gjë të tillë nuk janë fare më të mëdha se sa gjasat për çrrënjohjen e dhunës në marrëdhëniet ndërnjerëzore apo në marrëdhëniet ndërshtetërore. Megjithkëtë, duhet të bëhen përpjekje maksimale për kundërvënien kësaj dukurie, qoftë duke i parandaluar pasojat e saj apo duke i kapur dhe ndëshkuar kryerësit e akteve terroriste. (Dr.Sc.Haki Demolli, "Terrorizmi", Prishtinë 2002, p, 273)

Lufta kundër terrorizmit do të jetë e gjatë dhe e kushtueshme. Kjo luftë duhet të fokusohet në shkaqet që e shkaktojnë terrorizmin. Është shumë e besueshme se terrorizmi është përgjigje ndaj padrejtësisë, ku terroristët janë njerëz të shtyrë të ndërmarrin aksione të dëshpëruara nga kushtet e papërbalueshme të varfërisë, mungesës së shpresës apo nga shtypja politike dhe sociale. Nëse këto arsye time i marrim si të mirëqena, e vetmja mënyrë për të larguar apo së paku për të zvogëluar terrorizmin është trajtimi i burimeve të tij. Pra, duhet të merremi me ankesat dhe frustrimin e tyre, para se, thjesht, të ballafaqohemi me ta përmes brutalitetit të forcës. Siç ka thënë një linguist amerikan, "Thaje moçalin dhe mushkonjat do të zhduken vet". (Walter Laquer, "Roots of Terrorism", PTSS 10-03, #2613-E, faqe 1,

“European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish- Partenkirchen, Gjermani

Vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet zhvillimit ekonomik të zonave problematike, arsimimit të popullsisë, investimet në infrastrukturë, shëndetësi, mirëqenie sociale dhe masa të tjera të karakterit politiko-kriminal. Politika të ngjashme kanë ndjekur Kolumbia dhe Turqia dhe rezultatet kanë qenë të prekshme.

6.2 Aplikimi i masave parandaluese nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjia kombëtare dhe qasja në luftën kundër terrorizmit

Lufta kundër ekstremizmit dhe terrorizmit nuk mund të jetë efikase nëse ajo nuk bazohet në një strategji të saktë dhe të detajuar, me këtë strategji përcaktohen objektivat afatgjate se si do të arrihet deri te suksesi i kërkuar.

Shtetet të cilat ballafaqohen me sfida të terrorizmit nxorren dokumente strategjike për mënyrën e luftimit dhe parandalimit të tyre. Edhe Republika e Kosovës ka nxjerrë dokumentet e saj strategjike për t’u ballafaquar me këto sfida. Strategjia kundër terrorizmit është dokumenti strategjik i tretë me radhë, i nxjerrë nga Qeveria e Kosovës. Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2022 është dokumenti i tretë strategjik i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprave terroriste. Ky dokument strategjik ka për synim kundërshtimin dhe luftimin e ideologjive ekstremiste apo radikale, të çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të shpiejnë në përdorimin e dhunës dhe bien ndesh me normat dhe parimet demokratike të shoqërisë kosovare. Tutje, ajo synon në parandalimin e aktiviteteve terroriste, minimizimin e rrezikut nga kërcënimet terroriste, si dhe uljen e cënueshmërisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndër institucionale, por gjithë shoqërore, e cila do të krijojë një bazë fleksibile për reagim më efikas ndaj kërcënimeve ekzistuese dhe dinamikave tjera gjithnjë në rritje dhe shumë dimensionale. (<http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40243>)

Strategjia bazohet në katër shtylla apo objektiva strategjike të cilët janë në harmoni të plotë me Strategjinë e BE-së kundër Terrorizmit:

1. **Parandalimi**, i cili ka për qëllim parandalimin e terrorizmit përmes identifikimit dhe kundërshtimit të shkaktarëve, respektivisht kundërshtimit të ideologjive dhe doktrinave radikale të cilat nxisin individët në akte të dhunës.
2. **Mbrojtja**, përmes së cilës do të forcohen kapacitetet mbrojtëse të institucioneve ndaj sulmeve terroriste, respektivisht kërcënimeve të terrorizmit që i paraqiten Republikës së Kosovës ose të interesave të saj në rajon dhe më gjerë. Përveç forcimit të

kapaciteteve mbrojtëse, janë planifikuar edhe masa specifike në minimizimin e cenueshmërisë nga ky fenomen.

3. **Ndjekja**, përmes së cilës agjencitë e zbatimit të ligjit do të ndjekin, hetojnë dhe sjellin para drejtësisë individët apo grupet që paraqesin kërcënim terrorist apo kryejnë vepra terroriste.
4. **Reagimi**, që ka për qëllim përgatitjen e institucioneve në menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të një sulmi potencial terrorist. Përgatitja dhe reagimi efektiv janë me rëndësi kritike për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet dhe pasojat e mundshme. (Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022).

Kjo strategji është e krijuar mbi bazën e disa parimeve bazë dhe mbi këto parime ajo edhe funksionon. Strategjia bazohet në këto parime:

- **Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë**-veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi.
- **Parimi i qasjes gjithpërfshirëse shtetërore**-parandalimi dhe luftimi efektiv i kërcënimeve terroriste arrihet përmes qasjes gjithpërfshirëse ndaj këtij nga të gjitha institucionet qeveritare, publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.
- **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut**-nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.
- **Parimi i konfidencialitetit**-institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informatave gjatë procesit të hetimeve dhe proceseve tjera përkatëse.
- **Parimi i bashkëpunimit**-Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në lehtësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore.
- **Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar**-Republika e Kosovës do të luaj rol të rëndësishëm në luftën globale kundër terrorizmit dhe se parandalimi dhe luftimi efikas i terrorizmit arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me shtete, organizata dhe iniciativa, andaj Republika e Kosovës shpreh gatishmërinë dhe përkushtimin e saj që të jetë pjesë e mekanizmave ndërkombëtar që merren me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. (Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022, p, 7).

Kjo strategji,tutje përmban edhe analizën e situatës aktuale ku ndër kërcënimet më serioze për sigurinë në Kosovë konsiderohen:

- **Sulmet terroriste** qoftë nga pjestarët e organizatave terroriste përmes luftëtarëve të huaj terrorist,celulave të fjetura,por edhe nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të inspirohen për kryerjen e akteve të dhunshme.
- **Indoktrinimi me ideologji ekstremiste** i bazuar kryesisht përmes propagandës, indoktrinojnë dhe rekrutojnë personat e rinjë për t'i përdorur për qëllime të organizatave terroriste;
- **Migrimi i parregullt** duke marrë parasysh pozitën gjeografike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përveç kthimit të luftëtarëve të huaj me origjinë nga këto vende,shqetësim tjetër ngelet edhe mundësia që edhe luftëtarët e huaj terrorist nga vendet tjera të shfrytëzojnë vendet e Ballkanit Perëndimor,duke u përzier edhe me refugjatët e mundshëm,me synim që pastaj të udhëtojnë drejt vendeve të BE-së.(Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022, faqe 9).

Strategjia është e ndërtuar edhe mbi bazën e ligjeve të aplikushme dhe kushtetutës dhe në të cilën saktësisht janë paraparë 37 ligje dhe Kushtetuta e Kosovës është bazë ligjore për luftimin dhe parandalimin e terrorizmit. Më tutje kjo strategji parasheh institucionet shtetërore të cilat kanë obligime ligjore në luftimin e këtyre fenomeneve, e ato janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Koordinatori Nacional kundër Terrorizmit
- Sekretariati i Strategjive
- Policia e Kosovës
- Agjencia e Kosovës për Forenzikë
- Agjencia e Menaxhimit Emergjent
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Sistemi Gjyqësor -Rastet e terrorizmit në Kosovë trajtohen nga tri nivele:Gjykata Themelore,Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme,
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Prokuroria e Shtetit
- Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
- Ministria e Drejtësisë
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues i Kosovës

- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
- Ministria e Financave
- Dogana e Kosovës
- Njësia e Inteligjencës Financiare
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Integritimit Evropian
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore
- Zyra për mbrojtjen dhe ndihmë të viktimave. (Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022, p, 11-15)

Ne fund kjo strategji parasheh edhe objektivat e saj dhe afatin kohor për zbatimin e saj.

6.3 Masat represive në luftën kundër ekstremizmit dhe terrorizmit

Varësisht nga rrezikshmëria që paraqesin sulmet apo aktivitetet terroriste në një shtet apo rajon, do të kyçen agjensione të ndryshme shtetërore në këtë luftë. Shtetet lidere në luftën kundër terrorizmit, siç janë SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, kanë angazhuar drejtpërdrejt edhe forcat ushtarake në Irak dhe Afganistan, në mënyrë që të luftojnë grupet terroriste. Poashtu edhe Turqia në mënyrë të heshtur për vite me radhë ka angazhuar ushtrinë e saj në pjesën Jug-lindore të shtetit në luftë kundër kryengritësve kurdë, të cilëve Ankaraja zyrtare iu referohet si terroristë.

Shtetet që janë më pak të prekura nga aktivitetet terroriste, zakonisht luftën kundër kësaj dukurie, apo thënë më mirë përcjelljen e ndonjë aktiviteti të dyshuar terrorist, e bëjnë përmes organeve të zbatimit të ligjit që në shumicën e rasteve nënkupton se organizatat policore të shteteve konkrete janë bartëse të kësaj lufte, por të ndihmuara edhe nga agjensionet tjera shtetërore të fushës së sigurisë. Përveç forcave të armatosura (ushtria), shërbimeve sekrete e organizatave policore edhe shumë institucione të tjera janë të kyçura në luftën kundër terrorizmit dhe në parandalimin e tij.

Rolin kryesor në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në Kosovë e ka Policia e Kosovës, e cila në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme në strukturën e saj e ka edhe Drejtorinë Kundër Terrorizmit. (Walter Laquer, “Roots of Terrorism”, PTSS 10-03, #2613-E, faqe 1, “European Centre For Security Studies”, “George C. Marshall”, Garmish-Partenkirchen, Gjermani). Kjo drejtori ka mandat ligjor që të monitorojë të gjitha aktivitetet e dyshuara të individëve dhe organizatave të caktuara, që kanë predispozita për të përhapur urrejtjen ndërfetare në mes të qytetarëve të Kosovës, përmes përhapjes së doktrinave radikale islamike.

Policia e Kosovës në përgjithësi dhe Drejtoria Kundër Terrorizmit në veçanti, ka mjaft detyra dhe obligime ligjore, ndër të tjerat edhe hetimi i aktiviteteve të dyshuara si dhe ndjekja penale e të gjithë kryerësve të mundshëm të ndonjë akti terrorist, siç është paraparë në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. DKT bashkëpunon ngushtë me Drejtoritë dhe Departamentet tjera policore brenda organizatës, ndërsa jashtë organizatës bashkëpunon ngushtë me Njësinë e Inteligjencës Financiare, (Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) e ndihmon Drejtorinë Kundër Terrorizmit të PKS në hetimin e rasteve të financimit të terrorizmit) me Agjencionin Kosovar për Inteligjencë (AKI), me Doganat e Kosovës, me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), me Koordinatorin Nacional Kundër Terrorizmit, me Ministrinë e Financave, me Administratën Tatimore, me gjykatat dhe prokuroritë si dhe me EULEX-in dhe KFOR-in. Një bashkëpunim të mirë, i cili duhet të vazhdojë të ngritet në nivele edhe më të larta, duhet krijuar me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe me Departamentin e Minierave, pastaj me organizatat joqeveritare, me mediat, me opinionin publik dhe me çdo mekanizëm tjetër, i cili në çfarëdo forme mund të kontribuojë në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, apo të çfarëdo lloji të ekstremizmit. Edhe bashkëpunimi ndërkombëtar duhet patjetër të avansohet, si në raport me shtetet fqinje poashtu edhe me shtetet tjera më të largëta si dhe me institucionet tjera relevante ndërkombëtare.

6.4 Llogaridhënia, Legjitimiteti dhe besimi tek institucionet e rendit

Në luftën e gjatë kundër radikalizmit ekstrem dhe terrorizmit, institucionet përgjegjëse shtetërore duhet të jenë shumë të kujdesshme në kuptim të respektimit të ligjeve në fuqi, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të krijojnë një raport të sinqertë të besimit me opinionin publik.

Çdo devijim i punës së institucioneve shtetërore do të krijonte një ndjenjë mos besimi të qytetarëve dhe mediave në kapacitetet, seriozitetin e këtyre institucioneve. Normalisht që pakënaqësia e opinionit publik ndaj institucioneve shtetërore është njëri ndër synimet e grupeve terroriste. Të gjitha institucionet që janë të përfshira në luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit duhet të jenë të hapura për opinionin publik (deri në atë masë sa mos të rrezikohet efikasiteti i punës së tyre) dhe ajo që është çështja më e rëndësishme është llogaridhënia ndaj organeve më të larta, por edhe ndaj opinionit publik.

Pjesa e tretë: Pjesa Empirike

KAPITULLI VII:

7. Aspekti hulumtues i shqiptimi të sanksioneve penale ndaj kryesëve të veprave Penale të Terrorizmit

7.1 Aspekti hulumtues i shqiptimi të sanksioneve penale ndaj kryesëve të veprave Penale të Terrorizmit në Gjykatat e Kosovës për periudhën kohore 2014-2017

Policia e Kosovës duke u bazuar në normat juridike në vendin tonë si dhe sipas Strategjisë Nacionale kundër Terrorizmit dhe planit të veprimit i cili buron nga kjo strategji monitoron çdo aktivitet të personave fizik dhe juridik për të cilët siguron informata se mund të paraqet rrezik për rendin kushtetues në të ardhmen, apo mund të kryejnë ndonjë veprë penale. E gjithë kjo bëhet me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të ndonjë veprë penale të mundshme, duke përfshirë veprat e terrorizmit dhe ekstremizmit.

Policia bazuar në mandatin e saj ligjor mbledh dhe analizon të dhëna për dukuri të cilat mund të paraqesin rrezik dhe kërcënim për sigurinë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunon me Prokurorinë për hapat e mëtutjeshëm hetimor. Policia e Kosovës ka kapacitete të mjaftueshme për të parandaluar dhe luftuar çdo formë të çfarëdo krimi apo veprë penale që bie në kundërshtim me ligjin duke përfshirë edhe sigurinë në brezin kufitar dhe në Aeroport.

Ne këtë aspekt PK-ja ka bashkëpunim shumë të ngushtë edhe me institucionet tjera të sigurisë në vend, duke përfshirë edhe institucionet relevante ndërkombëtare në vend, rajon dhe më gjerë.

STATISTIKAT:

Nga mesi i vitit 2012 janë shënuar rastet e para të bashkëngjitjes së Kosovarëve në zonën e konfliktit në Siri dhe pastaj edhe në Irak. Që nga viti 2012 e deri më tani janë 255 persona të gjinisë mashkullore në periudha të ndryshme kanë udhëtuar për në zonën e konfliktit dhe të cilët trajtohen si luftëtarë të huaj terrorist, ndërsa numri i luftëtarëve aktual që gjenden akoma në zonën e konfliktit është 57, ndërsa i personave

të kthyer në Kosovë, apo edhe në vendet tjera nga të cilat kanë udhëtuar për në zonën e konfliktit është 123.

Familjarë të tyre iu janë bashkëngjitur atyre në zonën e konfliktit, duke përfshirë 49 gra dhe 58 fëmijë, ndërsa aktualisht në zonën e konfliktit gjenden 41 gra, 55 fëmijë dhe 40 fëmijë të tjerë të lindur në zonën e konfliktit, së paku nga njëri prind me shtetësi apo me prejardhje nga Kosova

Numri i personave të kthyer në Kosovë apo edhe në vendet tjera prej nga kanë udhëtuar është 133, përfshirë këtu 123 meshkuj, 7 gra dhe 3 fëmijë

Numri i personave të vdekur në zonën e konfliktit është 76 persona, prej të cilëve 73 persona të gjinisë mashkullore të vrarë, ndërsa 3 persona, përfshirë këtu 1-person të gjinisë mashkullore, 1-person të gjinisë femërore dhe një fëmijë të lindur në zonën e konfliktit, raportohet të kenë vdekur nga shkaqe natyrore. (Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë -Prishtinë, Mail: zimp@kosovopolice.com)


GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

Lëndët për vitet 2015, 2016, 2017– vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtar i	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 46/15		S.I.	3		7	Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj 30.05.2017 dhe 800 Euro gjobë
2	PKR. 54/15		Z.Q.	139/31 147/2 143/2 374/2	10		Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste 25.10.2016
			I.B.		8		
			S.T.		7		
			B.B.		4	6	
			J.K.		4		
			L.K.		3		
			I.P.		5		
3	PKR. 65/16		F.R.	139/31	7		

4	PKR. 214/15		M.A.	139	5		Rekrutimi për terrorizëm 13.12.2016
5	PKR. 21/17		N.B.	3	Me kusht 2 vite prej 6 muajve		Bashkim apo pjesëmarrje në ushtrinë ose policinë e huaj 30.05.2017

Tabela 2 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017–në Gjykatën Themelore të Ferizajt



Grafiku 1 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Ferizajt


Lëndët për vitin 2015, 2016, 2017 - vepra terrorizëm

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

Lëndët për vitet 2016, 2017– vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 94/16		n.n	143	2		
2	PKR. 89/16		n.n	143	I dënuar me kusht		
3	PKR. 32/17		n.n	143	3		

Tabela 3 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Gjakovës



Grafiku 2 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Gjakovës


Lëndët për vitet 2016, 2017 - vepra terrorizëm

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

Lëndët për vitin 2015, 2016, 2017– vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 103/15		K.H		I dërguar për kompetencë në Gjykatën Themelore në Prishtinë		
			D.K				
			H.A				
2	PKR. 109/15		M.Z		1		Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me datë 01.09.2016
3	PRK. 101/16		L.R		1	6	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me datë 09.11.2017
4	PKR. 66/16		V.H		3	6	Aktgjykimi është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me datë 03.11.2016
5	PKR. 208/17		F.K		Ende e pavendosur		

Tabela 4 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Gjilanit



Grafiku 3 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Gjilanit

Lëndët për vitet 2015, 2016, 2017 - vepra terrorizëm


GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Lëndët për vitet 2015, 2016, 2017– vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 156/15		B.M.	143/2	1		Organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist 12.04.2017
2	PKR. 62/16		I.H.	142/152	Tërhequr aktakuza		Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste 25.10.2016
			S.H.				
			S.S.				
3	PKR. 67/17 dhe PKR. 86/17		Z.V.	142	Lënda është pazgjidhur		Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste

Tabela 5 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2016, 2017– në Gjykatën Themelore të Mitrovicës

Mënyra e vendosjes



Grafiku 4 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Mitrovicës


Lëndët për vitet 2015, 2016, 2017 - vepra terrorizëm

GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Lëndët për vitet 2015, 2017– vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës		Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
						Vite	Muaj	
1	PKR. 46/15			M.Z.	138/1	Me kusht 3 vite prej 2 viteve		Lehtësim në kryerjen e terrorizmit 21.12.2015
2	PKR. 241/15			S.M.	142	Me kusht 2 vite prej 3 viteve		Organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste 06.07.2017
3	PKR. 259/15			A.S.	138/23		8	Lehtësim në kryerjen e terrorizmit 15.03.2018
4	PKR. 68/17			R.A.	141		10	Shtytje në kryerjen e vprës penale 18.07.2017

Tabela 6 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë viteve 2015, 2017– në Gjykatën Themelore të Pejës



Grafiku 5 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Pejës

Lëndët për vitet 2015, 2017 - vepra terrorizëm

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lëndët për vitin 2014 – vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes	Vërejtje
1	PKR. 238/14	Eulex	A.K. – Ferizaj A.B. – Ferizaj	143	Hudhet akuza	
2	PKR. 695/14	Sh.H.	Burim Sejdiu - Vushtrri	143	Me kusht 2 vite për 3 vite	

Tabela 7 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2014, në Gjykatën Themelore të Prishtinës



Grafiku 6 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Lëndët për vitin 2014 - vepra terrorizëm

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS


Lëndët për vitin 2015 – vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 37/15	N.F.	V.Sh. – Gjilan	135	Në procedurë		PKR. 253/15 është e njëjta me lëndën 37/15
			A.M. – Gjilan				
			G.B. – Gjilan				
			N.S.– Prishtinë				
2	PKR. 100/15	N.B.	A.M. – Istog	143/2	4		
3	PKR. 263/15	A.B.	H.A.	143	3		
			N.A.		4	6	
			I.R.		4		
			E.B.		3	6	
			A.B.		3	6	
			L.L.		Me kusht 6 muaj për 1 vit		
			S.S.		3		
			H.E.		4	6	
			H.L		3		
			A.L		Me kusht 6		

					muaj për 1 vit		
			M.B.		3		
			S.H.		Me kusht 6 muaj për 1 vit		
4	PKR. 264/15	S.Q.	K.B.	143	Me kusht 6 muaj për 1 vit		
5	PKR. 392/15	Sh.G.	S.G.	144	13		Gjykata e Apelit 11 vite burg
6	PKR. 455/15	F.H.	E.S.	143	Me kusht 2 vite për 3 vite		
7	PKR. 505/15	V.S.	A.Xh.	143	4	6	
8	PKR. 538/15	N.B.	K.H.	138	4	6	
			D.K.		3	6	
			H.A.		3500 gjobë		
9	PKR. 687/15	N.F.	B.M.	135	Në procedurë		
10	PKR. 750/15	S.Q.	B.I.	144/4	Në procedurë		

Tabela 8 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2015, në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Mënyra e vendosjes



Grafiku 7 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Lëndët për vitin 2015 - vepra terrorizëm


GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lëndët për vitin 2016 – vepra terrorizëm

Nr. rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtari	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
1	PKR. 109/16	B.K	L.F - Viti	143	Në procedurë		
2	PKR. 372/16	Sh.G	A.L - Prishtinë	143	Me kusht 2 vite për 2 vite		
			N.B - Ferizaj		Aktgjykimi refuzues		
3	PKR. 375/16	A.H	I.H - Gjilan	139	Në procedurë		
			B.S - Viti				
4	PKR. 455/16	S.Q	V.C - Podujevë	3 par 3		12	
5	PKR. 510/16	V.I	B.R - Astrazub	141	Në procedurë		
			I.B - Prizren				
			E.G - Pejë				
			M.M - Prizren				
			F.R - Prishtinë				
6	PKR. 578/16	V.K	I.F - Fushë Kosovë	3 par 3	Në procedurë		
7	PKR. 619/16	V.S	A.K - Prishtinë	3 par 3	Lirohet nga akuza		
8	PKR. 679/16	V.S	A.A - Prishtinë		2	6	
9	PKR. 654/16	A.H	G.H - Prishtinë	143	Në procedurë		
10	PKR. 735/16	Sh. H	A.G - Pejë	3 par 3	Në procedurë		
11	PKR. 746/16	V.I	N.A - Mitrovicë	143	Në procedurë		
12	PKR. 774/16	B.K	A.A - Prishtinë	136	6		
			F.K. - Prishtinë		8		
			E.H - Prishtinë		5		
			A.B - Prishtinë		2		
13	PKR. 137/16	S.Q	T.I		Në procedurë		
			I.Z				
			N.Z				

Tabela 9 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2016, në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Mënyra e vendosjes



Grafiku 8 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Lëndët për vitin 2016 - vepra terrorizëm


GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lëndët për vitin 2017– vepra terrorizëm

Nr. Rendor	Nr. i lëndës	Gjyqtar i	Emri dhe mbiemri i të akuzuarit	Vepra	Mënyra e vendosjes		Vërejtje
					Vite	Muaj	
2	PKR. 65/17	B.K	Sh.K – Obiliq	141	Në procedurë		
3	PKR. 80/17	V.I	Q.M – Prishtinë	3 par 3	Me urdhër në dobi të përgj. 280 orë		
4	PKR. 2013/17	H.I	V.I – Prishtinë	136	Në procedurë		
			B.I – Mitrovicë				
			L.V – Skenderaj				
			F.G – Shkup				
			K.P – Ferizaj				
			A.A – Viti				
			L.G – Kaçanik				
			L.M – Skenderaj				
			B.P – Mitrovicë				
			D.D - Kamenicë				
7	PKR. 322/17	V.I	A.D - Prishtinë	3 par 3	1	6	
			K.B				
8	PKR. 162/17	V.S	B.L	137	4	6	
			G.H		3	6	
			M.H		3	6	
			E.L		3	6	
			F.M		3		

Tabela 10 Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2017, në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Lëndët për veprat Terrorizëm gjatë vitit 2017, në Gjykatën Themelore të Prishtinës



Grafiku 9 Grafiku sipas mënyrës së vendosjes në Gjykatën Themelore të Prishtinës


Lëndët për vitin 2017 - vepra terrorizëm

Periudha raportuese			Kallëzimi penal është marrë nga		Prej tyre	Mënyra e zgjedhjes së kallëzimeve penale sipas personave	Rastet në fazën e Shqyrtimit fillesatar dhe të Shqyrtimit të dytë	Vendimet gjyqësore sipas personave	Ankesa e Prokurorit dhe vendimet e Gjykatës në këto ankesa
1	2	3	4	5					
2014	7	18	Qytetari i demtuar	Personi juridik i dëmtuar	Prej tyre	Kallëzimet penale në procedurë hetimore	Prej tyre	Ankesa të aprovuara	Prej tyre
			Policia	Agjensioni antikorupsion					
			Auditori gjeneral	Qendra e intelgjencisë financiare					
			Organi i Administratës - Inspekcioni	Prokuroria publike drejtpërdrejtë					
			Eulexi	Të tjerët					
			Gjithsej kallëzime të pranuar penale gjatë periudhës raportuese Gjithsej (kol. 3 deri 12)	Gjithsej persona të paraqitur në kallëzimet e pranuar penale gjatë periudhës raportuese					
			Gjithsej kallëzime në punë gjatë periudhës raportuese (gjithsej të pagjidhura dhe të pranuar) = kol.1 +kol.13	Gjithsej persona, rastet e të cilëve janë në punë (kol. 2+14) = kol. 16					
			Gjithsej kërkesa për caktimin e paraburgimit	Gjithsej kërkesa për caktimin e paraburgimit					
			Kërkesa të aprovuara	Hedhje e kallëzimit penal					
			Kallëzime të dëguara në Departamentin për Kundërvajtje	Aktakuzë e drejtpërdrejt					
			Aktakuzë me kërkesë për Urdhërit ndëshkimor	Hetimet e pa përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktivime për fillim të hetimeve (filimi i hetimeve)	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej hetime në punë gjatë periudhës raportuese, kolona 23 + kolona 24	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			= kolona 25 Pezullim i hetimeve	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Rifillim i hetimit të pezulluar	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Pushim i hetimeve	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Për shkak të Ligjit për Amnisti	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktakuzë pas procedurës hetimore	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Hetime të pa përfunduara në fund të periudhës raportuese kolona 25 - kol 28 - kol 30 =	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			kolona 31 Pushimi i procedurës në shkak të parashkrimit	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Pushimi i procedurës për shkak të parashkrimit	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Propozim për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Cedim në kompetencë	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej raste të personave të zgjedhur kol. 19 + kol 21 +kol 22. + kol. 28 +kol 30 + kol 32 +	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej raste të personave të cilat kanë mbetur të pagjidhura në fund të periudhës	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej kallëzime penale të pagjidhura në fund të periudhës raportuese	Gjithsej raste të personave të cilat kanë mbetur të pagjidhura në fund të periudhës					
			Hudhja e Aktakuzës, neni 250 par. 3	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Ankesa kundër aktvendimit mbi hudhjen e Aktakuzës neni 250 par. 3	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Prej tyre	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Ankesa të aprovuara	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Prej tyre	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Për shkak të parashkrimit	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Masat e trajtimit të detyrueshëm	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Për shkak të parashkrimit relativ	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej ankesa të prokurorit në vendimet e Gjykatës	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Vetem për vendimin mbi denimin	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej ankesa të Aprovuara nga Gjykata	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Vetem ankesat në Vendimin mbi denimin	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Gjithsej Ankesat të Refuzuara nga Gjykata	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					
			Vetem për vendimin mbi denimin	Aktivime të përfunduara nga periudha paraprake					

2015	24	122		23				1			27	74	51	196	19	19						156	39	195	63	1	24	63	108						87	109	32						3				5	1	1				
2016	17	74		35				2	3	37	103	54	177	10	10							107	73	180	19		40	26	114							66	111	26						50				6	4			2	
2017	26	111		52				2	1	55		81	192	5	5	2						108	47	155	27	12	23	8	124							33	159	65						2	7			11	6			2	

Tabela 11 Raport statistikor për veprat penale kundër terrorizmit Neni 136-145 KPK i riu

Raport statistikor për veprat penale kundër terrorizmit Neni 136-145 KPK i ri



Grafiku 10 Raport statistikor për veprat penale kundër terrorizmit Neni 136-145 i ri

KAPITULLI VIII

8. Studimet empirike (Fokus grupi, intervistat gjysmë të strukturuar dhe anketa me pyetësor të strukturuar).

8.1 Intervista gjysmë të strukturuar me bërësit e politikave dhe përgjegjësit: roli i përgjegjësve të sektoreve të sigurisë dhe menaxhimi i situatave nga parandalimi i ekstremizmit të dhunëshëm;

8.2 Anketa me pyetësor të strukturuar me drejtorët e departamenteve të nivelit të mesëm e të ulët dhe të mesëm e të lartë: roli i drejtorit në zbatimin e politikave programore të dalura nga ligji dhe strategjia Kombëtare;

Përmbledhje.

<p style="text-align: center;">PYETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Komisioni AKI 1</p>	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
1. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë.			x		
2. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase komunikojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për ecurinë e punës.			x		
3. Këshilli Kombëtar i sigurisë merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare.	x				
4. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të sigurisë në mënyrë efikase vendosin për hartimin e strategjisë kombëtare për siguri		x			
5. Drejtorëve të Departamenteve ju jepet hapësirë në Këshillin Drejtues të sigurisë Kombëtare që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjen që kanë të bëjnë me sigurinë Kombëtare			x		
6. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase lehtësojnë zhvillimin, artikulumin dhe implementimin e një vizioni të qartë për strategjinë Kombëtare			x		
7. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase përfaqësojnë interesat e sigurisë dhe vlerat e saj në komunitet dhe në institucione dhe organe të tjera.		x			

8. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase udhëheqin me planet dhe proceset zhvillimore në kuadër të sektorit të sigurisë				X	
9. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase organizojnë dhe moderojnë takime me akterët kryesorë të sigurisë				x	
10. Drejtorët e departamenteve në mënyrë efikase marrin vendime me interes për sigurinë			x		
11. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin Kombëtar për siguri për punësimin e personelit dhe sistemimin në vendet e punës, sipas rregulloreve të punësimit dhe sistemimit të personelit		x			
12. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për udhëheqje të përbashkët		x			
13. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase orientojnë zhvillimin e sigurisë në të gjitha fushat e cilësisë së saj		x			
14. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme mbikëqyrin dhe monitorojnë procesin			x		
15. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase menaxhojnë cilësinë e punës në të gjitha fushat e cilësisë së saj			x		
16. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues të Sigurisë Kombëtare për menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve financiare nga grantet shtetërore dhe donacionet e jashtme për komunitetin, për të arritur qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit të sigurisë			x		

17. Rekomandimet e juaja	
--------------------------	--

Tabela 12 Pyetëtor – Komisioni AKI I

<p style="text-align: center;">PYETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Komisioni AKI 2</p>	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
1. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë.			x		
2. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase komunikojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për ecurinë e punës.		x			
3. Këshilli Kombëtar i sigurisë merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare.					
4. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të sigurisë në mënyrë efikase vendosin për hartimin e strategjisë kombëtare për siguri		x			
5. Drejtorëve të Departamenteve iu jepet hapësirë në Këshillin Drejtues të sigurisë Kombëtare që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjen që kanë të bëjnë me sigurinë Kombëtare				x	
6. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase lehtësojnë zhvillimin, artikullimin dhe implementimin e një vizioni të qartë për strategjinë Kombëtare			x		
7. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase përfaqësojnë interesat e sigurisë dhe vlerat e saj në komunitet , në institucione dhe organe tjera.			x		

8. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase udhëheqin me planet dhe proceset zhvillimore në kuadër të sektorit të sigurisë			x		
9. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase organizojnë dhe moderojnë takime me akterët kryesorë të sigurisë				x	
10. Drejtorët e departamenteve në mënyrë efikase marrin vendime me interes për sigurinë			x		
11. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin Kombëtar për siguri për punësimin e personelit dhe sistemimin në vendet e punës, sipas rregulloreve të punësimit dhe sistemimit të personelit				x	
12. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për udhëheqje të përbashkët			x		
13. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase orientojnë zhvillimin e sigurisë në të gjitha fushat e cilësisë së saj				x	
14. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme mbikëqyrin dhe monitorojnë procesin		x			
15. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase menaxhojnë cilësinë e punës në të gjitha fushat e cilësisë së saj				x	
16. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues të Sigurisë Kombëtare për menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve financiare nga grantet shtetërore dhe donacionet e jashtme dhe komunitetit, për të arritur qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit të sigurisë		x			

17. Rekomandimet e juaja	
--------------------------	--

Tabela 13 Pyetësor - Komisioni AKI 2

<p style="text-align: center;">PYETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Komisioni AKI 3</p>	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
1. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë.		x			
2. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase komunikojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për ecurinë e punës.			x		
3. Këshilli Kombëtar i sigurisë merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare.					
4. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të sigurisë në mënyrë efikase vendosin për hartimin e strategjisë kombëtare për siguri		x			
5. Drejtorëve të Departamenteve iu jepet hapësirë në Këshillin Drejtues të sigurisë Kombëtare që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjen që kanë të bëjnë me sigurinë Kombëtare			x		
6. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase lehtësojnë zhvillimin, artikulumin dhe implementimin e një vizioni të qartë për strategjinë Kombëtare				x	
7. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase përfaqësojnë interesat e sigurisë dhe vlerat e saj në komunitet dhe në institucione dhe organe tjera.		x			

8. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase udhëheqin me planet dhe proceset zhvillimore në kuadër të sektorit të sigurisë			x		
9. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase organizojnë dhe moderojnë takime me akterët kryesorë të sigurisë			x		
10. Drejtorët e departamenteve në mënyrë efikase marrin vendime me interes për sigurinë	x				
11. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin Kombëtar për siguri për punësimin e personelit dhe sistemimin në vendet e punës, sipas rregulloreve të punësimit dhe sistemimit të personelit		x			
12. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për udhëheqje të përbashkët			x		
13. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase orientojnë zhvillimin e sigurisë në të gjitha fushat e cilësisë së saj			x		
14. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme mbikëqyrin dhe monitorojnë procesin			x		
15. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase menaxhojnë cilësinë e punës në të gjitha fushat e cilësisë së saj			x		
16. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues të Sigurisë Kombëtare për menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve financiare nga grantet shtetërore dhe donacionet e jashtme për komunitetin, për të arritur qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit të sigurisë		x			

17. Rekomandimet e juaja	
--------------------------	--

Tabela 14 Pyetësor - Komisioni AKI 3

<p style="text-align: center;">PYETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Komisioni për SIGURI 1</p>	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
1. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë.		x			
2. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase komunikojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për ecurinë e punës.			x		
3. Këshilli Kombëtar i sigurisë merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare.	x				
4. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të sigurisë në mënyrë efikase vendosin për hartimin e strategjisë kombëtare për siguri		x			
5. Drejtorëve të Departamenteve iu jepet hapësirë në Këshillin Drejtues të sigurisë Kombëtare që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjen që kanë të bëjnë me sigurinë Kombëtare			x		
6. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase lehtësojnë zhvillimin, artikulumin dhe implementimin e një vizioni të qartë për strategjinë Kombëtare		x			
7. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase përfaqësojnë interesat e sigurisë dhe vlerat e saj në komunitet dhe në institucione dhe organe tjera.	x				

8. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase udhëheqin me planet dhe proceset zhvillimore në kuadër të sektorit të sigurisë		x			
9. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase organizojnë dhe moderojnë takime me akterët kryesorë të sigurisë			x		
10. Drejtorët e departamenteve në mënyrë efikase marrin vendime me interes për sigurinë	x				
11. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin Kombëtar për siguri për punësimin e personelit dhe sistemimin në vendet e punës, sipas rregulloreve të punësimit dhe sistemimit të personelit		x			
12. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për udhëheqje të përbashkët	x				
13. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase orientojnë zhvillimin e sigurisë në të gjitha fushat e cilësisë së saj		x			
14. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme mbikëqyrin dhe monitorojnë procesin	x				
15. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase menaxhojnë cilësinë e punës në të gjitha fushat e cilësisë së saj			x		
16. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues të Sigurisë Kombëtare për menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve financiare nga grantet shtetërore dhe donacionet e jashtme për komunitetin, për të arritur qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit të sigurisë	x				

17. Rekomandimet e juaja	<ul style="list-style-type: none"> • Preventiva nga ana e departamenteve për fushat që mbulojnë. • Marrja e praktikave më të mira
--------------------------	---


Tabela 15 Pyetësor - Komisioni SIGURI 1

<p style="text-align: center;">PYETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Komisioni për SIGURI 2</p>	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
1. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë.			x		
2. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase komunikojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për ecurinë e punës.			x		
3. Këshilli Kombëtar i sigurisë merr pjesë në hartimin e strategjisë kombëtare.		x			
4. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të sigurisë në mënyrë efikase vendosin për hartimin e strategjisë kombëtare për siguri			x		
5. Drejtorëve të Departamenteve iu jepet hapësirë në Këshillin Drejtues të sigurisë Kombëtare që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjen që kanë të bëjnë me sigurinë Kombëtare			x		
6. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase lehtësojnë zhvillimin, artikullimin dhe implementimin e një vizioni të qartë për strategjinë Kombëtare			x		
7. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase përfaqësojnë interesat e sigurisë dhe vlerat e saj në komunitet dhe në institucione dhe organe tjera.					

8. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase udhëheqin me planet dhe proceset zhvillimore në kuadër të sektorit të sigurisë		x			
9. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase organizojnë dhe moderojnë takime me akterët kryesorë të sigurisë		x			
10. Drejtorët e departamenteve në mënyrë efikase marrin vendime me interes për sigurinë			x		
11. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin Kombëtar për siguri për punësimin e personelit dhe sistemimin në vendet e punës, sipas rregulloreve të punësimit dhe sistemimit të personelit				x	
12. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Kombëtar të sigurisë për udhëheqje të përbashkët			x		
13. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase orientojnë zhvillimin e sigurisë në të gjitha fushat e cilësisë së saj					
14. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme mbikëqyrin dhe monitorojnë procesin		x			
15. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase menaxhojnë cilësinë e punës në të gjitha fushat e cilësisë së saj					
16. Drejtorët e Departamenteve në mënyrë efikase bashkëpunojnë me Këshillin Drejtues të Sigurisë Kombëtare për menaxhim efektiv dhe efikas të burimeve financiare nga grantet shtetërore dhe		x			

<p>donacionet e jashtme për komunitetin, për të arritur qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit të sigurisë</p>					
<p>17. Rekomandimet e juaja</p>					

Tabela 16 Pyetësor - Komisioni për siguri 2



*Grafiku 11 Grafiku i pyetësorëve:
Komisioni AKI 1, Komisioni AKI 2, Komisioni AKI 3, Komisioni SIGURI 1 dhe Komisioni SIGURI 2*

Intervistat me njohësit e sigurisë në Kosovë

Intervista për studimet e Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore-në Tetovë të Maqedonisë , me temën” Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në raste specifike 2014-2017 “

Prof Dr. Xhabir Hamiti – Profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

PYETJET

1.Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë ?

Ndër faktorët kryesor të ndërrimit të qasjes nga ai tradicional dhe racional e objektiv, në atë radikal dhe ekstrem, pa dyshim se ka një numër të madh të faktorëve. Ndër më kryesorët mund të rënditen si vijon:

- a. Propaganda masive e një interpretimi rigjid fetar të formës jo alternative, e cila ishte shumë aktive pas përfundimit të luftës në Kosovë.
- b. Shpërndarja e literaturës falas me përmbajtje ideologjike politike dhe sektare.
- c. Qasja e madhe e të rinjve në rrjetin social, e cila ua ka mundësuar ndjekjen e ligjëratave me përmbajtje fetare sipas versionit të huaj jo tradicional në shoqërinë tonë.
- d. Heshtja e gjatë e udhëheqësve të Bashkësive fetare islame tradicionale në Kosovë dhe më gjerë në rajon, kundër versioneve propaganduese të rrymave fetare, jo familjare me vendin, me kulturën, me traditat si dhe pozitën gjeopolitike dhe gjeografike të shteti tonë.

2.Cilët faktorë kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t'i bashkohen luftës në Siri?

- a. Indoktrinimi i verbërt sipas formës së veçantë të interpretimit fetar e cila është imponuar tek të rinjtë përmes propagandës në emër të mësimave “ islame”.
- b. Mungesa e njohurive të sakta se çfarë në të vërtetë po ndodhë në Siri dhe Irak.
- c. Mashtrimi i të rinjëve për një jetë më ideale në bazë të parimeve kinse sheriatike.
- d. Dëshira dhe vullneti për aventura.
- e. Varfëria dhe izolimi i të rinjve brenda Kosovës pa patur mundësi të udhëtimit në vendet e Evropës për shkak të sanksioneve për liberalizimin e vizave.

3. Cilat masa duhet t'i ndërrmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

- a. Preventiva(parandalimi) në kohë përmes senzibilizimit të asaj se çfarë ka ndodhur dhe çfarë po ndodhë në Siri dhe Irak.
- b. Krijimi i kundër-narrativave të formës së verbërt të interpretimit fetar.
- c. Rregullimi i pozitës juridike për Bashkësitë Fetare në vend.
- d. Koordinimi i fushatës dhe i aktiviteve me BIK-së.
- e. Kërkesa më e madhe dhe më e drejtpërdrejtë për BIK-së, e cila në këtë rast mund të luaj rolin kyç në drejtim të parandalimit të mëtujujshëm të indokrinimit të të rinjve me formën radikale dhe ekstreme të mësimve devijante në emër të “ islamit”.

4. Si duhet të trajtohen nga institucionet personat e Radikalizuar që gjinden në Burgjet e Republikës së Kosovës ?

- a. Të gjinden forma dhe mundësi të kontaktit me të burgosurit, të cilët janë dënuar për shkak të pjesëmarrjes së tyre në luftëra jashtë vendit.
- b. Sigurisht se mënyra më e mirë do të ishte angazhimi i psikologëve, ndërsa shumë e mirëseardhur do të ishte angazhimi edhe i ndonjë imami të parapërgatitur paraprakisht për trajtimin e individëve të tillë të radikalizuar në bazë të versioneve ekstreme fetare.

5. Cilat masa duhet të ndërmerren për trajtimin e personave që janë kthyer dhe priten të kthehen nga zonat e konfliktit nga Siria?

- a. Rehabilitimi i tyre në shoqëri dhe jetë normale përmes insituacioneve përkatëse sociale.

6. Cili është roli i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm ?

- a. Legjislacioni ka prodhuar efekte pozitive, sepse ka ndikuar në uljen e ikjes së të rinjve drejtë zonave të luftës. Sigurisht se në mungesë të tij do të kishte raste edhe të tjera të largimit të qytetarëve drejtë Sirisë dhe Irakut.

7. Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë?

- a. Angazhimi i të rinjve në projekte profitabile individuale dhe shoqërore. Mungesa e perspektivës dhe moszhvillimit ekonomik mund të luaj rol negativ në psikologjinë e

të rinjve. Përmes projekteve të ndryshme, të rinjtë mund të vetëdijësohen për rolin e tyre pozitiv në shoqëri, për rrezikun e manipulimit nga grupe dhe rryma të jashtme, për rolin e demokracisë etj.etj.

8.Si mund të ndikojnë institucionet e Arsimit (Universitetet), dhe OJQ-të e specializuara për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të Terrorizmit?

a.Arsimi është alfa dhe omega e formimit të duhur të individit dhe shoqërisë. Do të duhej që në të ardhmen në sistemin arsimor të parashihet ndonjë lëndë mësimore mbi historinë e religjioneve, për rolin e tyre përgjatë historisë si dhe për mundësitë e keqpërdorimit të mësimve fetare nga individ, grupe apo lider për kauza të ndryshme politike në botë.

b.Të njëjtën mund t`a bëjnë edhe OJQ-të, duke pasur për targetë struktura të caktuara të shoqërisë, të cilat janë më lehtë të manipulueshme.

9. Cilat janë programet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në Parandalimin e ekstremizmit dhe sipas mendimit tuaj çfarë programe të reja mund të krijohen ?

a.Nuk kam pasqyrë të detajuar për programet e Qeverisë së vendit tonë, por e di se ekziston një strategji e hartuar së fundi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në vendin tonë i cili mund të shpie në terrorizëm.

b.Ajo që mund të bëhet në të ardhmen është kontrolli më i ngjeshur mbi individët dhe organizatat e huaja apo të brendshme, të cilat ende vazhdojnë të propagandonjë mësimet fetare të shoqëruara me elemente dhune dhe intolerance.

Intervista për studimet e Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore-në Tetovë të Maqedonisë , me temën”Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në raste specifike 2014-2017”Z. **Haxhi Xhemajli** Koordinator për Siguri dhe Mbikqyrje të FSK –së në Kuadër të Parlamentit të Kosovës.

PYETJET

1. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë ?

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit janë të ndryshëm: social, ekonomik, religjioz.etj

2. Cilët faktorë kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t’i bashkohen luftës në Siri?

Faktorët që kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t’i bashkohen luftës në Siri janë: mungesa e perspektivës ekonomike, punësimi, cilësia e jetës, ndikimi religjioz.

3. Cilat masa duhet t’i ndërmmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

Masat që duhet t’i ndërmmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm janë:Zbatimi i ligjit, përmirësimi i gjendjes ekonomike, punësimin,edukimi dhe arsimimi cilësor, shpejtim të agjendës integruese.

4. Si duhet të trajtohen nga institucionet personat e Radikalizuar që gjinden në Burgjet e Republikës së Kosovës ?

Institucionet e Kosovës, duhet te marrin masa dhe veprime kompatible me situatën, gjithëpërfshirëse në mënyrë që këta persona të kenë suksese deradikalizimi. Eksperiencat nga vendet tjera tregojnë se pikërisht burgjet kanë shërbyer për nxitje, rritje kanë prodhuar efektin e kundërt. Koha e qëndrimit në burgje duhet të shërbejë që këta persona te kalojnë përmes procesit të deradikalizimit.

5. Cilat masa duhet të ndërmmirren për trajtimin e personave që janë kthyer dhe priten të kthehen nga zonat e konfliktit nga Siria.

Nuk kam ndonjë mendim konkret.

6. Cili është roli i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e esktermizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm ?

Po ligji për parandalimin e bashkimit të shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja ka luajtur rolin pozitiv në parandalimin e shkuarjes së shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja duke reduktuar në masë të madhe numrin e shtetasve të Kosovës në konfliktet e armatosura jashtë vendit.

7. Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalim të ekstremizmit të dhunëshëm në Kosovë?

Nuk kam mendim konkret.

8. Si mund të ndikojnë institucionet e Arsimit (Universitetet), dhe OJQ-të e specializuara për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të Terrorizmit?

Institucionet arsimore dhe OJQ kanë rol tepër të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të terrorizimit. Kjo arrihet sidomos me programet edukative dhe parandaluese të cilat duhet të jenë të përhershme dhe të integruara në kuadër të procesit arsimor të Kosovës.

9. Cilat janë programet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në Parandalimin e ekstremizmit , dhe sipas mendimit tuaj çfarë programe të reja mund të krijohen ?

Nukkam informacion konkret.

Intervista për studimet e Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore-në Tetovë të Maqedonisë , me temën”Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në raste specifike 2014-2017” me Z. Dr Florian Qehaja Drejtor Ekzekutiv i QKSS- Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë si dhe njëri ndër themeluesit e kësaj qendre .

PYETJET

1. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë ?

Fillimisht, fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë nuk është manifestuar në formën e ndonjë sulmi terrorist, por në vendimin e disa të rinjëve Kosovarë që t’u bashkohen luftërave të huaja dhe organizatave terroriste, kryesisht në Siri dhe Irak. Ekzistojne faktorë të shumtë që kanë ndikuar në shfaqjen e këtij fenomeni ne Kosovë, siç janë papunësia, edukimi (jo domosdoshmërisht niveli i edukimit, por, kualiteti i edukimit p.sh mungesa e mendimit kritik tek të rinjtë), ndjenja e mospërkatësisë në komunitetin ku kanë jetuar këta persona, mungesa e perspektivës, mungesa e njohurive mbi fenë, ‘fetarizimi’ ka ndodhur kryesisht shpejt dhe për një periudhë mjaft të shkurtër, gjithashtu edhe lidhjet familjare dhe shoqërore me persona të tjerë që veçse kanë qenë të radikalizuar.

2. Cilët faktorë kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t’i bashkohen luftës në Siri?

Besoj që përgjigjja më lartë i përgjigjet edhe kësaj pyetjeje.

3. Cilat masa duhet të ndërmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

Institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Fillimisht, Qeveria ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2015-2020; pastaj, është hartuar dhe miratuar edhe Ligji që ua ndalon pjesëmarrjen në konflikte të huaja qytetarëve të

Kosovës; gjithashtu është edhe Strategjia Kundër Terrorizmit; pastaj ekziston edhe ligji për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit. Pra, të gjitha këto ligje dhe politika kontribuojnë në parandalim dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

4. Si duhet të trajtohen nga institucionet personat e Radikalizuar që gjinden në burgjet e Republikës së Kosovës ?

Personat e radikalizuar që gjinden në burgjet e Kosovës duhet të i nënshtrohen programeve të deradikalizimit dhe pastaj edhe të re-integrit. Me sa kam informata unë, MPB nëbashkëpunim me ICITAP(çfarë kuptimi ka ky akronimMensur?) e ka formuar divisionin i cili do të merret me de – radikalizimin dhe re- integrimin e personave që janë kthyer nga konflikti si dhe familjareve te tyre.

5. Cilat masa duhet të ndërmerren për trajtimin e personave që janë kthyer dhe priten të kthehen nga Zonat e konfliktit nga Siria?

Edhe këta duhet të iu nënshtrohen procesit të de – radikalizimit dhe reintegrit. Por, këto programe duhet të iu përshtaten nevojave të personave dhe familjeve të tyre, meqë arsyet se pse dikush vendosi t'i bashkohet organizatave terroriste janë të ndryshme dhe nuk ka një rast të ngjashëm.

6. Cili është roli i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e esktermizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm ?

Roli i legjislacionit është shumë i madh meqë përcakton qartë se cilat janë aktivitetet që duhet ndërmarrë në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (këtu po i referohem Strategjisë në veçanti).

7. Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë?

Institucionet duhet të koordinohen ndërmjet vete si dhe të ndajnë informata me njëra – tjetrën. Është shumë i rëndësishëm roli i institucioneve në nivel lokal, prandaj duhet të ketë koordinim dhe bashkëpunim shumë më të mirë ndërmjet komunave dhe institucioneve të nivelit qendror.

8. Si mund të ndikojnë institucionet e Arsimit (Universitetet), dhe OJQ-të e specializuara për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të Terrorizmit?

Fillimisht, institucionet e arsimit e kanë një rol të jashtëzakonshëm në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm ,meqë në shkolla duhet të fillojë të zhvillohet dhe të inkurajohet mendimi kritik, i cili sipas shumë hulumtimeve, ka treguar që është esencial në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm. Pastaj, institucionet e arsimit mund edhe të shërbejnë si vende të

sigurta ku fëmijët dhe të rinjtë mund të ndajnë problemet e tyre me mësimdhënës dhe kështu të krijohet ndjenja e përkatësisë në komunitetin ku jetojnë.

Universitetet dhe OJQ-të e specializuara kanë një rol po aq të rëndësishëm meqë mund të kryejnë hulumtime shkencore që kanë për synim të identifikojnë faktorët që shpiejnë drejt ekstremizmit të dhunshëm, mund të zhvillojnë teknologji të re për monitorim të ideologjisë ekstremiste online dhe kështu të bëhet luftimi i kësaj dukurie edhe online. Për më tepër, universitetet dhe OJQ-të mund të shërbejnë edhe si qendra ku trajnohen edhe akterë të tjerë relevant (psh zyrtarët komunalë) në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm.

9. Cilat janë programet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në Parandalimin e ekstremizmit dhe sipas mendimit tuaj çfarë programe të reja mund të krijohen ?

Të gjitha programet dhe aktivitetet e Qeverisë dhe institucioneve tjera janë të përkrahura në Strategji si dhe në Plan të Veprimit. Sipas mendimit tim, duhet të fokusohet më tepër në riintegrim , sidomos të grave dhe fëmijëve të cilët janë kthyer nga zona e konfliktit, apo pritët qetë kthehen.

Intervista në kuadër të studimeve të Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë të Maqedonisë , me temën “ Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në raste specifike 2014-2017 “ **Z. Nur Çeku** Koordinator për AKI.

PYETJET

1. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë ?

Përgjigje-*Në mesin e faktorëve të cilët kanë ndikuar të paraqitet dhe rritet ekstremizmi në Kosovë është gjendja jo e mirë ekonomike e një kategorie të caktuar të popullsisë dhe mungesa e perspektivës, sidomos te të rinjtë.*

2. Cilët faktorë kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t’i bashkohen luftës në Siri?

Përgjigje-*Faktorët të cilët kanë ndikuar që të rinjtë kosovar t’i bashkohen luftës ne Siri është efekti indoktrinues nga prijësit /imamët fetar. Niveli i indoktrinimit të të rinjëve nga ana e prijëseve fetar të sektit Selefi përmes propagandimit të ideologjive radikale ka ndikuar drejtpërdrejt në shkuarjen e të rinjve në luftërat në lindje të mesme e posaçërisht në Siri.*

3. Cilat masa duhet të ndërmmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

Përgjigje-*Për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin dhe radikalizmin që shpie në terrorizëm, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrin masat si në vijim:*

- a) ndërprerja e mbështetjes financiare nga organizatat jashtë Kosovës,*
- b) parandalimin e ideologjive propaganduese dhe*
- c) angazhimi më i madh social.*

4. Si duhet të trajtohen nga institucionet personat e Radikalizuar që gjinden në burgjet e Republikës së Kosovës ?

Përgjigje-*Trajtimi i kësaj kategorie të pjesëtareve të shoqërisë kosovare duhet të bëhet përmes de-radikalizimit dhe integritit të tyre në shoqëri si pjesëtarë të dobishëm të saj. Kjo*

do duhej të arrihej edhe në mënyrën që gjatë vuajtjes së dënimit të krijohen programe të veçanta të cilat do të ndikonin dhe do të arrinin efekt të shpejtë në de-radikalizimin e tyre.

5. Cilat masa duhet të ndërmerren për trajtimin e personave që janë kthyer dhe priten të kthehen nga zonat e konfliktit nga Siria.

Përgjigje-*Siç u theksua edhe me lart, institucionet për zbatimin e ligjit dhe organizatat e ndryshme jo-qeveritare duhet të hartojnë programe të veçanta për trajtimin dhe ri-integrimin e këtyre personave në shoqëri, qoftë përmes përcjelljes së mesazheve jo-radikale apo edhe mundësisë së punësimit të tyre.*

6. Cili është roli i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e esktermizmit dhe radikalizmit që shpie në Terrorizëm ?

Përgjigje-*Legjislacioni pozitiv ka një rol të dyfishtë në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit në Republikën e Kosovës. Së pari, parasheh masa ndëshkimore për të gjithë personat të cilët janë të indoktrinuar nga ideologjitë ekstremiste. Së dyti, ka efekt profilaktik/parandalues që ndikon drejtpërdrejt në sensibilizimin e pjesëtarëve të shoqërisë lidhur me pasojat juridike të cilat mund t'i bartin në rast të radikalizmit apo ekstremizmit.*

7. Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalim të ekstremizmit të dhunëshëm në Kosovë?

Përgjigje-*Roli i stafit të institucioneve qëndron në hartimin e politikave të favorshme qeveritare të cilat do të ndikonin në parandalimin e ekstremizmit. Një nivel më i lartë i përgatitjes së personelit të institucioneve ligjzbatuese do të kishte efekt permanent në eliminimin e këtyre formave devijante të pjesëtarëve të shoqërisë kosovare.*

8. Si mund të ndikojnë institucionet e Arsimit (Universitetet), dhe OJQ-të e specializuara për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të Terrorizmit?

Përgjigje-*Institucionet arsimore në Kosovë, posaçërisht ato të arsimit të lartë do të kishin rol të jashtëzakonshëm në eliminimin dhe reduktimin e ideologjive radikale. Institucionet e arsimit, në këtë rast. Universitetet do duhej të implementojnë në kurrikulat e tyre programe/lëndë të cilat objekt të studimit të tyre do të kishin mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, të drejtave dhe lirive themelore të individit, integritetit trupor dhe moral si dhe ligjërimin e vlerave tjera fundamentale siç është familja dhe shoqëria. Gjithashtu, edhe Organizatat Joqeveritare do të kishin impakt të jashtëzakonshëm në këtë drejtim e sidomos ato të cilat merren me trajtimin e formave të radikalizimit fetar që të zbatojnë programe të cilat do i reduktonin rastet e paraqitjes së terrorizmit.*

9. Cilat janë programet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në Parandalimin e ekstremizmit , dhe sipas mendimit tuaj çfarë programe të reja mund të krijohen ?

Përgjigje- Qeveria e Republikës së Kosovës është dhe duhet që përmes inicimit të proceseve gjyqësore dhe ndërprerjes së financimit nga organizata të ndryshme që operojnë jashtë territorit të Kosovës të ndikojnë parandalimin e ekstremizmit. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës duhet të krijojë edhe programe të posaçme të ri-integrimit të personave të prirur ndaj kësaj dukurie negative e cila njëkohësisht paraqet edhe sfida aktuale të sigurisë ndaj qytetareve të vendit.

Intervista në kuadër të studimeve të Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë të Maqedonisë , me temën “ Ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë në raste specifike në periudhën kohore 2014-2017 “ me Z. Emursh Thaçi ish- Drejtor i Burgjeve të Kosovës njëherit Prof. Dr i Psikologjisë.

PYETJET

1.Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë?

- Përhapja e ideologjisë së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është bërë kryesisht përmes manipulimit të ndjenjës fetare tek të rinjtë.Përveç ndjenjës fetare, të radikalizuarit, përfituan nga rasti dhe shumica dërrmuese e atyre që i janë bashkuar organizatave terroriste në luftërat në Siri dhe Irak.
- Faktorët tjerë është hyrja e organizatave ndërkombëtare,të OJQ-ve në Kosovë me tendenca në radikalizimin e moshës së re e cila fatkeqësisht është nxënë në numër të madh të papunësisë.
- Faktorë tjetër është hyrja e rrymave ekstremiste të cilat në misionin e tyre kanë rritjen dhe dominimin e sekteve fetare në vendet e Ballkanit, me theks të veçantë në Kosovë.
- Shfrytëzimi i situatës socio-ekonomike nga klerikët fetar të relegjionit islam me bindje radikaliste që sot në Kosovë janë në numër të madh me tendencë të rritje, ku të njëjtit janë pjesë e shkollave të sekteve të vogla fetare me tendencë të shtrirjes edhe në tërë territorin e Kosovës.

- Një faktorët shumë serioz është edhe futja e radikalizmit nga vendet jo mike përmes sigurimeve shtetërore të tyre, të cilat si tendencë e kanë radikalizmin e një pjesë të shoqërisë që në raport me shtetet mike dhe kështu Kosovë të dalë më shumë me orientim pro-islamiste se sa euro-atlantike. Përmes kësaj rryme ekstreme shtetet jo mike të Kosovës përpiqen të arrijnë qëllimin e tyre në sferën gjeopolitike etj.

2. Cilët faktor kanë ndikuar që të rinjtë kosovarë t'i bashkohen luftës në Siri?

- Fillimisht ka qenë një luftë mediatike në përkrahje të kauzës Siriane edhe nga shumë qeveri të shteteve të ndryshme dhe vetë qeveria e Kosovës, por pastaj ajo u shndërrua në një luftë për “Xhihad” ku një pjesë e klerikëve tanë ndihmuan në rekrutimin e të rinjëve përmes OJQ-ve të cilat edhe ashtu e kishin mision rekrutimin,
- Mungesa e njohurive të mëparshme fetare, sistemi i dobët arsimor dhe mungesa e aftësive të të menduarit kritik i bëjnë njerëzit të blejnë në tiparet e radikalizmit fetar që çon në ekstremizëm. Sistemi arsimor i Kosovës ka dështuar që t'u krijojë aftësi që u sigurojnë punësim të rinjëve. Përveç kësaj, korrupsioni i institucioneve publike, pakënaqësia me punën e institucioneve publike, ka krijuar një depresion të përgjithshëm dhe tjetërsim nga sistemi, duke shtuar se kjo krijon kushte të favorshme për grupet radikale dhe fetare për të përhapur ideologjitë e tyre.

3. Cilët masa duhet të ndërmmarrin institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

- Kosova ka nxjerrë Strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020, por shtrohet pyetja sa jemi të kënaqur në parandalimin e kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë,
- Duhet që institucionet e Kosovës të organizojnë përmes MASHT-it leksione në shkolla që të njoftohen me pasojat eventuale në rast të radikalizimit.
- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndërmerr masa urgjente përmes mekanizmave të sigurisë dhe atyre financiare që të ketë nën kontroll financimin e OJQ-ve të cilave nuk u dihet financimi i tyre.

- Bashkësia Islame e Kosovës duhet të jetë nën ombrellën e institucioneve të Kosovës dhe të gjitha investimet eventuale nga jashtë shtetit të kenë një kontroll institucional.
- Monitorimi i mediave dhe portaleve elektronike për gjuhë dhe deklarata që mbjellin urrejtje dhe nxisin radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm,
- Krijimin e një ekipi të analistëve në nivel nacional për të mbledhur informacion mbi tendencat e radikalizimit në gjithë Kosovën (duke përfshirë rajonet/lokacionet më të prekura, moshën e synuar, demografinë etnike dhe të tjera, rekrutuesit dhe organizatat mbështetëse, narrativët e rekrutimit dhe metodat e përdorura nga ana e tyre), si dhe monitorimin e tyre për zhvillimet e reja, dhe përdorimi i këtij informacioni për të përshtatur veprimet parandaluese.
- Kryerja e hulumtimeve specifike në shkolla si dhe me opinionin publik do të jetë pjesë përbërëse e këtij aktiviteti.

4.Si duhet të trajtohen nga institucionet personat e Radikalizuar që gjinden në burgjet e Republikës së Kosovës?

- Në Shërbimin Korrektues të Kosovës është një numër i vogël i të ndaluarëve të cilët kanë qenë pjesë e luftës në Siri dhe Irak, mirëpo ndikimi i tyre në burgje ka pasur impakt negativ tek pjesa tjetër e të burgosurve ku në emër të asaj se ata janë persona që predikojnë aspektet fetare bëjnë shpërndarjen e kësaj rryme që, ka pasur efekt në rritje të kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë.
Kjo kategori në burgje duhet të trajtohet nga personeli i cili është i thirrur në risocializimin dhe riintegrim në shoqëri, përmes aktiviteteve të cilat organizohen brenda burgjeve në sferat edukative arsimore dhe në aftësi profesionale me qëllim që pas daljes nga burgu të jenë të orientuar drejt integritimeve shoqërore.
- Unëpersonalisht për këtë kategori kam kërkuar që të jenë të ndarë fizikisht me banim në dhomat e banimit dhe jo të futen brenda me pjesën tjetër ku janë të burgosurit për vepra tjera penale, pasi që kjo kategori është në gjendje të ndikoj në radikalizëm dhe ndikim në predikim radikal fetar, edhe pse tingllon

diskriminim ,mendoj që përkohsisht të jenë në banim më të veçuar ,por jo edhe në aktivitete ku mundësia e monitorimit është më e madhe.

- Personat e dënuar për veprat penale që ndërlidhen me terrorizmin, gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet korrektuese, mund t'i indoktrinojnë të dënuarit tjerë, që vuajnë dënimet për vepra penale ordinere.
- Të kthyerit nga lufta duhet të trajtohen nga institucionet në formë rehabilituese, të trajtohen nga aspekti Psiko-social, pasi që ka trauma lufte dhe në rast se kanë pasur edhe familjet në këto zona lufte të merren masa në ri-socializimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri përmes programeve nga institucionet dhe organizatat tjera kompetente.

5.Cilat masa duhet të ndërmerren për trajtimin e personave që janë kthyer dhe priten të kthehen nga zonat e konfliktit nga Siria?

Është e vështirë t'i qasesh me politika mosangazhimit dhe riintegritit të ish-luftëtarëve të huaj në Kosovë ,pasiqë ende nuk ekziston një program bazë. Krahasuar me vende të tjera evropiane, kapacitetet institucionale për të hartuar dhe zbatuar programe të suksesshme riintegrimi janë tejet të kufizuara. Korniza e sotme ligjore, nëpërmjet sistemeve korrektuese dhe institucioneve të ngjashme, nuk jep zgjidhje të mjaftueshme meqë nuk përputhet me gjendjen në terren. Është një nevojë urgjente që Kosova duhet ta ndërtojë modelin vetanak duke u bazuar në kapacitetet lokale dhe kontekstin për raste specifike, por, një program i detajuar risocializimi dhe riintegrimi për personat e radikalizuar ende mbetet për t'u zhvilluar për të plotësuar kornizën ligjore. Nëpër gjithë fushën në fjalë ekziston një pështjellim qasjesh ndaj riradikalizimit, por që nuk rrjedhin nga një proces konsultativ e i bashkërenduar. Sipas Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë, personat e dënuar duhet të i nënshtrohen programeve rehabilituese përpara rikthimit të tyre në shoqëri.

- Riintegrimi si i tillë nuk është politikë e preferuar, por detyrim ligjor për Qeverinë e Kosovës;
 - Sikurse me vendet e tjera të rajonit, Kosovës i mungojnë kapacitetet për hartimin dhe zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegritit brenda shërbimeve korrektuese;
- Që nga viti 2016, Qeveria e Kosovës e ka filluar procesin e hartimit të programit për deradikalizim dhe riintegrim.

- Programet e deradikalizimit dhe riintegritimit nuk iu drejtohen vetëm personave të kthyer nga zonat e luftës. Këto programe gjithashtu duhet të përfshijnë edhe personat që nuk iu janë bashkuar konflikteve të huaja, por kanë qenë subjekte të ekstremizmit brenda vendit;
- Shumica e ish-luftëtarëve të huaj të arrestuar nuk pritet të qëndrojnë në burg mbi 3.5 vjet;
- Ka dëshmi se të akuzuarit për terrorizëm dhe rekrutim po e vazhdojnë aktivitetin duke përhapur ideologji të dhunshme edhe brenda burgjeve. Shërbimet korrektuese nuk duken mjaftueshëm të për ta trajtuar këtë sfidë;
- Literatura radikale fetare që ka hyrë në burgje me mjete të pazakonta;
- Kthimi i luftëtarëve të huaj në shoqëri ende mbetet sfidë, meqë komuniteti i përgjithshëm në Kosovë shpreh rezerva kur është fjala për pranimin e tyre si pjesë e shoqërisë.

6.Cili është roli i legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e esktermizmit dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm?

- Kosova ka një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për të luftuar terrorizmin, e cila sipas Departamentit të Shtetit të SHBA “është e mjaftueshme për të ndjekur penalisht individë të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terroriste”. Kjo kornizë legjislative përbëhet nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, ku që të dyjat i adresojnë veprat në mënyrë gjithëpërfshirëse, si dhe krijojnë procedurat e nevojshme për të ndjekur penalisht krimet e lidhura me terrorizmin. Në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës gjithashtu miratoi **Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit**, sipas të cilit po ndiqen penalisht pjesëtarët e ISIS-it dhe organizatave të tjera ekstremiste që kthehen në Kosovë. Deri në vitin 2015 ,gjithsejt 130 pjesëmarrës të Kosovës në konfliktin e Lindjes së Mesme janë kthyer, ndërsa deri në vitin 2016 janë nxjerrë aktgjykime kundër 36 të pandehurve, 33 të pandehur janë në gjyq, 50 të pandehur janë nën hetim dhe 78 të dyshuar janë hetuar. Përveç kësaj, 19 njerëz u arrestuan në nëntor 2016, me dyshimin për komplot për të kryer sulme terroriste në Kosovë dhe Shqipëri. Në vitin 2016, Kosova e zgjeroi kornizën e saj legjislative për të luftuar aktivitetet terroriste. Kështu, në maj të vitit 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për parandalimin e pastrimit të

parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, duke zëvendësuar ligjin përkatës të vitit 2013. Në nëntor 2016, Banka Qendrore e Kosovës miratoi Rregulloren e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Nga 2013, institucionet publike të Kosovës miratuan dy direktiva administrative dhe dy udhëzime administrative lidhur me financimin e terrorizmit. Këto akte përfshijnë: Udhëzimin Administrativ 2013 për trajtimin e parandalimit dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit; Direktiva Administrative për Parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit 2015; Udhëzimin Administrativ 2013 për vlerësimin e rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; Udhëzimin Administrativ 2013 për përpilimin e statistikave, raporteve dhe rekomandimeve për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; dhe Udhëzimin Administrativ 2014 për standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga profesionistët e përfshirë.

7.Cili është roli i stafit të institucioneve, agjencioneve të sigurisë në ngritjen e performancës më të mirë në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë?

- Shtetet, përmes Ministrive, agjencive të tyre policore, në veçanti, kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë individëve brenda juridiksionit të tyre, nga terrorizmi, si pjesë e detyrimeve të tyre pozitive për garantimin e së drejtës për jetën, së drejtës për integritet fizik dhe të drejta të tjera si dhe liri themelore të njeriut. Rrjedhimisht, ato duhet të përqendrohen tek parandalimi i terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor. Teksa vendet e ndryshme mundohen të gjejnë mënyra për parandalimin më efikas të terrorizmit po shtohen njëkohësisht përpjekjet për të kuptuar pse dhe kur individët kthejnë sytë nga terrorizmi, si ndodh kjo dhe mënyrat sesi kjo mund të parandalohet që në fillesat e veta.

8.Si mund të ndikojnë institucionet e Arsimit (Universitetet), dhe OJQ-të e specializuara për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të luftimit të Terrorizmit?

- Takime informuese me mësimdhënës, menaxhmentin e shkollës dhe shërbimin psikologjik dhe pedagogjik në lidhje me sjelljet dhe veprimet e dyshimta të nxënësve.
- Identifikimi i shkollave që mund të jenë potencialisht të prekura nga ekstremizmi dhe radikalizmi.
- Identifikimi i individëve, grupeve, vendbanimeve, rajoneve të cilat janë të cenueshme ndaj influencimit me ideologji ekstremiste dhe radikale.
- Vlerësimi vjetor i gjendjes rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe readiklaizmit në Republikën e Kosovës,
- Identifikimi i personave të radikalizuar dhe mënyrave të radikalizmit.
- Studimi për identifikim të faktorëve të hershëm që ndikojnë në radikalizim dhe shtrirjen e dimensionit të radikalizmit në Kosovë.
- Pjesëmarrja e zyrtareve policore në debate publike që organizohen nga OJQ - të ndryshme, forume dhe organizata tjera në Kosovë.
- Organizimi i seminareve, tryezave të rrumbullakta dhe punëtorive nëbashkëpunim me bashkësitë fetare, OJQ -të e ndryshme dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë.

9.Cilat janë programet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në Parandalimin e ekstremizmit dhe sipas mendimit tuaj çfarë programe të reja mund të krijohen?

- Mbajtja e trajnimeve të përbashkëta me qëllim të konsolidimit, modernizimit dhe standardizimit të praktikave më të mira të shkëmbimit të informatave të inteligjencës.
- Mbajtja e trajnimeve themelore dhe të specializuara në fushën kundër ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit.
- Pjesëmarrja në Konferenca, Seminare rajonale kundër radikalizmit dhe ekstremizmit, Etj.

Intervista në kuadër të studimeve të Doktoraturës në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë të Maqedonisë , me temën “Ekstremizmi i dhunëshëm në Kosovë në raste specifike 2014-2017” me Prof. Dr. Mustafë Bajrami – ekspert dhe njohës i fesë dhe Lindjes së Mesme.

PYETJET

1. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e ekstremizmit në Kosovë ?

Ekstremizimi është dukuri globale që paraqitet nëpër vende të ndryshme, nëpër kohë të ndryshme dhe nën rrethana krejtësisht të ndryshme. Shkaqet e paraqitjes së tij janë gjithashtu të ndryshme. Ai është refleksion i gjendjeve të caktuara psikologjike, politike, ekonomike, fetare e kulturore.

